



© Tdh

Fëmijët dhe Migracioni në Shqipëri

Prirjet më të fundit dhe masat e disponueshme të mbrojtjes



Fëmijët dhe Migracioni në Shqipëri

**Prirjet më të fundit dhe masat
e disponueshme të mbrojtjes**

Dr. Zana Vathi and Dr. Iva Zajmi

Tabela e përmbajtjes

Falënderime	4
Shkurtesat	5
Termet dhe përkufizimet kyçe	6
Përmbledhje ekzekutive	8
1. Hyrje	12
2. Metodologjia	15
3. Migracioni dhe mbrojtja sociale: Zhvillimet dhe reagimet më të fundit kombëtare	18
3.1 Emigracioni	22
3.2 Imigracioni	23
3.3. Reagimi, koordinimi dhe kapaciteti institucional	24
3.3.1. Menaxhimi i flukseve të reja të migrantëve dhe refugjatëve	26
3.3.2. Ofrimi i ndihmës për të kthyerit	28
3.3.3. Caktimi i masave për ndihmën sociale	29
3.3.4. Mbrojtja e fëmijëve të prekur nga migracioni	31
4. Situata në terren: Rangu vendor	33
4.1. Emigracioni	33
4.2. Imigracioni	36
4.3. Migracioni i brendshëm	37
4.4. Migracioni i kthimit	39
4.5. Migracioni, mbrojtja sociale dhe e fëmijëve	41
5. Përfundime	48
6. Rekomandime	52
Anekset	55
Aneksi 1 - Bibliografia	55
Aneksi 2 - Lista e të intervistuarve	56
Aneksi 3 - Gjetjet sipas bashkive	58
Tabela 1. Të dhënat e kampionëve	26
Kutia 3. 1. Ligjet dhe politikat për migracionin dhe mbrojtjen sociale në Shqipëri	19
Kutia 3. 2: Shifrat e të kthyerve që nuk iu dha azil	22
Kutia 3. 3: Shifrat e fluksit të refugjatëve në Shqipëri	23

Falënderime

Ky raport është produkti i punës së një ekipi studiuesish të përbërë nga Dr. Zana Vathi (studiuese kryesore), Dr. Iva Zajmi (studiuese) dhe 4 studiues vendor: Ana Majko (Tiranë dhe Fier), Enkeleda Sako (Fier), Celstina Mucollari (Lezhë dhe Shkodër) dhe Nertila Lera (Korçë). Ky projekt u komisionua nga Terre des hommes në Shqipëri, me mbështetjen financiare të USAID-it, Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe Fondacionit Terre des hommes në Lozanë, dhe u koordinua nga zyra e Terre des hommes në Shqipëri, në mënyrë më specifike nga Enkelejda Kallçiu, Orinda Gjoni dhe Renata Kapidani. Nga ana tjetër, Jezerca Tigani dhe Blerta Spahiu nga Terre des hommes në Shqipëri, dhanë komente tejet të vyera në procesin e shqyrtimit, ndërsa Maria Antonia Di Maio dha ndihmesën e saj përmes rishikimit të raportit të studimit.

Falënderojmë përzemërsisht të gjitha grupet e interesit që pranuan të merreshin në intervistë, duke dhënë kështu një ndihmesë të madhe në studimin dhe përpilimin e këtij raporti. Lista e të intervistuarve ndodhet në Aneksin 2. Autori shpreh mirënjohjen e tij të veçantë për migrantët dhe familjet e tyre, të cilët ndanë me zemërgjerësi mendimet dhe përvojën e tyre gjatë punës në terren.

Shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
FRONTEX	Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian
ONQ	Organizatat ndërqeveritare
OJFN	Organizatat jofitimprurëse ndërkombëtare
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit për Migracionin
OJF	Organizatë jofitimprurëse
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SKM	Strategjia Kombëtare për Migracionin
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
SISHSHK	Strategjia për Integrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer, 2010-2015
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
MB	Mbretëria e Bashkuar
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët

Termet kyçe dhe përkufizimet

Në kuadrin e këtij raporti, janë përdorur përkufizimet e mëposhtme:

Fëmija është çdo person nën moshën 18 vjeç¹.

Adoleshenca përkufizohet si periudha e rritjes dhe zhvillimit të njeriut, që ndodh pas fëmijërisë dhe para moshës madhore, nga mosha 10 deri në 19 vjeç².

Të rinj quhen të gjithë ata persona që i përkasin grupmoshës 15-24 vjeç³.

Fëmijët në lëvizje përfshijnë të gjithë ata fëmijë që janë larguar nga vendbanimet e tyre dhe që ose po udhëtojnë drejt një vendi të ri, ose tashmë kanë mbërritur në atë vend⁴. Sipas përkufizimit të mësipërm, një fëmijë mund të lëvizë përtej kufijve shtetërorë, ose brenda vendit. Ai/ajo mund të udhëtojë vetëm, me prindërit ose me anëtarë të tjerë të familjes, me të rritur dhe/ose fëmijë të tjerë, qoftë të njohur apo të panjohur për të.

“Të miturit e pashoqëruar” përfshijnë shtetasit e vendeve të treta ose pa shtetësi nën moshën 18 vjeç, që mbërrin në territorin e shteteve anëtare të BE-së të pashoqëruar nga një kujdestar ligjor ose zakonor në moshë madhore dhe për sa kohë që ata nuk merren nën kujdesin efektiv të një personi të tillë. Këtu përfshihen edhe të miturit që lihen të pashoqëruar pasi kanë hyrë në territorin e vendeve anëtare⁵.

Fëmijët e ndarë janë fëmijët nën moshën 18 vjeç, jashtë vendit të tyre të origjinës dhe të ndarë nga të dy prindërit ose kujdestari i tyre i mëparshëm ligjor ose zakonor⁶.

Fëmijë i trafikuar është çdo person nën 18 vjeç i cili rekrutohet, transportohet, transferohet, strehohet ose pritët për qëllime shfrytëzimi, brenda ose jashtë vendit edhe nëse nuk përdoret asnjë mjet kanosjeje, mashtrimi, abuzimi me pushtetin apo çdo lloj tjetër forme abuzimi⁷.

1 Neni 1 i KKBDF-së

2 Përkufizimi i OBSH-së (http://www.who.int/maternal_child_adolescent/topics/adolescence/dev/en/)

3 Përkufizimi standard i OKB-së (<http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/youth/youth-definition/>)

4 Përkufizimi që përdor Terre des hommes, 2011.

5 Direktiva e Këshillit 2004/83/EC, 29 prill 2004, “Për standardet minimale për kualifikimin dhe statusin e shtetasve të vendeve të treta ose të personave pa shtetësi si refugjatët, ose të personave që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare” dhe përmbajtja e mbrojtjes së miratuar Kapitulli 1, Neni (2) (i), <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32004L0083:en:HTML>

6 Fëmijët e Ndarë në Programin e Evropës (SCEP), Deklarata e Praktikave të Mira, Botimi i katërt i Rishikuar, 2009. Ky përkufizim, që përdoret gjerësisht nga Komenti i Përgjithshëm Nr. 5, përfshin situatën kur fëmija mund të jetë i shoqëruar, por në praktikë, i rrituri që e shoqëron mund të mos ketë mundësi ose të jetë i dhuri për të marrë përsipër përgjegjësitë e kujdesit.

7 SCEP/Save the Children, *Dokument Qëndrimi për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Trafikimit të Fëmijëve në Evropë*, 2007. Ky përkufizim mbështetet në Nenin Nr. 3 të Protokollit të OKB-së për të Parandaluar, Shtypur dhe Ndëshkuar Trafikimin e Personave, Sidomos Grave dhe Fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar (2000).

Mbrojtja e fëmijës i referohet mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit⁸.

Refugjat është dikush që është detyruar të largohet nga vendi i tij/saj për shkak të përndjekjes, luftës ose dhunës. Një refugjat e ka të rrënjosur thellë frikën e përndjekjes për motive racore, fetare, kombëtare, politike apo anëtarësie në një grup të caktuar shoqëror. Me shumë gjasa, ata nuk mund të kthehen në shtëpi ose kanë frikë të kthehen. Shkaqet kryesore të largimit të refugjatëve nga vendet e tyre janë lufta si dhe dhuna etnike, fetare dhe fisnore⁹.

⁸ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, 1989

⁹ Përkufizimi i UNHCR-së, <http://www.unrefugees.org/what-is-a-refugee/>

Përmbledhje ekzekutive

Shqipëria dhe populli shqiptar janë prekur në mënyrë domethënëse nga migracioni që prej fillimit të viteve 1990. Qytetarët shqiptarë kanë pasur prirjen të emigrojnë kryesisht drejt vendeve më të pasura të Evropës, Amerikës së Veriut dhe Australisë. Megjithëse valët më të mëdha u regjistruan në vitet 1990 dhe 2000, emigracioni vazhdon ende në ditët e sotme, duke e kthyer Shqipërinë në vendin e origjinës së një prej flukseve më të mëdha të migracionit në Evropë. Megjithatë, emigracioni nuk është e vetmja formë lëvizjeje që prek Shqipërinë. Prirjet e imigracionit po rriten, ndonëse me një ritëm më të ulët se ai i vendeve të tjera të Evropës. Migracioni i kthimit, p.sh kthimi si i migrantëve afatgjatë edhe i atyre afatshkurtër, është një tjetër fluks migracioni tepër i rëndësishëm, ndërsa aspekti më i anashkalluar i lëvizjeve që prekin Shqipërinë është migracioni i brendshëm, i cili ka një ndikim të madh te personat e prekur, familjet e tyre, si dhe institucionet që priten t'i asistojnë.

Pavarësisht të dhënave të kufizuara për migracionin në Shqipëri, kjo dukuri duket se ndikon në mënyrë të padiskutueshme te popullsia, duke përfshirë edhe fëmijët. Kështu, Terre des hommes në Shqipëri vendosi të kryejë një kërkim për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore rreth prirjeve bashkëkohore të migracionit në vend, sfidave dhe mundësive që rrjedhin prej tyre, si dhe rreth masave aktuale të ndërmarra nga institucionet kombëtare dhe vendore. Kërkimi është një ndërthurje e dy elementeve kryesore, që janë një analizë e literaturës së disponueshme për prirjet aktuale të migracionit dhe, intervistat dhe fokus grupet me migrantë, familjet e tyre dhe persona të tjerë kyç në rang kombëtar dhe vendor, në pesë bashki të Shqipërisë (Tiranë, Shkodër, Lezhë, Fier dhe Korçë), të cilat janë prekur në mënyrë të konsiderueshme nga migracioni gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit. Për sa i përket kufizimeve kryesore, studimi nuk arriti të përfshijë popullatën e imigrantëve në mesin e të intervistuarve. Për më tepër, për shkak të pamjaftueshmërisë kohore, gjë që kufizoi pjesëmarrjen e sigurt dhe të plotë, fëmijët nuk u konsultuan në mënyrë të drejtpërdrejtë. Së fundi, duke qenë se informacioni i disponueshëm për fëmijët migrantë është shumë i kufizuar, gjetjet përqendrohen më tepër te fëmijët dhe familjet e prekura nga migracioni, megjithëse sipas këndvështrimit të tyre, situata e fëmijëve të prekur karakterizohet nga shumë aspekte.

Emigracioni nga Shqipëria ka qenë kryesisht i parregullt për një kohë të gjatë. Ndonëse gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit shumë qytetarë shqiptarë kanë arritur të integrohen në vende të tjera, mundësitë e migracionit të rregullt kanë mbetur të kufizuara. Me liberalizimin e regjimit të vizave në vitin 2010, modelet dhe prirjet e migracionit në Shqipëri kanë ndryshuar. Shtetasit shqiptarë mund të lëvizin brenda hapësirës Schengen për 90 ditë duke u larguar nga vendi në mënyrë të rregullt. Megjithatë, duke qenë se kjo mundësi nuk lidhet me gjasat për t'u punësuar jashtë vendit, shumë shtetas shqiptarë kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare për arsye ekonomike në zonën e Schengen-it (madje edhe në MB-në), si një mënyrë për të siguruar qëndrimin e tyre afatgjatë në këto vende. Pjesës më të madhe i është refuzuar dhënia e kësaj mbrojtjeje. Edhe pse është një formë më pak e rrezikshme për të udhëtuar, kjo mënyrë e re emigracioni paraqet sfida të mëdha për personat, familjet dhe fëmijët e kësaj kategorie. Nga kërkimet në rang vendor rezultoi që, azilkërkuesit shqiptarë, edhe pse paraqisnin një nivel më të ulët "të tronditjes psikologjike" kur ktheheshin në Shqipëri krahasuar me migrantët afatgjatë, ata ndodheshin në një situatë akoma më të pasigurt se ajo para largimit, pasi në përgjithësi

atyre u duhej t'i shisnin të gjitha pasuritë e tyre për të përballuar ekonomikisht udhëtimin dhe nuk kishin mundësi të fitonin as nga ana financiare dhe as nga ajo profesionale gjatë kohës së qëndrimit jashtë vendit. E njëjta tronditje psikologjike gjatë kthimit në Shqipëri vihej re edhe te fëmijët, të cilët e kishin më të lehtë integrimin në vendin e ri.

Shqipëria, krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor që janë përballur me flukse më të mëdha hyrëse migrantësh dhe azilkërkuesish gjatë periudhës 2015-2016, është prekur pjesërisht nga kriza e ashtuquajtur e 'migrantëve dhe refugjatëve'. Megjithatë, numri i kufizuar dhe i pandryshueshëm i personave dhe familjeve që kanë hyrë në vend ka nxjerrë në pah edhe mungesën e theksuar të përgatitjes së sistemit. Prirjet dhe menaxhimi i imigracionit në Shqipëri duhen analizuar më tej, sidomos për sa i përket nivelit të respektimit të të drejtave të personave të prekur dhe kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse. Gjithashtu, kërkimi identifikoi një fluks të madh imigrantësh për sa i përket personave që hynin dhe qëndronin rregullisht në Shqipëri, kryesisht për arsye pune, bashkim familjar dhe vullnetarizëm në veprimtaritë fetare. Ky aspekt i migracionit duket se nuk paraqet problem në Shqipëri.

Migracioni i kthimit në Shqipëri prek migrantët afatgjatë (të cilët shpesh kthehen për shkak të krizës ekonomike në vendin pritës), azilkërkuesit (të cilët kthehen vetë ose i kanë kthyer mbrapsht pasi i kanë refuzuar aplikimet), si dhe migrantët sezonalë. Situata dhe pritshmëritë e migrantëve të kthyer ndryshojnë, ndër faktorë të tjerë, në varësi të llojit të migracionit që kanë kryer. Në përgjithësi, migrantët afatgjatë janë të gatshëm t'i investojnë kursimet e tyre në pasuritë e paluajtshme ose në sektorin e biznesit. Ata kanë fituar aftësi të reja profesionale dhe dëshirojnë të punësohen sipas kualifikimeve. Fatkeqësisht, shpeshherë ata bien pre e zhgënjimit pasi mbështetja që marrin në rang vendor është shumë e kufizuar. Kjo situatë i nxit ata të migrojnë sërish.

Në përgjithësi, azilkërkuesit, të cilëve iu refuzuan kërkesat, kanë nevoja bazë dhe të menjëhershme si p. sh mbështetja për strehim apo për të përballuar të mirat dhe shërbimet jetike, si kujdesin shëndetësor. Megjithatë, në të dyja grupet e mësipërme, pengesat kryesore për riintegrim hasen në situatat e përjetuara nga fëmijët. Pasi arrijnë të integrohen mjaft mirë në vendin pritës (edhe kur qëndrimi i tyre jashtë vendit ishte relativisht i shkurtër), fëmijët ndihen të larguar nga vendi i tyre i origjinës dhe, janë në gjendje dhe kanë dëshirë t'i ruajnë lidhjet me vendin pritës. Pavarësisht përpjekjeve të mësuesve dhe stafit, këta fëmijë përballen me vështirësi të mëdha gjatë riintegrimin në shkollë, në komunitet dhe në shoqëri.

Migracioni i brendshëm prek të gjitha bashkitë e përfshira në këtë studim, megjithëse në shkallë të ndryshme dhe në varësi të modeleve paksa të ndryshme. Migrantët e brendshëm janë personat dhe familjet që lëvizin në përgjithësi nga zonat rurale tek ato urbane me shpresën për të përballuar standardet e larta të jetesës dhe për të pasur më shumë mundësi për veten dhe për fëmijët e tyre (që lidhen kryesisht me punësimin, arsimimin dhe shëndetin). Migracioni i brendshëm në Shqipëri përfshin edhe migrantët e kthyer afatgjatë dhe afatshkurtër, që duan të vendosen në qytete dhe zona të ndryshme të vendit pasi kthehen, me shpresën për të filluar sërish jetën e tyre në kushte më të mira. Fatkeqësisht, të rriturit dhe fëmijët migrantë të brendshëm nuk konsiderohen si në nevojë për ndihmë apo mbrojtje, megjithëse përballen me një sërë pengesash gjatë aksesit në shërbime, kryesisht për shkak të pengesave administrative. Më të cenueshmit në mesin e migrantëve të brendshëm janë ata që kanë arsim të ulët dhe formim të ulët socio-ekonomik, sidomos personat dhe familjet që i përkasin minoriteteve etnike që janë pre e diskriminimit në vend.

Kërkimi në rang vendor pohoi prirjet e përgjithshme në lidhje me migracionin hyrës, dalës dhe të brendshëm në Shqipëri të përvijuar në rang kombëtar. Megjithatë, duket se lloji dhe intensiteti i lëvizjeve ndikohen nga pozita gjeografike e çdo qyteti, ndryshimet socio-kulturore dhe ekonomitë ekzistuese vendore. Duke qenë se është kryeqyteti dhe qyteti më i populluar, Tirana pret numrin më të madh të migrantëve të brendshëm. Gjithashtu, ajo tërheq një pjesë të konsiderueshme të imigracionit të rregullt në vend. Megjithatë, një numër i madh imigrantësh nga shtete të ndryshme u vendosën në Fier për të punuar në industrinë vendase të naftës. Në Lezhë, duket se prirja mbizotëruese mbetet emigracioni në vendet e Bashkimit Evropian (kryesisht në Itali) dhe ky qytet nuk u prek nga fluksi hyrës i azilkërkuesve dhe i migrantëve të parregullt. Nga ana tjetër, kjo lëvizje preku si Shkodrën, ashtu edhe Korçën pasi kjo e fundit shërbente si pikë hyrëse në vend, ndërsa Shkodra si pikë dalje për ata që synonin Bashkimin Evropian.

Menaxhimi i migracionit dhe ndërveprimi tij me sistemet sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri duket se karakterizohen nga mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve në përgjithësi, e ndërthurur me mungesën e burimeve financiare dhe njerëzore (si në numër, ashtu edhe në aftësitë përkatëse profesionale). Pavarësisht aspekteve shumëplanëshe të migracionit të nënvijëzuar në këtë raport, duket se ndihma dhe mbrojtja që i ofrohet personave, familjeve dhe fëmijëve të prekur nga migracioni mbështeten ende në një përkufizim të ngushtë të "grupeve të cenueshme" që sjell përjashtimin e atyre që kanë nevojë për mbështetje. Të gjendur përballë mbizotërimit të emigracionit në Shqipëri, përpjekjet e qeverisë për të bashkëpunuar me vendet kryesore që presin qytetarët shqiptarë janë ende të kufizuara kur bëhet fjalë zgjerimin e mundësive të punësimit të rregullt.

Kur kthehen, migrantëve iu mungon ndihma dhe mbrojtja e duhur, duke përfshirë strehim, punësim, ngritjen e bizneseve të reja dhe akses në shëndetësi. Nga ana tjetër, pavarësisht nevojës për fuqizim dhe integrim në një sistem mbrojtjeje funksionale më të gjerë, përpjekjet për të mbështetur përfshirjen në shkollë të fëmijëve të kthyer duket se janë të konsiderueshme, sidomos në rang vendor. Megjithatë, në tërësi, migrantët shprehën mungesë besimi të institucionet dhe në kapacitetin e tyre për të ndihmuar me efikasitet ata dhe familjet e tyre.

Duke qenë se është përqendruar për një kohë të gjatë te emigracioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore, Shqipërisë i mungon një kuadër dhe politikë gjithëpërfshirëse ligjore për imigracionin. Gjatë ndarjes së boshllëqeve me sistemin më të gjerë të menaxhimit të migracionit për sa i përket burimeve financiare dhe njerëzore si dhe koordinimit ndërinstytucional, u ngritën shqetësime të mprehta në lidhje me menaxhimin e imigrantëve të parregullt dhe refugjatëve. Këto lidhen veçanërisht me kapacitetin dhe standardet e kujdesit dhe akomodimit të familjeve dhe fëmijëve të azilkërkuesve, vendqëndrimin dhe kushtet e paraburgimit të migrantëve që nuk kanë aplikuar për azil.

Nga kërkimi doli në pah, si në rang kombëtar, ashtu edhe në rang vendor, nevoja për të reformuar politikën dhe kuadrin institucional në lidhje me menaxhimin e migracionit dhe ofrimin e mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve për migrantët. Për ta arritur këtë synim, rekomandohet në veçanti:

- *Përmirësimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i migracionit.* Në Shqipëri, duhet hartuar dhe zbatuar një politikë gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë migracioni. Një politikë e tillë duhet të përqendrohet në zgjerimin e mundësive të ligjshme për emigracion për qëllime pune apo formim profesional.

- *Prioritizimi i ofrimit të shërbimit dhe buxhetimit të tij në rang qendror.* Në mënyrë që të përmbushë objektivat e saj për migracionin dhe mbrojtjen sociale, Shqipëria duhet t'i japë përparësi ofrimit të shërbimit në terren për migrantë, si dhe burimeve njerëzore dhe materiale brenda buxhetit të saj kombëtar.
- *Njohja e migracionit të brendshëm si një formë e rëndësishme e migracionit në lidhje me politikëbërjen.* Në Shqipëri, migrantët e brendshëm duhen njohur si grup i cënueshëm që kanë nevojë për ndihmë. Duhet hequr të gjitha pengesat administrative që pengojnë aksesin në shërbime.
- *Ofrimi i mbështetjes së duhur për të ndihmuar migrantët në procesin e riintegrit.* Migrantëve që kthehen nga jashtë u duhet ofruar mbështetje në lidhje me strehimin dhe mundësitë e punësimit, arsimimin dhe kujdesin shëndetësor. Si bazë për të mbështetur punësimin dhe ngritjen e bizneseve të reja, mund të krijohet një listë me aftësi që janë fituar gjatë emigracionit. Gjithashtu, masat për të nxitur ngritjen e bizneseve të reja nga emigrantët e kthyer mund të përfshijnë përjashtime nga taksat në muajt e parë ose ofrimin e ambienteve të punës.
- *Përmirësimi i ndjeshëm i trajtimit të imigrantëve të parregullt dhe azilkërkuësve.* Duke qenë se mund të ketë një rritje të mundshme të numrit të këtyre migrantëve, i gjithë seti i procedurave që kanë të bëjnë me të rriturit, fëmijët dhe familjet që janë pjesë e këtij grupi të rrezikuar duhet t'i nënshtrohen një analize të hollësishme dhe të rishikuar me imtësi në mënyrë që Shqipëria të plotësojë standardet bazë të të drejtave të njeriut të përcaktuara nga drejta ndërkombëtare dhe kombëtare.
- *Përfshirja e të gjithë institucioneve që i ofrojnë migrantëve shërbime sociale në rang vendor në zhvillimin e procedurave standarde të veprimit duke caktuar qartë kohën, si dhe duke identifikuar institucionet përgjegjëse në çdo fazë veprimi dhe ndërveprimin ndërmjet migracionit dhe strukturave të shërbimit social.* Mandati i këtyre institucioneve duhet rishikuar për të përmirësuar sa më shumë të jetë e mundur ofrimin e shërbimeve dhe për të shmangur mbivendosjen.

1. Hyrje

Shqipëria dhe populli shqiptar janë prekur në mënyrë të konsiderueshme nga migracioni që prej rënies së diktaturës në vitin 1990 dhe kalimit në ekonomi tregu dhe shtet demokratik. Njësoj si e gjithë Evropa Juglindore, Shqipëria ka përjetuar një rritje të menjëhershme të intensitetit të lëvizjeve të popullsisë, e cila ndikon në llojet dhe prirjet e ndërlikuara të migracionit në të gjithë rajonin e më gjerë. Prirja më mbizotëruese është emigrimi i qytetarëve shqiptarë kryesisht drejt vendeve të tjera të Evropës, por edhe në vende më të largëta si në Amerikën e Veriut dhe në Australi.

Megjithëse valët më të mëdha të emigracionit u regjistruan në vitet 1990 dhe 2000, emigracioni në Shqipëri vazhdon edhe në ditët e sotme. Për shkak të liberalizimit të regjimit të vizave në vitin 2010, qytetarët shqiptarë mund të lëvizin lirisht brenda hapësirës Schengen¹⁰, megjithëse nuk lejohen të punojnë në këto vende, pasi e drejta për të punuar në vende të tjera varet nga marrëveshjet dypalëshe të punësimit ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverive të vendeve të tjera. Pavarësisht kësaj, në vitin 2015 u regjistrua një valë e madhe emigrantësh shqiptarë.

Pavarësisht kthimit të migrantëve në Shqipëri (kryesisht nga Greqia), që filloi në mesin dhe fundin e viteve 2000 për shkak të krizës ekonomike që preku të gjithë Evropën¹¹, numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit u përllorarit në 1,4-1,5 milion, duke e kthyer Shqipërinë në një prej vendeve të origjinës me fluksin më të madh të migrantëve në Evropë.

Siç tregojnë edhe gjetjet e këtij raporti (seksioni 4), varfëria, papunësia dhe pakënaqësia e madhe me sistemin e mbrojtjes sociale i nxiti shumë familje të pafavorizuara të shkonin drejt vendeve më të pasura të BE-së. Sipas UNHCR-së¹², numri i qytetarëve shqiptarë që emigruan drejt hapësirës Schengen për periudhën 2012-2015 përlloraritet të jetë 62, 520. Pjesa më e madhe e këtyre personave kanë aplikuar për azil në Bashkimin Evropian. Sipas UNHCR-së, në vitin 2015, shqiptarët zinin vendin e parë për nga numri i kërkesave në azil pas sirianëve (54,762 persona)¹³. Kjo dukuri përfshin persona që lëvizin në hapësirën Schengen për shkak të liberalizimit të regjimit të vizave dhe që aplikojnë për azil për shkak të mungesës së mundësive për punësim dhe kushteve të këqija ekonomike¹⁴. Siç analizohet edhe në seksionin 4, komunitetet dhe institucionet vendore të fushës po përballen me një numër të lartë personash, duke përfshirë edhe fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë nga familjarët, si dhe të rinj dhe familje që po riintegrohen në Shqipëri pasi kërkesa e tyre për azil është refuzuar nga një prej shteteve të BE-së.

¹⁰ Hapësira Schengen, e themeluar nga Marrëveshja Schengen (1985), nënkupton një zonë ku 26 vende të ndryshme evropiane që kanë nënshkruar marrëveshjen i kanë hequr të gjithë kufijtë e brendshëm duke i zëvendësuar me një kufi të vetëm të jashtëm. Ato janë: Austria, Belgjika, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Lihtenshtejni (<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AI33020>).

¹¹ http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013_.pdf

¹² <http://www.unhcr.org/uk/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html>

¹³ <http://www.unhcr.org/uk/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html>

¹⁴ <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-kosovo-top-german-2015-asylum-seekers-list-01-07-2016>

Emigracioni nuk është forma e vetme tradicionale apo bashkëkohore e migracionit që prek Shqipërinë. Shqipëria është një vend me të ardhura mesatare, që ka kaluar sfida dhe transformime të mëdha ekonomike që prej fillimit të viteve 1990. Prirjet e imigracionit në Shqipëri po rriten pjesërisht edhe si rezultat i përmirësimit të gjendjes ekonomike. Këto prirje lidhen me historinë e migracionit dhe profilin socioekonomik të Shqipërisë, gjatë periudhës kur prekej nga lëvizje të tjera migratore në rajon dhe në rang ndërkombëtar. Për shembull, Shqipëria është prekur nga fluksi i refugjatëve nga Siria, Libia, Afganistani dhe vende të tjera të shkatërruara nga lufta megjithëse në një shkallë më të vogël krahasuar me vendet e tjera të Evropës dhe Ballkanit Perëndimor. Prandaj, ky raport synon të studiojë dinamikën e këtyre flukseve dhe ndikimin e tyre në debatet politike, vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve në Shqipëri.

Një tjetër fluks migracioni tejet i rëndësishëm është migracioni i kthimit. Prirjet e kthimit lidhen ngushtë me modelet e emigracionit të viteve 1990 dhe 2000. Numri më i madh i të kthyerve në Shqipëri në fundin e viteve 2000 vinte nga Greqia për shkak të krizës ekonomike në vend, e cila kishte shërbyer si vend pritës për komunitetin më të madh të migrantëve shqiptarë në Evropë. Migracioni i kthimit është shtuar gjatë viteve të fundit, ku numri i të rriturve të kthyer në Shqipëri ishte 133,544 gjithsej për periudhën 2009-2013¹⁵. Ky shtim lidhet edhe me urgjencën e prirjes së theksuar më sipër për sa i përket numrit në rritje të qytetarëve shqiptarë që kërkojnë azil në vendet e Evropës Perëndimore. Mbledhja e të dhënave dhe analiza e migracionit të kthimit në Shqipëri janë ndërmarrë kohët e fundit, dhe si rrjedhojë, mungojnë statistika të qëndrueshme në lidhje me karakteristikën e të kthyerve. Për më tepër, edhe pse dihet që 33,7% e këtyre migrantëve janë kthyer me bashkëshortët dhe fëmijët, nuk dihet ende numri i saktë i të kthyerve nën 18 vjeç¹⁶. Fëmijët që kanë hyrë në Shqipëri si pjesë e migracionit të kthimit janë regjistruar në mënyrë sporadike nga institucione të ndryshme, në varësi të fushës ku ata përqendrohen. Për shembull, sipas të dhënave nga Ministria e Shëndetësisë, në Shqipëri, gjatë periudhës 2012-2014 janë kthyer 12,444 fëmijë emigrantë gjithsej (përkatësisht 3,484 në vitin 2012, 5,020 në vitin 2013 dhe 3,940 në vitin 2014) si pjesë të programit kombëtar të vaksinimit¹⁷. Mospërfshirja sistematike e fëmijëve në statistika paraqet një pengesë të madhe në politikëbërjen e shëndoshë për migracionin dhe për hartimin e masave efektive për të mbrojtur fëmijët e prekur nga migracioni në Shqipëri.

Megjithatë, ndoshta lloji më i anashkaluar i migracionit, si dhe efekti që ka te migrantët dhe familjarët e tyre është migracioni i brendshëm. Ndoshta këtij lloji nuk i jepet përparësi nga politikëbërësit përkatës pasi paketa e kushteve për aderimin e Shqipërisë në BE përqendrohet te emigracioni, siç shihet edhe nga seksioni 3. Megjithatë, siç shpaloset edhe nga ky kërkim, ky lloj migracioni ka ndikim të madh te shërbimet. Për më tepër, lidhet me përafrimin e politikave me BE-në, duke qenë se mënyra se si migracioni i brendshëm trajtohet në Shqipëri lidhet drejtpërdrejtë me kushtet që priten të përmbushë nga sistemi i mbrojtjes shoqërore, një tjetër çështje madhore që i përket negociatave për aderimin në BE. Në këtë raport, diskutohet ndikimi që këto prirje kanë në politikë dhe praktikë mbështetur në intervistat me politikëbërësit, ofruesit e shërbimeve dhe me vetë migrantët.

Pavarësisht natyrës së ndërlikuar dhe rëndësisë së migracionit që prek Shqipërinë, vendit i mungon aktualisht një strategji gjithëpërfshirëse zyrtare migracioni. Shqipëria ka përparuar në trajtimin e problemeve të migracionit, duke i përfshirë ato edhe në disa strategji kombëtare për

¹⁵ http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013_.pdf

¹⁶ http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013_.pdf

¹⁷ http://www.albania.iom.int/publications/reports/Profili_i_zgjeruar_i_migracionit_ENG_web.pdf

sektorë të veçantë për periudhën 2014-2020, si në mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, punësimin, biznesin dhe zhvillimin, menaxhimin e integruar të kufirit dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, duhen bërë ende më shumë përpjekje në trajtimin e qëndrueshëm dhe të përshtatshëm të problemeve me natyrë shumëplanëshe dhe në ofrimin e mbrojtjes dhe aksesit të plotë për të drejtat themelore të migrantëve dhe familjeve të tyre.

Nisur nga të dhënat e kufizuara për prirjet e migracionit në Shqipëri dhe nga ndikimi që ka në popullsinë shqiptare, duke filluar nga migrantët dhe familjet e tyre e deri te institucionet kombëtare dhe vendore, Tdh-ja në Shqipëri vendosi të kryejë një kërkim për të mbledhur të dhëna sasiore dhe cilësore rreth prirjeve bashkëkohore të migracionit në Shqipëri, sfidave, si dhe mundësive që rrjedhin prej migracionit dhe reagimeve aktuale nga institucionet vendore dhe kombëtare përgjegjëse për menaxhimin e migracionit dhe në ofrimin e ndihmës apo mbrojtjes për personat e prekur prej saj, sidomos fëmijëve. Ndryshe nga publikimet e disponueshme në lidhje me temën që kanë vënë theksin tek emigracioni, raporti në fjalë vlerëson profilin migrator të Shqipërisë që po transformohet me ritme të larta dhe i kushton vëmendje migracionit të brendshëm dhe imigracionit.

Ky raport ndahet në katër seksione kryesore. Pas prezantimit të temave kyçe të analizuara në raport (Seksioni 1) dhe përvijimit të aspekteve kryesore të metodologjisë së ndjekur gjatë këtij studimi (Seksioni 2), në Seksionin 3 shqyrtohen problemet e lidhura me migracionin, më konkretisht numri gjithnjë e në rritje i qytetarëve shqiptarë që kanë aplikuar për azil në Evropën Perëndimore për arsye ekonomike dhe fluksi hyrës i imigrantëve dhe refugjatëve të parregullt në Shqipëri, që shërbejnë si burim diskutimesh në ditët e sotme në rang kombëtar. Këto dy tema u analizuan në lidhje me rreziqet e mundshme dhe mundësitë për migrantët e përfshirë dhe kapacitetin e institucioneve përgjegjëse për të menaxhuar migracionin dhe për t'i ofruar ndihmë apo mbrojtje migrantëve të prekur në kontekstin më të gjerë të kuadrove ekzistues ligjorë dhe të politikave që lidhen me këtë temë.

Një aspekt novator i këtij raporti është vëmendja e madhe dhe e hollësishme që i kushton kësaj situatë. Sipas këndvështrimeve në rang kombëtar, raporti vijon me diskutimin e përmasave vendore, duke vëzhguar pesë zona urbane në rajone të ndryshme të Shqipërisë: Tirana (kryeqyteti i Shqipërisë), Shkodra dhe Lezha (dy qytete të mëdha në veri), Korça dhe Fieri (dy qytete të mëdha në jug). Në seksionin 4, hollësitë për funksionimin e shërbimeve sociale dhe sfidave që hasen nga migrantët dhe ofruesit e shërbimeve analizohen nga këndvështrimi i politikëbërjes në rang kombëtar. Informacione të posaçme për bashkitë ofrohen në Aneksin 3.

Në pjesën e fundit të raportit jepen një sërë përfundimesh dhe rekomandimesh kyçe për politikëbërësit dhe për organizatat që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë në Shqipëri.

2. Metodologjia

Ky studim synon të ofrojë një analizë të situatës së prirjeve dhe dinamikave bashkëkohore të migracionit dhe ndikimin që ata kanë te popullsia, sidomos te fëmijët nëpërmjet ndërthurjes së të dhënave në rang kombëtar dhe vendor. Në mënyrë më specifike, kërkimi synon të:

- Ofrojë një vështrim të përgjithshëm për arsyet e migracionit, si dhe të udhëtimeve migratore dhe të trajtimit të fëmijëve dhe familjeve nga autoritetet;
- Ofrojë një profil të migrantëve në 5 rajone të Shqipërisë (Tirana, Lezha, Shkodra, Korça dhe Fieri), duke analizuar sfidat dhe mundësitë për fëmijët dhe familjet migrante;
- Kuptojë në përgjithësi planet dhe shërbimet institucionale në nivel qendror dhe vendor për Shqipërinë dhe fëmijët dhe familjet me shtetësi të huaj që kanë përjetuar lloje të ndryshme migracioni;
- Japë rekomandime se ku duhet të përqendrohen fushat kyçe të politikëbërjes në rang kombëtar dhe vendor;

Dy ishin elementët kryesorë të kërkimit për përpilimin e këtij raporti: 1-analiza e literaturës së disponueshme për prirjet aktuale, si dhe reagimet institucionale, të zbatuara në kuadrin ligjor dhe të politikave ekzistuese për migracionin dhe mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri; dhe 2- intervista me migrantët dhe anëtarët e familjes dhe persona të tjerë kyç në rang kombëtar dhe vendor.

Rishikimi i literaturës përfshin raportet e disponueshme dhe dokumente të tjera që lidhen me migracionin në gjuhën shqipe, angleze apo gjuhë të tjera fliten nga ekipi i kërkimit, sidomos për ato që përqendrohen te llojet e migracionit që duket se prekin në masë të gjerë fëmijët. Gjithashtu janë rishikuar edhe dokumentet në gjuhën shqipe, angleze apo gjuhë të tjera që fliten nga ekipi i kërkimit, në lidhje me mbrojtjen sociale dhe sistemet e mbrojtjes së fëmijëve. Analiza përfshinte si dokumentet e publikuara, ashtu edhe ato të brendshmet të aksesuara nëpërmjet punës në terren dhe të ofruara nga një sërë institucionesh dhe organizatash që veprojnë në Shqipëri.

Ky studim bazohet kryesisht te metodat sasiore, më konkretisht te **intervistat, diskutimet e fokus grupeve, vëzhgimeve** dhe shënimeve për vëzhgimet gjatë punës në terren. Kërkimi u krye kryesisht në rang kombëtar dhe vendor. Kërkimi në rang kombëtar u krye në Tiranë, por megjithatë, procesi i analizimit të të dhënave u bazua te një metodologji krahasuese e studimit të rasteve. Si rrjedhojë, çdo bashki u trajtua si një rast studimor dhe u krye një analizë e hollësishme për secilën prej pesë qyteteve të përfshira. Krahas këtyre studimeve, u ndërmor edhe një analizë krahasuese ku ndërthureshin të dhëna nga kërkimet në çdo bashki dhe ku krahasoheshin situatat në rang kombëtar dhe vendor.

Puna në terren përfshinte pesë bashki: Shkodër, Lezhë, Tiranë, Fier dhe Korçë. Në çdo bashki u planifikuan 10 intervista me migrantë dhe/ose të afërmit e migrantëve dhe 10 intervista me persona kyç (100 intervista gjithsej me nga 50 për çdo grup). Krahas kësaj, u planifikuan edhe 15 intervista në Tiranë me persona kyç që punojnë në rang ndërkombëtar dhe kombëtar. Në çdo bashki u formuan dy fokus grupe: një me migrantë dhe një me persona kyç.

Në çdo bashki, kampioni përbëhej nga të rritur që ishin migrantë që kishin kryer një apo më shumë lloje migracioni që prekin vendin, të afërmit e migrantëve, dhe persona kyç. Të afërmit dhe anëtarët e familjes së migrantëve paraqisnin interes për këtë studim pasi përfshirja e tyre do të ofronte një këndvështrim më të gjerë për arsyet e migracionit dhe pasojat e tij në të gjithë familjen. Në këtë grup përfshiheshin partnerët e migrantëve, fëmijët, prindërit, si dhe të afërmit që kujdeseshin për fëmijët e lënë në Shqipëri gjatë kohës që prindërit e tyre punonin jashtë vendit. Për karakteristikat e kampionit janë ofruar më shumë hollësi në Aneksin 3.

Grupi i personave kyç përbëhej nga zyrtarët që punonin në fushën e migracionit, mbrojtjes dhe mirëqenies sociale për fëmijët dhe familjet. Krahas kësaj, u morën në intervistë edhe përfaqësuesit e organizatave të mëdha fitimprurëse dhe jofitimprurëse që ndodheshin në Tiranë. Analiza e modeleve kombëtare të paraqitura në këtë raport mbështetet kryesisht në intervistat me politikëbërësit dhe zbatuesit, dhe i referohet strategjive dhe programeve kryesore që janë miratuar, sipas rastit, transformimit të tyre sipas rrethanave aktuale.

Tabela 1. Hollësitë e kampionit

Bashkia	Migrantët		Pjesëtarët e familjes		Personat kyç	Gjithsej
	F	M	F	M		
Shkodër	6	9	10	2	11	38
Lezhë	3	11	5	8	9	36
Tiranë	-	-	-	-	15	15
1) kombëtar						
2) vendor	5	5	12	11	8	41
Fier	6	4	3	8	8	29
Korçë	9	1	14	21	9	54
Gjithsej (pjesëmarrësit)	29	30	44	50	60	213
	59		94			

Për sa i përket **procedurave** dhe **afatit**, puna në terren u krye në periudhën 30 maj - 28 qershor 2016 nga dy studiuesit kryesorë dhe nga studiuesit vendorë në çdo bashki (deri në fund të qershorit). Intervistat u realizuan nëpërmjet takimeve ballë për ballë dhe nëpërmjet emailit. Intervistat ballë për ballë zgjatën afërsisht një orë dhe u regjistruan në formën e shënimeve, përveç një sërë intervistash në Shkodër dhe Lezhë që u regjistruan dhe u zbardhën plotësisht. Secili fokus grup përbëhej nga 5-7 persona, ku futeshin migrantë të grupeve të ndryshme, të afërmit e migrantëve, si dhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore dhe të OJF-ve.

Të gjitha intervistat me fokus grupet u kryen duke garantuar fshehtësi dhe anonimitet të plotë. Të gjithë të intervistuarve iu dha një fletë informacioni dhe formular pëlqimi, ndërsa personat kyç u pyetën nëse dëshironin të identifikoheshin në raport apo parapëlqenin që të ruhej fshehtësia e deklaratave të tyre.

Si studimi, ashtu edhe raporti në fjalë kanë një sërë **kufizimesh**. Intervistat dhe fokus grupet u kryen sipas planit. Megjithatë, në Fier u ngrit vetëm një fokus grup, ndërsa në Tiranë dhe Lezhë u bënë më pak intervista me persona kyç nga ato që parashikoheshin. Megjithatë, numri i madh i intervistave që u kryen në rang vendor e kompensuan këtë kufizim.

Për qëllim të këtij studimi, u ndërmorën kërkime për të gjitha llojet e migracionit, por megjithatë, për shkak të metodologjisë cilësore dhe karakterit afatshkurtër të punës në terren, llojet e ndryshme të migracionit nuk përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë në kampionin e marrë në intervistë. Pavarësisht synimit të ekipit të studiuesve të këtij studimi për të përfshirë edhe migrantët me kombësi joshqiptare, të gjithë migrantët dhe të afërmit e marrë në intervistë ishin qytetarë shqiptarë, ndërsa intervistat me personat kyç ishin burimi i vetëm për mbledhjen e të dhënave për migrantët me kombësi joshqiptare.

Për shkak të kohës së kufizuar në dispozicion, u vendos që fëmijët të mos përfshiheshin drejtpërdrejtë në kërkim, pasi koha e pamjaftueshme do të pengonte pjesëmarrjen e sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve nëpërmjet punës në terren. Megjithatë, Terre des hommes dhe partnerët e saj i kanë përfshirë rregullisht dhe gjerësisht fëmijët e prekur nga migracioni në kuadrin e kërkimeve të tjera me tema të ngjashme, si dhe në projekte që lidhen me këto veprimtari. Kështu, pjesë e kërkimit në fjalë është edhe informacioni i përfutur drejtpërdrejt nga fëmijët në kuadrin e konteksteve të tjera.

Megjithatë, për shkak të metodologjisë së përdorur dhe të informacionit të kufizuar për migracionin e fëmijëve në Shqipëri, ky raport përqendrohet kryesisht në situatën e fëmijëve e të rriturve dhe fëmijëve që kryejnë migracion hyrës, dalës dhe të brendshëm në vend, vështirësitë që hasin, dhe masat e miratuara për t'i ndihmuar dhe mbrojtur ata dhe fëmijët e tyre. Në vijim të këtij studimi, Terre des hommes synon të kryejë dhe mbështesë kërkimet e mëtejshme me në qendër fëmijën për situatën e fëmijëve në lëvizje në Shqipëri.

3. Migracioni dhe mbrojtja sociale: Zhvillimet dhe reagimet më të fundit kombëtare

Pavarësisht se është një vend tejet i prekur nga migracioni dhe ndonëse kjo dukuri është trajtuar nga strategji dhe plane të mëparshme veprimi për migracionin, Shqipëria nuk ka të dhëna të sakta dhe sistematike për migracionin. Përfundimi i sistemit të adresave dhe krijimi i një regjistri për emigrantët, që priten të përfundohen brenda vitit 2017, mund ta zvogëlojnë pjesërisht këtë hendek.¹⁸ Institucioni përgjegjës për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për migracionin në rang kombëtar është Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), ndërsa INSTAT-i, Instituti i Statistikave, përpilon rregullisht të dhëna, duke u mbështetur në punën e zyrave të tij rajonale, që ndodhen në bashkitë kryesore, dhe kanë si qëllim parësor mbledhjen e të dhënave.

Meqenëse emigrantët shqiptarë nuk janë regjistruar në mënyrë sistematike kur janë larguar nga vendi, dhe për shkak se nuk ka pasur shumë përpjekje për ta regjistruar largimin e tyre tek autoritetet vendore, përdorimi i “metodave të tërthorta” vazhdon të jetë mënyra kryesore për të pasur një mesatare të individëve, që kanë emigruar gjatë dekadave të fundit¹⁹. Mungon mbledhja sistematike e të dhënave, veçanërisht në lidhje me lëvizjen e qytetarëve shqiptarë, të cilët kryesisht migrojnë për punë, drejt vendeve fqinje dhe të tjera.

Në të njëjtën kohë, në vendin tonë nuk janë kryer studime periodike për numrin dhe situatën e migrantëve të kthyer. Ndikimi i këtyre kthimeve në tregun vendas të punës nuk është analizuar mjaftueshëm, dhe nuk është shqyrtuar siç duhet situata lidhur me aftësinë për punësim të migrantëve të kthyer për sa i përket vendimit që ata marrin për të emigruar sërish.

Situata e mësipërme kufizon në mënyrë të konsiderueshme mundësinë për të hartuar politika të sigurta dhe të mbështetura në fakte për migracionin në Shqipëri.

Intervistat me politikëbërësit dhe ekspertët e rangut kombëtar treguan se çështjet më të diskutuara për migracionin janë numri në rritje i shqiptarëve që aplikojnë për azil në Evropën Perëndimore për arsye ekonomike dhe fluksi i refugjatëve në Shqipëri (dhe plani përkatës i emergjencës). Për këtë arsye, ky kapitull përqendrohet kryesisht në dy çështjet e mësipërme, të cilat analizohen në aspektin e rreziqeve të mundshme dhe mundësive që kanë migrantët e përfshirë. Përveç kësaj, ai shqyrton kapacitetin dhe sfidat e institucioneve ekzistuese, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e migracionit dhe ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për migrantët në fjalë, në një kuadër më të gjerë të reformave të nevojshme për procesin e aderimit në BE.

¹⁸ Intervistë me Znj. Ermira Galanxhi, Drejtore e Institutit të Statistikave, INSTAT

¹⁹ http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013.pdf

Kutia 3. 1: Ligje dhe politika lidhur me migracionin dhe mbrojtjen sociale në Shqipëri

Ligjet dhe politikat e migracionit janë ndër më të rejat dhe më të ndryshueshmet në kuadrin ligjor dhe politik shqiptar. Deri në vitet 1990, emigracioni konsiderohej krim. Imigracioni kontrollohej rreptësisht dhe vetëm një numër i kufizuar njerëzish, që mbështesnin pikëpamjet zyrtare politike, kishin të drejtë të imigronin. Edhe migracioni i brendshëm ishte tepër i kufizuar. Të gjendur përballë një prej skenarëve më shpërthyes të migracionit, që prej fillimit të viteve 1990, Shqipëria hartoi këto ligje dhe politika për t'iu përgjigjur fluksit të lartë të migracionit, por edhe në lidhje me pritshmëritë, kushtet dhe trysinë e ushtruar nga vendet e tjera dhe BE-ja, drejt së cilave migrojnë qytetarët shqiptarë. Ligjet dhe politikat për migracionin u janë nënshtruar rishikimeve të shpeshta në mënyrë që të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së. ONQ-të dhe OJFN-të kanë luajtur, dhe deri diku, vazhdojnë të luajnë edhe sot një rol të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e politikave të migracionit në Shqipëri

Në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në disa dokumente ligjore që rrjedhin prej saj janë përfshirë dispozita të qarta për migracionin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve. Në Kushtetutë²⁰ parashikohet, ndër të tjera, detyra e shtetit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të qytetarëve shqiptarë jashtë kufijve (neni 8), mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e banorëve të huaj (neni 16), lirinë për të zgjedhur banesën e tyre (neni 39), si dhe të drejtën e qytetarëve të huaj për strehim (neni 40). Domosdoshmëria për mbrojtjen e fëmijëve në kuadrin e migracionit rrjedh nga neni 54, i cili parashikon mbrojtje të veçantë të fëmijëve, të rinjve dhe femrave nga shfrytëzimi dhe abuzimi.

Ligji kryesor kombëtar për rregullimin e **emigracionit** është ligji nr. 9668/2006²¹ (i rishikuar me ligjin nr. 10389, datë 03.03.2011) "*Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për arsye punësimi*". Qëllimi i këtij ligji është kujdesi, mbrojtja dhe ruajtja e identitetit kombëtar të qytetarëve shqiptarë, si dhe ruajtja dhe forcimi i lidhjeve me vendin e tyre gjatë kohës që punojnë jashtë Republikës së Shqipërisë. Ky ligj i jep të drejtën qytetarëve shqiptarë të punojnë jashtë kufijve në përputhje me ligjet kombëtare dhe me ligjet e vendit të destinacionit. E drejta e punësimit sigurohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe të negociuara dhe të nënshkruara nga MMSR-ja. Ligji parashikon gjithashtu mundësinë për të gjetur punë jashtë vendit nëpërmjet agjencive private të punësimit, të licencuara nga MMSR-ja. Zbatimi i këtij ligji kërkon akte të qarta nënligjore në bazë të bashkëpunimit ndërmjet MMSR-së, MPB-së dhe MPJ-së. Megjithatë, deri më sot, këto akte janë miratuar me shumë kufizime.

Me vendosjen dhe rritjen e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, u miratuan ligje të tjera, në mënyrë që të rregullojnë shtrirjen e shërbimeve që do të sigurohen nga shteti shqiptar për këto komunitete. Mbështetur në ligjin nr. 23/2015 "*Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë*", shërbimet diplomatike dhe këshillimore shqiptare duhet të mbrojnë interesat dhe të drejtat ligjore të emigrantëve shqiptarë. Literatura e gjerë për migracionin shqiptar ka treguar se këto shërbime nuk kanë qenë të efektshme në të shkuarën (shih Vullnetari 2007 për rishikim). Roli i këtyre shërbimeve këshillimore ka qenë më i efektshëm për sa i përket shërbimeve të menjëhershme për migrantët shqiptarë.

²⁰ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kushtetuta_e_republikes_se_shqiperise_1298.pdf

²¹ http://www.pp.gov.al/web/ligj_per_emigrimin_36.pdf

Mbështetur në ligjin nr. 10129/2009 "*Për gjendjen civile*" (i rishikuar)²², Konsullatat Shqiptare lëshojnë certifikata dhe pasaporta për qytetarët shqiptarë në shtatë vende²³, përfshirë këtu Italinë, Greqinë, Britaninë e Madhe dhe SHBA-në. Sipas të njëjtit ligj, MPJ-ja dhe Instituti i Diasporës janë të detyruar të mbështesin mësimdhënien e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare për fëmijët me origjinë shqiptare që jetojnë jashtë vendit.

Më tej, sipas ligjit nr. 10389/2011, MMSR-ja duhet të mbështesë emigrantët e kthyer në Shqipëri duke u ofruar ndihmë sociale dhe lehtësuar aksesin në shërbimet mbështetëse të riintegritimit në vend. Këta migrantë gëzojnë të drejtën për mbrojtje sociale dhe financiare, bashkim familjar, dhe përjashtohen nga detyrimet dhe taksat në kufirin kombëtar. Ata gjithashtu kanë të drejtë të përfitojnë orientim për punë dhe formim profesional falas, si dhe arsim e strehim. Statusi i emigrantit u jepet migrantëve të kthyer, nga MMSR-ja, pasi të kenë qëndruar të paktën një vit jashtë vendit.

Ligji nr. 9861/2008 "*Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror*" dhe ligji nr. 108/2013 "*Për të huajt*" janë dy ligjet kryesore që rregullojnë **imigracionin** e qytetarëve të huaj në Shqipëri. Ligji "*Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror*"²⁴ parashikon procedurat për kalimin e kufirit, rolet dhe detyrat e Policisë Kufitare, procedurat që duhen ndjekur për emigrantët dhe migrantët që hyjnë ose qëndrojnë në mënyrë të parregullt, duke përfshirë azilkërkuesit, viktimat e trafikimit dhe fëmijët e pashoqëruar. Ligji më i fundit "*Për të huajt*"²⁵ parashikon kushtet për hyrjen, qëndrimin, kthimin, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve të huaj, si dhe autoritetet përgjegjëse për imigracionin në Shqipëri. Ligji nr. 121/2014 "*Për azilin në Republikën e Shqipërisë*"²⁶ përcakton kushtet dhe procedurat për dhënien dhe refuzimin e azilit, të drejtat dhe detyrat e azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, aksesin në shërbime dhe integrimin e refugjatëve në Shqipëri. Përpos kësaj, ligji nr. 8389/1998 "*Për shtetësinë shqiptare*" rregullon marrjen e shtetësisë Shqiptare (neni 6), nëpërmjet lindjes, natyralizimit pas pesë vjetësh qëndrimi të vazhdueshëm në Shqipëri (parashikuar në nenin 9), dhe birësimit nga qytetarët shqiptarë.

Ligji i ri nr. 121/2016 "*Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë*" zgjeron ndihmën e ofruar për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, përtej ndihmës në të holla që është dhënë në të shkuarën. Në veçanti, ky ligj parashikon një gamë shërbimesh të reja, duke përfshirë: shërbimet parashoqërore, shërbimet në qendrat e komunitetit, shërbimet rezidenciale (duke përfshirë strehimin), shërbimet sociale në raste emergjence, kujdes alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, këshillim dhe nëpërmjet internetit dhe telefonit, si dhe shërbime të tjera të specializuara. Ligji përmend drejtpërdrejt ndër përfituesit e shërbimeve të sipërpërmendura shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët ose përfituesit e mbrojtjes shtesë.

Lidhur me **mbrojtjen e fëmijëve** në rast migracioni, ligji nr. 10347/2010 "*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*" është një kuadër ligjor që parashikon respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e tyre. Ky ligj parashikon të drejtën

²² <http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/07/LIGJ-Nr.-10-129-dat%C3%AB-11.5.2009-P%C3%8BR-GJENDJEN-CIVILE.pdf>

²³ Fakt i deklaruar në takimin me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Konsullor Z. Gazmend Barbullushi.

²⁴ <http://www.infocip.org/al/?p=6833>.

²⁵ http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/13-11-14-04-05-08ligji_per_te_Huajt.pdf.

²⁶ https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014_19228_11.pdf.

e jetës, emrit dhe kombësisë, e të qenit me prindërit dhe familjen, kthimit të sigurt, lirisë së shprehjes, arsimimit, kohës së lirë, kushteve të përshtatshme të jetesës dhe kujdesit shëndetësor, mbrojtjes nga: dhuna, shfrytëzimi, përdorimi i drogës, trafikimi dhe konfliktet e armatosura, torturimi dhe arrestimi, si dhe të drejtën për kujdes alternativ.

Dispozita më specifike ligjore për mbrojtjen e fëmijëve janë të përfshira në Udhëzimin Ndërmintor të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, Ministrit të Shëndetësisë, dhe Ministrit të Punëve të Brendshme, për Bashkërendimin e Veprimtarive për Mbrojtjen e Fëmijëve (nr. 10, datë 25. 02. 2015) dhe në Planin e Veprimit për Fëmijët 2012-2015, që mbulon fushat e qeverisjes që merr parasysh mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet cilësore për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet e përshtatshme për fëmijët, dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje. Për më tepër, Axhenda Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve 2016-2020, e cila gjatë kohës së këtij kërkimi ishte duke u hartuar, do të përqendrohet në zhdukjen e dhunës ndaj fëmijëve, ngritjen e shërbimeve të përshtatshme për fëmijët dhe në qeverisjen e të drejtave të fëmijëve.

Në mënyrë të ngjashme me kuadrin ligjor për migracionin, Shqipëria po zhvillon më tej kuadrin ligjor për mbrojtjen e fëmijëve, që do të parashikojë disa dispozita të lidhura veçanërisht me fëmijët në lëvizje ose të prekur nga migracioni. Ligji nr. 10347/2010 "*Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*" po rishikohet dhe pritet të përfshijë edhe të drejtat dhe procedurat për fëmijët e kthyer nga migracioni, të trajtojë situatën e fëmijëve që punojnë në rrugë dhe shfrytëzimin e mundshëm të tyre. Ky ligj i ri duhet të jetë më gjithëpërfshirës, meqenëse duhet të zbatohet për fëmijët me kombësi shqiptare (brenda ose jashtë Shqipërisë), si dhe për fëmijët e huaj dhe pa shtetësi.²⁷

Në kuadrin aktual ligjor, ekzistojnë disa dispozita të veçanta për fëmijët e pashoqëruar, ndryshe nga grupet e tjera të fëmijëve migrantë. Këta fëmijë janë përmendur në ligjin "*Për të huajt*" dhe në ligjin "*Për azilin*", pavarësisht faktit se këto ligje u referohen fëmijëve të pashoqëruar që hyjnë në Shqipëri dhe nuk përmendin fëmijët e pashoqëruar me kombësi shqiptare që kthehen në vend. *Ligji për kufirin*, i cili zbatohet nëpërmjet dy akteve nënligjore²⁸, parashikon procedurën për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës për fëmijët e pashoqëruar nga Shqipëria në situatë kufitare. Ky ligj parashikon disa masa mbrojtëse dhe sigurie për këtë grup të veçantë fëmijësh, të tilla si përdorimi i paraburgimit si masë e fundit, gjurmimi i familjes, identifikimi dhe referimi tek autoritetet përgjegjëse. Përpos kësaj, sipas nenit 36, policia kryen kontrole të hollësishme kur dyshojnë se një fëmijë po largohet nga kujdestaria e prindërve ose kur fëmija është i pashoqëruar. Neni 16 i ligjit nr. 121/2014 "*Për azilin*" nënvizon faktin se fëmijëve të pashoqëruar që hyjnë në Shqipëri si azilkërkues duhet t'iu caktohet një kujdestar ligjor dhe kërkesës së tyre t'i jepet përparësi. Si përfundim, ligji për emigrimin parashikon se fëmijët migrantë duhet të kthehen në mënyrë të sigurt.²⁹

27 Intervistë me Znj. Ina Verzivolli, Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, që i referohet Projektligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

28 Urdhër i Brendshëm i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. 643, datë 17. 12. 2013 "*Për marrjen e masave për ripranimin në Shqipëri të të miturve të pashoqëruar, verifikimin dhe fillimin e hetimeve në rastet kur prindërit apo kujdestarët ligjorë nuk përmbushin detyrimet ligjore*"; Udhëzim i Përbashkët i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror, Nr. 332/3, datë 07. 03. 2014 "*Për marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e tjera*"

29 Neni 24 i ligjit për emigracionin.

3. 1. Emigracioni

Emigracioni në Shqipëri ka disa forma. Ai ka qenë kryesisht i jashtëligjshëm³⁰ për një kohë të gjatë, sepse pak migrantë kanë pasur mundësi të migrojnë në mënyrë të ligjshme për qëllime studimi, pune, apo bashkime familjare. Megjithatë gjatë dekadave të fundit një numër i madh emigrantësh kanë arritur të integrohen në vendet e reja të qëndrimit, veçanërisht në Itali³¹, mundësitë që kanë qytetarët shqiptarë për migracion të ligjshëm janë ende të kufizuara.

Liberalizimi i regjimit të vizave në vitin 2010 ka ndryshuar modelin dhe dinamikën e emigracionit, meqenëse shtetasit shqiptarë tashmë kanë leje të plotë për të lëvizur në hapësirën Schengen të BE-së deri në 90 ditë pa pasur nevojën e një vize³². Kjo e drejtë lëvizjeje, nuk ka të bëjë me mundësinë për t'u punësuar në BE. Megjithatë, emigracioni tani bazohet shumë në këtë lloj lëvizjeje dhe përhapet në disa forma, duke përfshirë kryesisht përpjekjen për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare për arsye ekonomike, dhe, në disa raste për shkak të gjakmarrjes, trafikimit, dhe migracionit tranzit drejt vendeve të tjera që nuk janë pjesë e hapësirës Schengen, të tilla si në Mbretërinë e Bashkuar.

Që prej liberalizimit të vizave, në Shqipëri ka pasur emigracion masiv, duke përfitur nga liria e lëvizjes, si dhe kthime masive nga vendet pritëse. Këto valë kanë qenë veçanërisht të mëdha që prej vitit 2015. Në veçanti, kërkesat për azil në vendet e BE-së për arsye ekonomike të qytetarëve shqiptarë kanë qenë shpesh temë diskutimesh ndërmjet vetë migrantëve dhe zyrtarëve. Të dhënat zyrtare janë të kufizuara për shkak të karakterit të ri dhe dinamik, por, burime nga MMSR-ja dhe UNCHR-ja³³ pohojnë se 68,500 qytetarë shqiptarë kanë emigruar në këtë mënyrë gjatë vitit 2015. Mesa duket, kësaj forme të re migracioni i është dhënë përparësi në programin e politikëbërësve shqiptarë, meqenëse ka të bëjë me procesin e liberalizimit të vizave, i cili është pjesë e procedurave të anëtarësimit të vendit në BE.

Kutia 3. 2.: Numri i të kthyerve pas kërkesave të refuzuara për azil

Ky lloj kthimi u rrit në fund të vitit 2015 dhe në fillim të vitit 2016. Sipas të dhënave nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, numri i qytetarëve shqiptarë të kthyer nga vendet evropiane në gjysmën e dytë të vitit 2015 ishte 20,766 ndërsa në gjysmën e parë të vitit 2016 ishte 7,544. Nga 20,776 të kthyer në vitin 2015, 1,169 ishin femra (20 prej të cilave ishin fëmijë) ndërsa 11,916 ishin meshkuj (127 prej të cilëve ishin fëmijë). Nga 7,544 persona të kthyer vullnetarisht në vitin 2016, 5802 ishin të rritur ndërsa 1,742 ishin fëmijë. Vetëm në janar të vitit 2016, numri i qytetarëve shqiptarë të kthyer arriti në 2,807, prej të cilëve 1,224 u kthyen vullnetarisht ndërsa 1,583 iu nënshtruan kthimit të detyruar nga hapësira Schengen e BE-së.

³⁰ Russell King, "Përtej detit dhe matanë maleve: Dokumentimi i migracionit shqiptar", për revistën Scottish Geographical Journal Vol. 119, Iss. 3, 2003, <http://dx.doi.org/10.1080/00369220318737179>

³¹ Zana Vathi, *Migrating and Settling in a Mobile World. Albanian Migrants and their Children in Europe*, 2015 (<http://link.springer.com/book/10.1007%2F978-3-319-13024-8>)

³² https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/jha/117555.pdf

³³ <http://www.unhcr.org/uk/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html>

Nëpërmjet kërkesës për azil për arsye ekonomike, shumë familje shfrytëzojnë mundësinë për të provuar dhe për të marrë statusin e refugjatit në Gjermani dhe vende të tjera të pasura të BE-së. Krahasuar me vitet 1990, kur njerëzit rrezikonin jetën e tyre gjatë udhëtimit, kjo formë migracioni nuk paraqet shumë rreziqe për jetën dhe sigurinë e personave që e provojnë. Megjithatë, zyrtarët qeveritarë³⁴ e përmendin shpesh rolin që kanë kontrabandistët në krijimin e kushteve që mundësojnë migracionin, ata nuk kanë prova të mjaftueshme për ta vërtetuar këtë argument.

3.2. Imigracioni

Gjatë hartimit të këtij raporti, Shqipëria nuk ishte shumë e prekur nga fluksi hyrës i refugjatëve në Evropë dhe në Ballkanin Perëndimor, por numri i tyre u rrit shumë shpejt në rajon që nga fillimi i vitit 2015 deri në fillim të vitit 2016. Kjo mund të shkaktohej pjesërisht nga kushtet socioekonomike në vend, të cilat nuk konsiderohen të kënaqshme, si dhe prej ndryshimeve në dinamikën dhe devijimin e flukseve në rajon, kryesisht në rritjen e migracionit kombëtar, dërgimin e informacioneve nga Ballkani Perëndimor në BE, dhe marrëveshjes midis BE-së dhe Turqisë. Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit, të cilat janë përballur me flukse hyrëse masive si dhe një numër të madh aplikimesh për azil, në Shqipëri këto flukse kanë marrë formën e devijimeve të itinerareve. Megjithatë, përfaqësues të Drejtorisë së Migracionit raportojnë se në 5 vitet e fundit, imigracioni i jashtëligjshëm është bërë një temë shqetësuese për autoritetet në rang kombëtar³⁵.

Në përgjithësi, vihen re tre situata të ndryshme në lidhje me popullsinë e migrantëve dhe refugjatëve që hyjnë në Shqipëri. Disa persona hyjnë në vend dhe aplikojnë për azil, ndërsa një tjetër grup njerëzish kalojnë kufirin dhe qëndrojnë në territorin e Shqipërisë ose kalojnë përmes tij pa raportuar tek autoritetet. Si përfundim, disa migrantë ose refugjatë që hyjnë në Shqipëri, por nuk paraqesin kërkesë për azil, arrestohen nga autoritetet dhe dërgohen në qendrat e paraburgimit me akuzën e të qenit migrant me qëndrim të parregullt.

Kutia 3.3: Fluksi i refugjatëve në Shqipëri shprehur në shifra³⁶

Sipas MPJ-së, gjatë vitit 2015 numri i regjistruar i migrantëve dhe refugjatëve që hynë në Shqipëri ishte 2,047 (më i vogël se numri i qytetarëve të huaj të regjistruar zyrtarisht në të njëjtën periudhë në vitin 2014 kur numri ishte 2,618 gjithsej). Në periudhën korrik-dhjetor 2015, numri i migrantëve që janë përpjekur të kalojnë përmes Shqipërisë ka qenë 88, një numër ky më i madh se ai i regjistruar në muajin dhjetor (73). Shumica e atyre që kaluan kufirin në mënyrë të paligjshme në periudhën janar – dhjetor vinin nga Siria (1,354), e ndjekur nga Eritrea (171), Somalia (118), si dhe nga Pakistani dhe Afganistani. Në vitin 2016, tek autoritetet përkatëse shqiptare u paraqitën 274 kërkesa për azil, prej të cilëve 11 individëve iu dha statusi i refugjatit, ndërsa 10 individë përfituan mbrojtje plotësuese.³⁷

³⁴ Intervistë me Znj. Elona Gjebrea, Ministria e Punëve të Brendshme. Në përgjithësi, sipas përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore dhe ONQ-ve të intervistuar si pjesë e kërkimit, për shkak të mungesës së informacioneve për sistemet e azilit dhe mundësitë e vërteta për të përfituar mbrojtje ndërkombëtare, individët ose familjet që ndërmarrin këtë rrezik për të rënë pre e trafikantëve dhe shfrytëzuesve gjatë rrugëtimit.

³⁵ Intervistë me Znj. Esmeralda Toska, Drejtoria e Migracionit

³⁶ Intervistë me Znj. Enkeleda Toska, Drejtoria e Migracionit, Ministria e Punëve të Brendshme

³⁷ Intervistë me Alma Mele, Drejtoria e Azilit, Ministria e Punëve të Brendshme

Nga 3 tetori 2016, numri i përgjithshëm i migrantëve të identifikuar duke hyrë në mënyrë të parregullt në Shqipëri ishte 691³⁸. Në Shqipëri u regjistruan migrantë dhe refugjatë nga 12 shtete të ndryshme: 45 nga Maroku, 19 nga Siria, 14 nga Somalia, 12 nga Pakistani, 13 nga Afganistani, 5 nga Algjeria, 2 nga Palestina, 2 nga Irani, 1 nga Iraku, 3 nga Eritrea, 2 nga Libia dhe 1 nga Mali³⁹.

Bazuar në shifrat e mësipërme, është e vështirë të identifikohen prirjet specifike të fluksit të migracionit si edhe të parashikohen prirjet e ardhshme që mund të prekin Shqipërinë. Megjithatë, mendohet se numri i madh i refugjatëve dhe migrantëve që hyjnë në mënyrë të parregullt është shumë më i lartë se shifrat zyrtare, dhe se shumica e tyre nuk identifikohen⁴⁰.

Në planin politik, trysnia që ushtrojnë këto flukse në Shqipëri është e shumëfishtë. Autoriteteve shqiptare iu kërkohet nga disa shtete anëtare të BE-së t'i ndalojnë dhe t'i devijojnë këto flukse në një periudhë afatshkurtër para se të arrijnë në Evropën Perëndimore me arsyetimin se rrjeti i krimit të organizuar mund të lulëzojë sërish nëpërmjet rrugëve detare të Adriatikut⁴¹.

Në planin e brendshëm, këto flukse krijojnë vështirësi në infrastrukturën dhe shërbimet e imigracionit, të cilat janë ende të pazhvilluara.

3.3. Reagimi institucional, koordinimi dhe kapaciteti

Institucionet kryesore përgjegjëse për menaxhimin e migracionit në rang kombëtar në Shqipëri janë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) dhe Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ).

MPB-ja kontrollon Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Kufitare dhe e Migracionit, Drejtorinë e Azilit, dhe Koordinatorin Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz. Policia Kufitare dhe e Migracionit është një institucion i rëndësishëm, sepse ka disa detyra, ku përfshihen: kontroll i procedurave të vizave, vendimmarrja për hyrjen dhe qëndrimin, dhënia e leje vetë banimit, mbikëqyrja e kthimit vullnetar dhe të detyruar, ripranimi dhe referimi i migrantëve, identifikimi dhe ofrimi i ndihmës për fëmijët e pashoqëruar, viktimat e trafikimit, azilkërkuesit dhe personat pa shtetësi. Institucioni i Policisë Kufitare dhe e Migracionit përbëhet nga një drejtori e përgjithshme dhe 7 drejtori rajonale. Policia Kufitare është gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë së Integruar për Menaxhimin e Kufirit (2014-2020).

Për shkak të pranisë së trafikimit të qenieve njerëzore si jashtë ashtu edhe brenda kufijve të Shqipërisë, MPB-ja ka krijuar pozicionin e Koordinatorit Kombëtar për Luftën Kundër Trafikimit në Njerëz. Ky institucion ka dy drejtori, përkatësisht Drejtoria e Antitrafikut dhe Drejtoria e Azilit. Me regjistrimin e popullsisë në gjendjen civile, duke përfshirë edhe fëmijët e lindur jashtë vendit nga prindër shqiptarë, merret posaçërisht Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile e MPB-së.

³⁸ <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-facing-flow-of-refugees-as-transit-country-09-30-2016>

³⁹ Intervistë me Znj. Alma Mele, Drejtorja e Azilit

⁴⁰ Intervistë me IOM

⁴¹ <http://www.balkaninsight.com/en/article/italy-to-help-albania-in-securing-borders-03-15-2016>

MMSR-ja kontrollon Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), Drejtorinë e Migracionit dhe Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Ajo është përgjegjëse për punësimin e qytetarëve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, si dhe riintegrimin dhe punësimin e shqiptarëve të ripranuar. Ajo gjithashtu jep leje pune për shtetas të huaj, nënshkruan marrëveshje për punësimin dhe mbrojtjen sociale, si dhe menaxhon politikën për migracionin. Drejtoria e Migracionit po zbaton Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (2014-2020), e cila ndjek Strategjinë për Riintegrimin e Migrantëve Shqiptarë të Kthyer (SRMSHK) 2012-2015.

MPJ-ja është përgjegjëse për politikën e vizave, sigurimin dhe promovimin e të drejtave të të huajve në Shqipëri, negocimet e marrëveshjeve për migracionin me vendet e tjera, mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë, organizimin e Diasporës Shqiptare dhe riatdhesimin e rregullt të qytetarëve shqiptarë duke përfshirë fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë. Ajo kontrollon shërbimin këshillimor dhe Institucionin Kombëtar të Diasporës (IKD).

Përfaqësitë konsullore shqiptare iu ofrojnë migrantëve shqiptarë dhe azilkërkuesve mbështetje administrative, ligjore/gjyqësore. Këto institucione janë pjesë e MPJ-së dhe drejtohen nga ajo. Ligji për funksionimin e përfaqësive konsullore parashikon disa detyra për këto institucione, duke përfshirë: mbështetjen e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në raste vështirësish, fatkeqësish, ose zhvillimesh të politikave të dhunshme (neni 4); përfaqësimin ligjor (neni 6); mbrojtjen e trashëgimisë dhe interesit të pronës (neni 8); shqyrtimin e kërkesave për viza dhe shtetësi (neni 9-10); përditësimin e regjistrimit civil në rast lindjesh, martesash dhe vdekjesh (neni 11); dhe përkthimin, certifikimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet shqiptare (neni 12-15). Në këtë raport rëndësi të veçantë i kushtohet rolit të konsullatave shqiptare në lëshimin e certifikatave nga regjistri civil për qytetarët shqiptarë jashtë vendit. Siç është analizuar në seksionin 4, regjistrimi i fëmijëve të migrantëve shqiptarë është aktualisht një nga problemet më serioze për fëmijët e migrantëve të kthyer.

Në vijim të miratimit të SRMSHK-së, në menaxhimin e migracionit janë përfshirë institucione të tjera, të cilat janë:

- Ministria e Financave, e cila përfshihet në riintegrimin e të kthyerve duke i përjashtuar nga taksat dhe duke menaxhuar skemën vullnetare të daljes në pension;
- Ministria e Bujqësisë, e cila merret kryesisht me situatën e të kthyerve, që punësohen ose investojnë në sektorin bujqësor;
- Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS), e cila përgatit programet për mbështetjen e fëmijëve të migrantëve të kthyer.

Kuadri institucional në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve përbëhet nga Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës në rang vendor. Siç shihet edhe nga gjetjet e seksionit 3 dhe 4, institucionet e mbrojtjes së fëmijës janë të reja dhe veprimtaria e tyre është ende në zhvillim, ndërkohë që ka ende një farë pasigurie për sa i përket juridiksionit të tyre për çështjet e migracionit.

Politikat kyçe që lidhen me migracionin gjenden në strategjitë e mëposhtme qeveritare: *Për Punësimin dhe Aftësi (2014-2020)*, *Për Riintegrimin e Refugjatëve Shqiptarë (2010-2015)*, *Për Politikën e Migracionit (2005-2015)*, *Për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (2014-2020)*, *Për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2014-2017)* dhe në *Planin e Veprimit për Fëmijët (2005-2010)*.

Strategjia e fundit Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) mbulonte periudhën 2005-2010. Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013, të miratuar nga Qeveria e Shqipërisë thuhet se “vizioni i strategjisë është sigurimi i një politike të plotë për migracionin, kalimi nga një politikë që është përqendruar kryesisht te luftimi i flukseve të paligjshme drejt një politike të mbështetur te ngritja dhe funksionimi i një sistemi funksional kombëtar për menaxhimin e migracionit.”

Objektivat kryesore të politikave më të fundit të migracionit të miratuara në Shqipëri ishin: reduktimi i emigracionit të parregullt, menaxhimi i fluksit të imigracionit, krijimi i mundësive për emigracion të rregullt, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve, dhe transformimi i migracionit në një mjet zhvillimi për Shqipërinë.

Më tej, për të mbrojtur dhe mbështetur punësimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit, qeveria shqiptare ka nënshkruar marrëveshje punësimi me një sërë vendesh (me Katarin në vitin 2014, Italinë në vitin 2008 dhe Gjermaninë në vitin 2012). Janë nënshkruar marrëveshje për mbrojtjen sociale të migrantëve me Hungarinë (2014) dhe Belgjikën (2014), por ende jo me Greqinë dhe Italinë. Duke marrë parasysh që Greqia dhe Italia janë ndër vendet kryesore pritëse të imigrantëve shqiptarë në Evropë dhe në botë, mungesa e marrëveshjeve me këto vende, siç shihet edhe në seksionin 4 të këtij raporti, është mjaft e rëndësishme, sidomos për të drejtat e migrantëve, si për ata që qëndrojnë atje, ashtu edhe për shumë të tjerë që janë kthyer dhe nuk kanë mundësi t'i transferojnë të gjitha kontributet e tyre të sigurimeve shoqërore në Shqipëri.

Mosdiskriminimi i punëtorëve shqiptarë në BE parashikohet edhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA, 2006). Në mbështetje të nenit 46 dhe 47 të MSA-së⁴², shtetasit shqiptarë të punësuar në mënyrë të ligjshme në vendet e BE-së nuk diskriminohen në lidhje me aksesin në punësim, pagë dhe kushte pune. Bashkëshortët dhe familjarët e migrantëve kanë të njëjtin akses në tregun e punës. Punëtorët sezonalë ose ata që punojnë mbi bazën e marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet qeverive nuk i gëzojnë këto të drejta.

Migracioni i kthimit dhe statusi i migrantëve të kthyer u rregulluan fillimisht nga SKM-ja, PKVM-ja, dhe së fundmi nga SKZHI-ja e re⁴³. Në këto dokumente theksohet kthimi dhe ripranimi i të dëbuarve dhe të kthyerve, dhe angazhimi i migrantëve tejet të kualifikuar. Dispozita më të hollësishme për të kthyerit janë përfshirë në SISHSHK-në 2010-2015, ku vihej në dukje mungesa e dispozitave të qarta për kthimin vullnetar ose për kategoritë të papërfshira në dy aktet e mëparshme, dhe rregullonin procedurat që duhen zbatuar për të kthyerit në fjalë. Gjithashtu, ajo parashikonte edhe detyrat dhe veprimtaritë për një sërë institucionesh si MPJ-ja dhe përfaqësuesit konsullorë që parashikohet të lehtësojnë kthimin e migrantëve dhe familjeve të tyre në Shqipëri duke shpërndarë informacion para kthimit të tyre. MPJ-ja koordinon shpërndarjen dhe vendosjen e standave të afishimit dhe materialeve të tjera në pikat kufitare për të njëjtin grup të të kthyerve. Edhe SHSSH-ja pritet të përfshihet në procesin e riintegritimit duke ofruar ndihmë psikologjike për të kthyerit. Në lidhje me fëmijët e ndarë dhe të pashoqëruar, roli i saj kryesor është gjurmimi i familjes së fëmijës dhe ndjekja në vijimësi e kthimit apo riintegritimit të tij/saj.

⁴² http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/Marreveshja_e_Stabilizim-Asocijimit.pdf.

⁴³ <http://www.adriapol.al/resources/National-Strategy-for-Development-and-Integration.pdf>

3.3.1. Menaxhimi i flukseve të reja të migrantëve dhe refugjatëve

Duke qenë se është përqendruar për një kohë të gjatë te emigracioni dhe trafikimi i qenieve njerëzore, Shqipërisë i mungon një kuadër dhe politikë gjithëpërfshirëse ligjore për imigracionin, gjë që do të analizohet më në hollësi në seksionin 4.

Institucioni kryesor përgjegjës për **identifikimin** e migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri është Policia Kufitare, që është enti që merr dhe shqyrton kërkesat për azil. Nëse migrantët nuk aplikojnë për azil, ata kthehen automatikisht në Greqi dhe nëse kthimi kryhet brenda 24 orëve, autoritetet shqiptare nuk nisin asnjë procedurë. Nëse Policia Kufitare i identifikon këto raste përtej kufirit, autoritetet ndërmarrin procedura administrative të parashikuara me ligj⁴⁴.

Sipas disa grupeve të interesit të marra në intervistë, infrastruktura ekzistuese ka mungesa në burime njerëzore si në numra, ashtu edhe për sa i përket specializimeve të nevojshme për të përballuar nevojat e ndryshme të këtyre migrantëve. Në të vërtetë, shqetësimi i parë që doli në pah nga intervistat është trysnia nën të cilën gjendet Policia Kufitare, gjë që mund të sjellë pasaktësi në procesin e shqyrtimit. Me rritjen e fluksit në vitet e fundit dhe me ndryshimin e tipareve të tyre demografike (më shumë gra dhe fëmijë), është shtuar vetëm një staf në rang kombëtar për të menaxhuar ngarkesën e punës së ndërlikuar dhe të shtuar të këtij institucioni.

Kështu, disa ONQ e kanë përqendruar punën e tyre së bashku me Policinë Kufitare në ofrimin e ndihmës për dy pikat kryesore kufitare të hyrjes dhe daljes, ndërsa OJF-të kanë mbështetur identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin në Korçë dhe Gjirokastrë (dy bashki jugore kufitare).

Një problem madhor në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për migrantët dhe refugjatët që hyjnë në Shqipëri, lidhet me **pritjen**. Shërbimet për refugjatët përqendrohen në dy pika kryesore: qendrën e pritjes për ata që aplikojnë për azil në Babrru, dhe qendrat e paraburgimit administrativ për ata persona që hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin e Shqipërisë dhe refuzojnë të plotësojnë një aplikim për azil në Kareç. Kapaciteti i qendrës së azilit në Babrru është 100-150 njerëz, për të cilën autoritetet shprehen se nuk është e mjaftueshme pavarësisht numrit të vogël të refugjatëve që hyjnë në Shqipëri. Qendra ka qenë funksionale për 10 vjet dhe kapaciteti i saj i vogël nuk ka paraqitur problem deri më tani për shkak të numrit të vogël të migrantëve dhe refugjatëve. Aksesit në shërbimet sociale për refugjatët e akomoduar në Babrru dhe për ata pak që janë akomoduar gjatë raportohet të jetë cilësor si nga përfaqësuesit e shtetit, ashtu edhe nga të OJF-ve në Tiranë.

Raportohet që rastet e familjeve me fëmijë, kryesisht shtetas sirianë, që kanë hyrë kohët e fundit në Shqipëri janë të pakta. Drejtoria për Azilin raportoi se në Babrru ndodheshin vetëm 11 fëmijë me familjet e tyre. Të gjithë fëmijët shkuan në çerdhe apo shkolla pavarësisht moshës së tyre dhe u ndihmuan shumë nga stafi i kësaj drejtorie. Migrantët që aplikuan për azil përfituan ndihmë financiare prej 7,000 lekësh në muaj, karta shëndeti për të pasur akses në shërbimet e ofruara nga shteti dhe akomodim falas nëpërmjet dhënies së statusit prej refugjati nga shteti shqiptar. Sipas zyrtarëve qeveritarë, kushtet në qendrën e Babrrusë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare duke përfshirë edhe ato për fëmijët. Avokati i Popullit vlerësoi se

⁴⁴ Intervista me Znj. Enkeleda Toska, Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit, Ministria e Punëve të Brendshme

kushtet ishin shumë më të mira krahasuar me qendrën e Kareçit, duke qenë se fëmijët në Babrru kanë akses në arsim dhe nënat ndjekin kurse të formimit profesional⁴⁵.

Gjithashtu, ka familje që lëvizin nga qendra pritëse në Babrru drejt vendstrehimeve më të pavarura, si psh apartamente të marra me qira. Duket se aksesin në shërbime për familjet e këtyre refugjatëve është në përgjithësi i mirë. Megjithatë, fëmijët refugjatë përballen me diskriminimin, duke qenë se mungesa e dokumentacionit pengon aksesin e tyre në arsim. Për më tepër, Avokati i Popullit raportoi se disa azilkërkues hasnin vështirësi në gjetjen e një pune, duke qenë se punëdhënësit shqiptarë parapëlqejnë kandidatët vendas.

Shumë pak vëmendje i kushtohet migrantëve me nevoja të mprehta, pra migrantëve të cilëve u është refuzuar statusi prej refugjati. Në qendrën e Babrrusë u caktua një ekspert ligjor për t'i ndihmuar, por mbështetja e ofruar duhet përmirësuar për t'u siguruar që migrantët të mos cenohen pasi të marri njoftim mbi vendimin e refuzimit.

Situata në qendrën e **paraburgimit** administrativ në Kareç është më shqetësuese, pasi është qendra e vetme funksionale për imigrantët e parregullt që nuk shprehin dëshirën për të dorëzuar aplikimin për azil. Kapaciteti i qendrës së Kareçit është 100 shtretër dhe flukset hyrëse më të fundit kanë krijuar krizë në akomodim. Për më tepër, sipas Avokatit të Popullit të Shqipërisë⁴⁶, qendra nuk ka psikologë, punonjës social dhe burime të aksesueshme në gjuhët amtare të migrantëve. Ndër problemet që raportohen nga të intervistuarit janë orët e kufizuara të ajrimit prej vetëm dy orësh, mungesa e televizorit dhe mospërputhja e dietës ushqimore me përkatësinë fetare të refugjatëve. Për shkak të kësaj situatë të varfër, raportohet një numër i madh i rasteve të largimit të migrantëve nga qendra e Kareçit pa raportuar autoritetet. Prandaj, nevojitet urgjentisht të kërkohet për alternativa të reja për paraburgimin, sidomos për fëmijët.

Migrantët e parregullt lejohen të qëndrojnë një muaj në Shqipëri, kohë gjatë së cilës kryhet e gjithë procedura. Në rast se ata nuk aplikojnë për azil, autoritetet shqiptare i kthejnë nëpërmjet marrëveshjeve të ripranimit. Aktualisht, të gjithë imigrantët e parregullt po mbahen në paraburgim, pasi alternativat e tjera të akomodimit janë shumë të pakta në numër, për të mos thënë që nuk ka, për shkak të mungesës së burimeve financiare.

Një problem tjetër thelbësor që prek integrimin e mundshëm të migrantëve dhe refugjatëve lidhet me **dokumentacionin**. Të gjithë ata që kanë statusin e refugjatit duhet të pajisen me karta identiteti me mikroçip. Megjithatë, lëshimi i kartave të identitetit dhe dokumenteve të udhëtimit është i kufizuar. Ligji parashikon një procedurë natyralizimi (ligji 8389/1998 *Për shtetësinë shqiptare*), por zgjat deri në pesë vjet. Në çdo rast, refugjatët nuk janë në gjendje të nisin procedurat, pasi kërkohen dokumentet origjinale nga vendi i origjinës, që ata nuk mund t'i marrin dot.

3.3.2. Ofrimi i ndihmës për të kthyerit

Tema e kthimit të migrantëve (afatgjatë) ekonomikë ishte parësore në rendin e ditës së qeverisë në periudhën 2010-2015 dhe u trajtua qartësisht dhe gjerësisht në Strategjinë Kombëtare për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015 dhe në Planin e saj të Veprimtimit (MMSR

⁴⁵ Intervistë me Z. Igli Totozani, Avokatin e Popullit

⁴⁶ Intervistë me Z. Igli Totozani, Avokatin e Popullit të Shqipërisë

2010). Sipas dispozitave të parashikuara në strategjinë dhe planin e mësipërm, migrantët e kthyer në Shqipëri mund t'i drejtohen Sporteve të Migracionit⁴⁷, që janë vendosur në Zyrat Rajonale të Punësimit, duke synuar të orientojnë dhe lehtësojnë aksesin e migrantëve në shërbimet e ndihmës sociale, strehim, formim profesional, punësim, ngritjen e bizneseve të reja dhe në ndihmë ligjore në lidhje me procedurat administrative dhe civile ku janë përfshirë. Sipas të dhënave të raportuara nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në MMSR, 4,957 qytetarë shqiptarë u janë drejtuar sporteve të migracionit për periudhën 2011-2015. Atyre iu janë ofruar shërbimet e mëposhtme: 2,752 qytetarë morën këshillim për punësim, 804 persona për orientim profesional, 1,056 persona morën informacion për shërbimet e kujdesit shëndetësor, 598 persona për ndihmë sociale, dhe 142 persona për ngritjen e bizneseve. 73% e migrantëve që iu drejtuan sporteve të migracionit ishin kthyer nga Greqia, 21% nga Italia, 2,8% nga vende të tjera të BE-së dhe 1,7% nga vende joanëtare të BE-së. Megjithatë, kërkimi nuk dha informacion për sa i përket rezultateve të shërbimeve të ofruara individëve që iu drejtuan sporteve të migracionit.

Vitet e fundit, ndihma e ofruar për të kthyerit iu ofrua kryesisht qytetarëve shqiptarë që kishin aplikuar për azil në vendet e BE-së, kërkesa e të cilëve u refuzua. Shumica dërrmuese e tyre u kthyen me dëshirë (ose e zbatuan me dëshirë urdhrin e kthimit) pasi kërkesa e tyre u refuzua, disa u dëbuan nga autoritetet e vendeve pritëse, ndërsa të kthyerit e tjerë u njohën si viktime të trafikimit, që janë kthyer normalisht në kuadrin e sistemeve të posaçme të bashkëpunimit transnacional ndërmjet vendeve të ndryshme.

Strategjia për riintegrimin e të kthyerve në Shqipëri përfundoi në vitin 2015, dhe ende nuk është ndërmarrë hartimi i një strategjie të re. Zyrtarët e MPB-së⁴⁸ u shprehën se bashkëpunimi transnacional do të jetë një nga pikat e para që do të trajtohet në Strategjinë e re Kombëtare për Migracionin që ndodhet aktualisht në proces hartimi, së bashku me bashkëpunimin institucional, një ndarje më e qartë e detyrave ndërmjet institucioneve qeveritare dhe trajtim i shkaqeve themelore për migracionin e pasigurt, kryesisht punësimin.

3.3.3. Caktimi i masave për ndihmën sociale

Pavarësisht faktit që janë ndërmarrë disa masa, intervistat me politikëbërës të ndryshëm në rang kombëtar tregojnë se mungesa e lidhjeve ndërmjet migracionit dhe mbrojtjes sociale, si dhe infrastruktura e dobët, e pengojnë efektshmërinë e reagimit të institucioneve kombëtare dhe vendore në Shqipëri ndaj migracionit. Zyrtarë nga ministri të ndryshme kanë raportuar se nevojitet një njësi koordinuese e migracionit për të shmangur reagime të copëzuara dhe dyfishim rolesh. Disa nga të intervistuarit sugjeruan krijimin e Ministrisë së Migracionit dhe Diasporës. Në përgjithësi, vihet re një mospërputhje ndërmjet dispozitave ligjore dhe rregulloreve, ku parashikohen shërbime të standardeve minimale për migrantët dhe përfitimin faktik të këtyre shërbimeve.

Disa politikëbërës në rang kombëtar u shprehën se nuk merrnin informacione të mjaftueshme lidhur me situatën e vërtetë, ku përfshiheshin edhe shërbimet që i ofrohen migrantëve nga organizata private. Megjithatë infrastruktura për të kryer kërkime në qeveri është e dobët,

⁴⁷ Shqip: Sportet e Migracionit

⁴⁸ Intervistë me Znj. Elona Gjerbrea, zv. Ministre e MPB-së

kapaciteti i organizatave ndërkombëtare në këtë fushë është shumë i vlefshëm. Kësaj i jepet më tepër rëndësi kur merret parasysh se pavarësisht punës së copëzuar të institucioneve qeveritare në Shqipëri, ONQ-të dhe OJF-të përqendrohen më tepër te çështjet sociale, dhe si rrjedhojë te propozimi i politikave më gjithëpërfshirëse.

SHSSH-ja në Shqipëri është institucion vartës i MMSR-së dhe ka 28 degë vendore. Njësoj si në rastin e sistemeve të mbrojtjes sociale në vendet e tjera⁴⁹, ligji parashikon akses në ndihmën sociale për migrantët që kanë status të rregullt në Shqipëri, ndërkohë që në rastin e migrantëve të parregullt, ndihma e disponueshme është shumë më e kufizuar dhe përqendrohet kryesisht te disa prej nevojave dhe të drejtave themelore. Një shqyrtim i dispozitave të vendosura dhe intervistave me zyrtarët nga ministritë përkatëse tregoi se parashikohen dispozita më sistematike dhe të shtjelluara në sistemin e mbrojtjes sociale për grupe të veçanta migrantësh, përkatësisht viktimat të identifikuar të trafikimit, refugjatë të njohur, dhe fëmijë të pashoqëruar.

Për shembull, fëmijët e pashoqëruar bëhen automatikisht pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale dhe procedurat për t'i ndihmuar dhe mbrojtur janë detyrim ligjor i institucioneve qendrore dhe vendore. Nga ana tjetër, një familje migrante që kthehet nga jashtë vendit duhet të shkojë te sportelet e migracionit që të kërkojë përmbushjen e nevojave të saj. Dallimi ndërmjet shërbimeve të siguruara për grupe të caktuara migrantësh dhe atyre që duhen kërkuar nga vetë migrantët bëhet i qartë nëpërmjet të drejtave që gëzojnë migrantët në Shqipëri.

Situata e **viktimave të identifikuar të trafikimit** është specifike për sa i përket ofrimit të shërbimit dhe aksesit në ndihmë dhe mbrojtje. Megjithëse personat e trafikuar gëzojnë statusin e personave të cenueshëm, ata duhet të identifikohen si viktimat të trafikimit dhe të paraqiten pranë shërbimeve sociale. Për këtë arsye, mbështetja dhe shërbimet për viktimat e trafikimit në praktikë iu ofrohen vetëm atyre që i kërkojnë. Provat e këtij kërkimi tregojnë se duke marrë parasysh stigmatizimin që lidhet me trafikimin në Shqipëri, një pjesë e viktimave të trafikimit mund të mbeten jashtë sistemit të ndihmës sociale.⁵⁰

Përveç mospërputhjeve ndërmjet ligjit dhe politikave në njërin anë, dhe ofrimit të shërbimit në praktikë nga ana tjetër (gjithashtu për shkak të koordinimit të pamjaftueshëm ndërinstitucional), në përgjithësi shihet një **mungesë e burimeve të duhura njerëzore dhe materiale** te të gjitha institucionet përgjegjëse për të identifikuar, ndihmuar, dhe mbrojtur migrantët në Shqipëri. Zyrtarët e qeverisë që janë marrë në intervistë në kuadër të këtij kërkimi e justifikojnë këtë situatë me mungesën e fondeve. Në veçanti, duket se Policia Kufitare nuk ka burime njerëzore të mjaftueshme dhe të trajnuara siç duhet, që nevojiten për të trajtuar fëmijët që hyjnë në vend, si dhe migrantët në përgjithësi.

Intensiteti (megjithëse pak) i rritur i fluksit të refugjatëve drejt Shqipërisë kontribuoi në zbulimin e mungesës së përgjithshme të përgatitjes të sistemit të menaxhimit të migracionit në Shqipëri, si pasojë e së cilës edhe rritja deri në masën e disa dhjetëra hyrjesh në ditë mund t'i shkaktojë probleme të rënda autoriteteve përkatëse, si dhe shkelje të mundshme të të drejtave kryesore

⁴⁹ Peggy Levitt, Charlotte Lloyd, Armin Mueller dhe Jocelyn Viterna, "Mbrojtja Sociale Botërore: Përcaktimi i Axhendës", në RSCAS 2015/78 (http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2682423)

⁵⁰ intervistë me ekspertët e trafikimit në MPB

të njeriut për migrantët e prekur. Situata do të vështirësohet duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta në demografinë e këtij fluksi, që fillimisht dominohej nga numri i madh i meshkujve të pamartuar, dhe më pas të grupeve më vulnerabël, si gratë dhe fëmijët, siç raportojnë ONQ-të në Shqipëri.

3.3.4. Mbrojtja e fëmijëve të prekur nga migracioni

Meqenëse ligji e lidh ndihmën sociale me “grupet e cenueshme” në Shqipëri, vetëm grupe të caktuara të fëmijëve migrantë përfitojnë nga shërbimet e ndihmës dhe mbrojtjes që përmbushin nevojat e tyre dhe janë në përputhje me situatën specifike në të cilën ndodhen.⁵¹ Në këto grupe përfshihen fëmijët e lënë pas dore, fëmijët në situatë rruge, dhe fëmijët e shfrytëzuar dhe të abuzuar seksualisht. Megjithatë, në një vend ku profili i migracionit po ndryshon shpejt, ky përcaktim i hershëm mund të **përrjashtojë shumë kategori të migrantëve dhe fëmijëve në nevojë**. Në përgjithësi, qasja në rang kombëtar është që fëmijët të cilët kthehen nga migracioni nuk njihen si grup në rrezik.

Lidhur me këtë, zyrtarët raportuan vështirësi në zbatimin e parimit të **‘interesit më të lartë të fëmijës’**.⁵² Pavarësisht se ekzistojnë dispozita ligjore lidhur me këtë çështje, përfshirja e saj në procedurat e shumë institucioneve ka qenë e vështirë. Ka pak interpretime të këtij parimi, sidomos për shkak të vështirësive për ta kuptuar këtë koncept nga pikëpamja kulturore dhe socioekonomike në Shqipëri. Si rrjedhojë, ka një mungesë qartësie në punën e përditshme me rastet e fëmijëve të cenueshëm, pavarësisht dëshirës së mirë për të respektuar të drejtat e fëmijëve, parimet, dhe detyrimet ndaj tyre. Megjithatë, përmirësimet në infrastrukturën ligjore të Shqipërisë, interpretimi dhe zbatimi i këtyre parimeve mbetet i paqëndrueshëm. Për shembull, ligji nr. 121/2014 *“Për azilin”*, neni 17 parashikon se **‘interesi më i lartë i fëmijës’** është qëndrimi mbizotërues që duhet mbajtur, por i referohet për interpretim vetëm KDF-së së OKB-së.

Një hendek tjetër është mungesa e një **sistemi të qartë referimi dhe procedura standarde të operimit që rregullojnë identifikimin, referimin dhe ofrimin e ndihmës për fëmijët e prekur nga migracioni**. Ajo që është më e rëndësishmja është se rrjedha e ndërveprimit të migracionit dhe strukturave të shërbimit social është e paqartë. Sistemi për mbrojtjen e fëmijëve shihet si i paqëndrueshëm dhe është e nevojshme të rishikohet nga zyrtarët e rangut të lartë, pavarësisht faktit që ekziston një infrastrukturë e rregulluar nga ligji nr. 10347/2010 *“Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”*. Një gjetje e rëndësishme është se edhe kur shërbimet janë të disponueshme për migrantët, në fakt ato janë të disponueshme për familjet, dhe jo për fëmijët. Përpos kësaj, nuk ekzistojnë as programe të veçanta për familjet që kthehen nga migracioni, përveç programeve **“të zakonshme”** që përqendrohen te fuqizimi i familjes.

Problemi i bashkërendimit bëhet edhe më serioz kur merren parasysh rastet e **kthimit të fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë nga familjarët**. Sipas përfaqësuesve të MPB-së, ka praktika të mira, të cilat bazohen në një Urdhër të veçantë për fëmijët e pashoqëruar, i përgatitur bashkërisht nga Shërbimi Social Shtetëror dhe Policia e Shtetit (2014). Mendohet se urdhri ka nevojë për rishikim, kryesisht prej faktit se MPJ-ja nuk përfshihet në procedurat e vendosura, dhe për këtë arsye ambasadat dhe konsullatat shqiptare nuk janë pjesë e tyre. Në fakt, përfaqësuesit e MPB-

⁵¹ Intervistë me Znj. Denada Seferi, MMSR

⁵² Intervistë me ekspertët e trafikimit në MPB

së u shprehën se pavarësisht faktit se ka protokolle që rregullojnë kthimin e migrantëve, dhe në veçanti të fëmijëve migrantë, ata nuk zbatohen gjithmonë. Supozohet se vendet e destinacionit jo gjithmonë bashkëpunojnë dhe i lajmërojnë autoritetet shqiptare për migrantët që po kthejnë. Si pasojë, autoritetet shqiptare nuk janë në gjendje të organizojnë pritjen e duhur dhe shërbimet e disponueshme në kohën e duhur.⁵³

Pashtetësia është një nga problemet kryesore që prekin fëmijët në kontekstin e migracionit në Shqipëri. Kjo lidhet ngushtësisht me problemin e **regjistrimit të fëmijëve**. Sipas përfaqësuesve të ONQ-ve⁵⁴, në Shqipëri pashtetësia është situatë *de facto*, por jo domosdoshmërisht politikë ku përqendrohet qeveria. Për shembull, komunitetet rome dhe egjiptiane janë në rrezik pashtetësie, sepse nuk janë të regjistruar në gjendjen civile. Një grup që është në rrezik të veçantë janë fëmijët e prindërve që kthehen nga Greqia. Këta fëmijë nuk janë regjistruar as në Greqi dhe as në Shqipëri, gjë që çon drejt pashtetësisë.

Një nga pengesat kryesore në çështjen e pashtetësisë janë burokracitë për regjistrimin e fëmijëve. Nëpunësit e gjendjes civile nuk mund të refuzojnë formalisht që t'i regjistrojnë këta fëmijë, por kërkohen një sërë aspektesh procedurale që e ndërlikojnë këtë proces për familjet. Problemi i regjistrimit në lindje mendohet se lidhet ngushtësisht me shtresën shoqërore të fëmijëve dhe prindërve. Fëmijët e shtresës së mesme kanë më shumë gjasa të regjistrohen në lindje në krahasim me grupet më të varfra dhe më pak të arsimuara të popullsisë. Në një periudhë afatgjatë, me shumë mundësi kjo gjë do të sjellë shtresëzimin e popullatës së migrantëve të kthyer.

Mungesa e regjistrimit ka pasoja të mëdha të aksesit në burimet dhe arsimin e fëmijëve, dhe si rrjedhojë problemet e regjistrimit mund të shkaktojnë marginalizimin e një numri të madh fëmijësh në moshë madhore. Megjithatë, shkalla e plotë e problemit nuk dihet ende dhe pasojat mbi jetën e fëmijëve nuk janë shqyrtuar siç duhet.

Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve tregoi se kjo agjenci **nuk ka statistika për fëmijët migrantë dhe shërbimet që iu ofrohen, pavarësisht faktit se njësitë** vendore për mbrojtjen e fëmijëve në zonat kufitare i kanë ndihmuar fëmijët që janë kthyer nga migracioni për t'u regjistruar në shkolla dhe për të përfutur akses në shërbimet shëndetësore dhe të tjera.

⁵³ intervistë me Znj. Esmeralda Toska, Drejtorja e Policisë Kufitare, MPJ

⁵⁴ intervistë me ekspertët e UNHCR-së në Tiranë

4. Situata në terren:

Rangu vendor

Në këtë seksion paraqiten gjetjet kryesore lidhur me migracionin hyrës, dalës dhe të brendshëm në Shqipëri, të cilat rrjedhin nga kërkimet në rang vendor, që janë kryer si pjesë e këtij studimi. Ky seksion përmban një përmbledhje krahasuese të prirjeve dhe çështjeve të ndryshme, ndërsa informacionet shtesë lidhur me gjetjet specifike në pesë bashkitë e mbuluara nga kërkimi në terren gjenden në Aneksin 3.

4. 1. Emigracioni

Që prej fillimit të viteve 1990, në të gjitha bashkitë e përfshira në këtë studim ka pasur lloje të ndryshme të emigracionit. Megjithëse të dhënat e kërkimit në rang vendor nuk japin një ndarje të prerë, prirja e përgjithshme tregon se qytetarët shqiptarë nga Tirana dhe qytete të mëdha në veri dhe jug (Shkodra dhe Korça) kanë migruar në vende më të pasura të BE-së, vende të tjera veriperëndimore, dhe Australi. Migrantët nga zonat dhe fshatrat më të vegjël kanë migruar në vende fqinje, kryesisht në Greqi, dhe një numër i madh kanë kryer migracion sezonal dhe rrethor. Arsyet për emigracionin kanë qenë kryesisht ekonomike, dhe të tjera kanë qenë bashkimi familjar dhe shëndeti.

Për një kohë të gjatë pjesa më e madhe e lëvizjeve migratore janë kryer në mënyrë të parregullt. Migrantët kujtojnë kostot e migracionit të tyre dhe fëmijëve të vet:

Ne migruam dy herë, të dyja herët në mënyrë të parregullt, dhe paguam shuma të mëdha parash. Udhëtimin e parë e kryem me gomone dhe ishte përvojë shumë e hidhur dhe e paharrueshme, jo vetëm për ne, por sidomos për fëmijët. Edhe sot pas shumë vitesh vajzat e mia e kanë fobi udhëtimin me traget dhe avion. Ato i tmerron udhëtimi vetëm për shkak të frikës së tmerrshme që përjetuan kur u përpoqëm të migrojmë. [...] Ndihem në faj për atë që i kam bërë fëmijëve të mi, dhe bashkë me gruan time jemi të vetëdijshëm për këtë [...]. Herën e dytë udhëtimi ishte më i sigurt, sepse kishim viza, që i kishim marrë në mënyrë të parregullt (mashkull, Shkodër).

Kërkimi në rang vendor konfirmoi prirjen kombëtare, sipas të cilës migracioni i parregullt i qytetarëve shqiptarë po bie. Migrantët e mundshëm kanë mundësi më të mëdha për të migruar në mënyrë të rregullt, gjë që i shton mundësitë për siguri dhe të ardhme më të mirë.

Në fakt, liberalizimi i vizave në vitin 2010 krijoi mundësi që familjet më të pafavorizuara të provojnë të migrojnë në vende më të pasura të Evropës Perëndimore. Më parë, migracioni ndërkuftar nga zonat urbane të Shqipërisë ishte përzgjedhës dhe përfshinte individë dhe familje që kishin

mundësi financiare për të udhëtuar⁵⁵. Nga ana tjetër, kjo valë e re emigracioni përfshinte më shumë grupe të pafavorizuara të popullsisë nga zonat urbane dhe periferike, dhe një numër i madh migrantësh të brendshëm, kryesisht ata që janë shpërngulur në Tiranë, dhe më pak në Shkodër dhe Korçë. Sipas përfaqësuesve të Zyrës së Punësimit në Shkodër:

Arsyet e migracionit kanë lidhje me kushtet e jetesës në Shqipëri, dhe dallimi ndërmjet pagës minimale dhe kushteve të jetesës në Shqipëri. Kostot e larta të jetesës i vendosin njerëzit në kushte të vështira, jo vetëm të papunët, por edhe të punësuarit. Sapo të rriten standardet e jetesës, do të ndryshojnë prirjet e migracionit. Qeveria po përpiqet të rrisë pagën minimale dhe numrin e përfitimeve, por mbetet ende shumë punë për të bërë.

Liberalizimi i vizave e ka lehtësuar migracionin sezonal në Greqi. Rrëfimi i një prej personave të intervistuar:

Unë emigrova në Greqi 10 vjet më parë. Kalova në këmbë nëpër male. Më vonë, pas liberalizimit të vizave, shkova në Greqi dhe Itali të të afërmit e mi me pasaportën time. Bëja punë sezonale, sidomos në bujqësi. [...] U largova për të gjetur një punë, sepse në Shqipëri nuk gjeja dot dhe po jetoja në kushte të vështira ekonomike. [...] për mua është shumë më e vështirë, sepse jam femër e vetme, nuk jam e martuar, dhe çdo gjë e bëj vetë. (femër, 46 vjeç, Fier).

Rrëfimet e migrantëve tregojnë ndërmjetësimin e kontrabandistëve në lëvizje, të cilëve iu referohen si “persona që merren me këto gjëra” (femër, 32 vjeç, Shkodër). Migrantët e intervistuar u shprehën se i kanë paguar kontrabandistëve sasi të mëdha parash. Një ekspert i Emergjencave Civile në Lezhë tha se kjo dukuri ka ndikuar më së shumti në zonat rurale në rajonin e tyre, dhe më pak në qytet, sidomos në krahasim me qytetet e tjera në Shqipëri, si Kukësi apo Vlora. Sipas tij, zonat rurale ishin shënjestra e kontrabandistëve dhe organizatave të ngjashme, të cilat siguronin imigracionin dhe vendosjen në vendet pritëse:

Familjet më të cenueshme vijnë nga zona të izoluara rurale, të cilat në shumë raste bien pre e shfrytëzimit dhe migracionit të parregullt, dhe në disa raste edhe e mashtrimit nga ana e kontrabandistëve. Emigracioni i tyre shoqërohet nga humbja e çdo gjëje që kanë, duke përfshirë të gjitha pronat dhe pasuritë në Shqipëri. Prandaj kur kthehen, kanë humbur çdo gjë dhe iu duhet të nisin një jetë të re, duke filluar nga akomodimi, puna, ndihma sociale, etj.

⁵⁵ Migracioni i ri shqiptar, Botues: Brighton: Sussex Academic Press, fq. 1-28

Provat nga Shkodra tregojnë se migrantët kanë bërë përpjekje të migrojnë jashtë më shumë se njëherë. Në fakt, shumica e azilkërkuesve janë kthyer në Shqipëri brenda pak muajsh, pasi Gjermania dhe vendet e tjera të BE-së e shpallën Shqipërinë vend të sigurt origjine⁵⁶ (2015). Ata nuk kishin mundësi për të shkuar në Gjermani dhe vende të tjera të BE-së, prandaj iu desh të merrnin para borxh dhe të shisnin disa nga gjërat që kishin. Një grua nga Korça shpjegon:

Kur u larguam [për në Gjermani], kishim vështirësi në Shqipëri, sepse morëm para borxh dhe u larguam meqenëse varfëria të detyron të bësh shumë gjëra! Nuk doja t'i lija fëmijët të vuanin ashtu. Askush nuk më ndihmonte, dhe dëgjonim histori të njerëzve që ishin larguar dhe menduam ta provonim edhe ne. Ishim pak të humbur... (femër, 36 vjeç, Korçë).

Udhëtimet drejt vendeve më të pasura të Evropës janë të gjata dhe zgjasin disa ditë, dhe shumë migrantë raportojnë se përdorin mjete të lira transporti, si autobusë, kamionë, dhe tragete. Kjo nënkupton se fëmijët e vegjël iu nënshtrohen ditëve të tëra udhëtimi në kushte të parehatshme. Megjithatë, problemet ekonomike me të cilat përballen familjet i detyrojnë të provojnë të migrojnë për të përmirësuar situatën e tyre. Për këtë arsye, regjimi i vizave të lira ka sjellë një situatë më të favorshme për atë që shihet si migracion i ligjshëm për të kërkuar azil. Megjithatë, siç është përmendur më sipër, ky konsiderohet migracion i rregullt, por migrantët flasin për ndikimet psikologjike që kishte mbi ta:

U largova për në Gjermani në vitin 2013 bashkë me vajzën time 12-vjeçare. U largova për një jetë më të mirë për mua dhe vajzën time, sepse doja që ajo të rritej pa i munguar asgjë. [...] kur mbërritëm në Gjermani, na vendosën në kamp bashkë me emigrantë nga mbarë bota. Kushtet ishin të vështira. Flinim në çadra. Isha e shqetësuar për vajzën time dhe nuk flija gjithë natën, sepse kisha frikë se mos ma dhunonte njeri, meqë kisha dëgjuar histori të frikshme. Ishte shumë e vështirë, sepse ishim vetëm ne të dyja, dy femra vetëm dhe në muajt e parë (femër, 46 vjeç, Fier).

Në përgjithësi, migracioni dhe prirja e kohëve të fundit për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare për arsye ekonomike duket se është projekt familjar në shumicën e rasteve. Shumica e migrantëve kanë emigruar me anëtarët e familjeve të tyre, kryesisht me bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët, ose (në rastin e personave të pamartuar) me motrat ose prindërit. Disa nga migrantët e intervistuar kanë migruar nga një qytet i vogël drejt Tiranës, dhe më pas jashtë vendit, duke shfaqur kështu lidhjet midis migracionit të brendshëm dhe migracionit ndërkombëtar në Shqipëri⁵⁷.

⁵⁶ <http://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-569008-Safe-countries-of-origin-FINAL.pdf>

⁵⁷ Julie Vullnetari, *Shqipëria në Lëvizje: Lidhjet midis Migracionit të Brendshëm dhe Ndërkombëtar*, Amsterdam University Press 2012 (<http://www.oapen.org/search?identifier=419372;keyword=vullnetari>)

Rezultatet e migracionit tek individët dhe familjet e tyre ishin të përziera. Ato vareshin nga një sërë faktorësh, duke nisur nga situata e migrantëve para nisjes deri te politikat dhe praktikat në vendet pritëse. Në përgjithësi, migrantët që kanë shkuar në Gjermani dhe kanë aplikuar për azil kanë pasur përvoja shumë të mira, veçanërisht lidhur me shërbimet e disponueshme për fëmijët, që nuk do t'i gjenin në Shqipëri, përkatësisht kujdesi ndaj fëmijës dhe arsimimi i hershëm. Disa migrantë që kanë shkuar në Suedi raportuan se kanë hasur probleme me akomodimin dhe kushtet e jetesës në kampet ku ishin vendosur. Në përgjithësi, pavarësisht përmirësimit të situatës ekonomike, emigracioni duket se ka pasoja emocionale dhe psikologjike te migrantët. Shumë prej tyre raportuan se edhe kur ndiheshin të sigurt ligjërisht, nuk ndiheshin të sigurt psikologjikisht. Disa nga rezultatet negative u vërejtën pasi migrantët u kthyen në Shqipëri. Në fakt, migracioni i familjeve solli ndërprerjen e arsimit bazë dhe të mesëm të fëmijëve. Pasi ktheheshin, disa prej tyre ishin në gjendje ta vazhdonin shkollën aty ku e kishin lënë. I intervistuari më i ri në Tiranë, rrëfeu sesi kishte emigruar dy herë nga Shqipëria në Greqi dhe Francë. Ai shpjegoi:

Emigrova dy vjet më parë. . . për një të ardhme më të mirë. U largova së bashku me familjen time. U largova me mamanë dhe motrën time, sepse babai qëndroi në Shqipëri. Isha më i vogli dhe i emocionuar se do të shkoja në një vend tjetër. Mamaja ime gjithmonë thoshte se do të shkonim jashtë vendit. . . [. . .] Ende jam në shkollë të mesme, sepse kur migrova e lashë përgjysmë. . . (mashkull, 19 vjeç, Tiranë).

Nga ana tjetër, fëmijët e tjerë nuk shkuan më në shkollë pas kthimit në vend⁵⁸. Përpos kësaj, ndryshe nga llojet e tjera të migracionit, migrantët që kërkonin azil dhe nuk iu pranua aplikimi, në përgjithësi nuk përvetësuan asnjë aftësi, së pari sepse qëndrimi jashtë vendit kishte zgjatur pak (zakonisht më pak se një vit), dhe së dyti sepse shumicën e kohës familjet e tyre kishin qëndruar nëpër kampe dhe nuk iu është dhënë mundësia të punonin në vendet pritëse.

4. 2. Imigracioni

Siç është përmendur në seksionin e metodologjisë, kërkimi për këtë studim nuk e përfshin pjesëmarrjen e migrantëve të huaj që jetojnë në Shqipëri. Sidoqoftë, intervistat me personat kyç treguan se imigracioni është dukuri e zakonshme në Shqipëri. Në krahasim me katër bashkitë e tjera të mbuluara nga ky studim, dhe zonat rurale, ai është më intensiv në Tiranë. Një aspekt interesant që doli nga intervistat ishte larmia e popullatës së imigrantëve. Ndërkohë që në shumë vende tipike imigracioni gjenden një ose më shumë grupe mbizotëruese imigrantësh. Në Shqipëri ata vijnë nga vende të ndryshme të botës.

Imigracioni mund të jetë specifik në bazë të sektorit. Për shembull, Fieri ka një numër relativisht të madh imigrantësh që punojnë në industrinë e naftës. Në Lezhë ndodhen një numër i madh imigrantësh për veprimtari fetare. Flukset hyrëse lidhur me "krizat e migrantëve dhe refugjatëve" të kohëve të fundit janë regjistruar në tre bashkitë e përfshira në këtë kërkim: Tirana, Korça

⁵⁸ Zana Vathi, Veronika Duci, Elona Dhembo, (Dis) *Integrimi i Atdheut: Përvoja Arsimore, Fëmijët dhe Kthimi i Migrantëve në Shqipëri*, IOM 2016 (<http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/imig.12230/full>)

si pikë hyrëse dhe Shkodra si pikë dalje. Flukset përfshinin të rritur dhe fëmijë që kërkonin mbrojtje ndërkombëtare. Megjithatë, natyra e larmishme e imigracionit në Shqipëri mbetet temë interesante që duhet eksploruar.

4.3. Migracioni i brendshëm

Ky lloj migracioni ka pasur modele të ndryshme në bashkitë e mbuluara nga ky studim, për sa i përket intensitetit dhe llojeve të lëvizjeve të brendshme nga të cilat ndikohen. Tirana ishte qyteti më i prekur nga migracioni i brendshëm dhe ka pritur migrantë nga të gjitha zonat e Shqipërisë. Në Korçë dhe Shkodër ka pasur migracion të brendshëm në një masë më të ulët, por më të lartë në krahasim me qytete me madhësi mesatare si Lezha dhe Fieri. Në rastin e këtyre dy të fundit, migrantët e brendshëm kryesisht kanë ardhur nga zonat rurale dhe urbane më të vogla në të njëjtat rajone:

“U shpërngula në Fier për të punuar, sepse nuk duroja dot më ta shihja familjen time në gjendjen e mjerueshme që ishim” (19 vjeç, mashkull, Fier).

Siç është shprehur dhe më sipër, sipas ligjeve dhe politikave ekzistuese, që janë pasqyruar në sjelljen e autoriteteve kombëtare dhe vendore, migrantët e brendshëm nuk konsiderohen grup i cenueshëm i popullsisë. Nga ana tjetër, ata hasin pengesa të shumta në aksesin në shërbime dhe ndihmë sociale. Situata pritet të ndryshojë me ndryshimin e ligjit të ri për ndihmën sociale, i cili nuk e lidh aksesin në shërbime sociale me regjistrimin në gjendjen civile të të njëjtit qytet ose fshat. Siç është përmendur më sipër, një nga burimet e migracionit të brendshëm është migracioni i kthimit. Për shembull, një familje nga Durrësi që u largua nga Shqipëria për të emigruar në Gjermani, pasi iu refuzua aplikimi për azil, u kthyen në Shqipëri dhe u përpoqën të vendoseshin në Tiranë. Siç tha dhe i ati:

Kur u kthyem, u vendosëm në Tiranë në një apartament me qira, sepse nuk kishte më mundësi për punë... punoj disa ditë në një vend, disa në një vend tjetër, ku të gjej në sektorin e ndërtimit... në mënyrë që t’i rrisim fëmijët sa më mirë të jetë e mundur (mashkull, 39, Tiranë)

Pas refuzimit të aplikimeve për azil, migrantët që janë kthyer dhe kanë vendosur të vendosen në Tiranë shpeshherë jetojnë në kushte më të vështira sesa më parë. Migrantët e brendshëm të kthyer që u rivendosën në Tiranë nuk kishin as lidhje familjare dhe as lidhje shoqërore në kryeqytet. Në përgjithësi, dukej se kishin më shumë nevojë për ndihmë dhe mbështetje për t’u integruar sesa kur u larguan nga vendi.

Ndërkohë që arsyet e migracionit të brendshëm kanë qenë kryesisht ekonomike, në disa raste ato kanë qenë të lidhura edhe me faktorë personalë, që shpesh e bën atë specifike sipas gjinisë. Për shembull, një migrant nga Shkodra që jetonte në Tiranë u shpreh:

Ne u larguam nga Shqipëria për shkak të vështirësive ekonomike, dhe shpresonim të kishim një jetë më të mirë... unë dhe ish-burri im jetuam 10 vjet në Itali, dhe më pas vendosëm të ktheheshim në Shqipëri dhe u kthyem në Shkodër ku hasëm shumë vështirësi dhe u divorcuam (femër, 33 vjeç, Tiranë)

Në fakt, një tjetër prirje e migracionit të brendshëm është lëvizja e grave të divorcuara nga zonat rurale drejt qyteteve kryesore, më së shumti në Tiranë, me përpjekjen për të rindërtuar jetët e tyre dhe për t'iu ofruar fëmijëve të tyre kushte jetese dhe mundësi më të mira:

Jam e divorcuar dhe kam 8 vjet që jetoj në Korçë. U largova nga Voskopoja për një të ardhme më të mirë për fëmijët e mi, sepse atje nuk ka shkollë [të mira]. Jeta është e vështirë në Korçë. Mua më mbështetin prindërit dhe punoj në të zezë. Kam punuar në sektorin e frutave, pastruese shtëpie, dhe për momentin jam e papunë. Jetoj në shtëpi me qira. Ndihma e vetme financiare që marr, vjen nga prindërit e mi (femër, 31 vjeç, Korçë).

Migrantët e brendshëm shpeshherë përballen me diskriminim në vendin e ri që vendosen. Kjo vihet më shumë në dukje në rastin e atyre që vijnë nga Veriu i Shqipërisë:

Njerëzit në Levan na paragjykojnë dhe na quajnë "malokë", duke na bërë që të mos ndihemi të mirëpritur... (femër, 40 vjeç, Fier).

Varfëria dhe marginalizimi i këtyre migrantëve gjithashtu pasqyron edhe mirëqenien e fëmijëve:

Ne përballemi me shumë probleme ekonomike për shkak të papunësisë, dhe kjo krijon vështirësi në arsimimin e fëmijëve. Ata shkojnë në shkollë, por nuk mësojnë mirë, sepse nuk kanë libra. Nuk kam para mjaftueshëm për t'ua blerë, dhe kjo ka ndikuar në ecurinë e tyre në mësim (femër, 42 vjeç, Korçë, me prejardhje nga Tropoja).

Një çështje e rëndësishme që e ndërlikoi situatën e migracionit të brendshëm të fëmijëve është mungesa e regjistrimit, që nuk është problem i madh vetëm për familjet rome dhe egjiptiane, por edhe për fëmijët e familjeve (të tjera) migrante të kthyer⁵⁹. Mungesa e regjistrimit gjithashtu i pengon institucionet që të informohen lidhur me praninë e këtyre fëmijëve në territorin ku ato veprojnë, dhe të marrin masa mbrojtëse në rastet e nevojshme:

⁵⁹ Përfaqësuese e organizatës "Gruaja në Zhvillim", Shkodër

Meqenëse shumë fëmijë nuk janë regjistruar, ata lëvizin lehtësisht nga një qytet në tjetrin, dhe fatkeqësisht nga një vend në tjetrin. Kemi shumë pak informacion për lëvizjet e tyre, meqenëse janë të peregjistruar dhe nuk kanë mjete identifikimi, prandaj pikat kufitare nuk kanë statistika lidhur me këtë çështje dhe shtetet nuk i deklarojnë. [...] Mungesa e regjistrimit është pasojë e një defekti ligjor, sepse familjet mund të kenë migruar, ose kur kanë lindur fëmijët ka pasur vështirësi në regjistrimin e tyre.

4.4. Migracioni i kthimit

Migracioni i kthimit në pesë bashkitë ku gjenden migrantë afatgjatë, azilkërkues që janë kthyer në mënyrë vullnetare ose i janë nënshtruar një vendimi kthimi, migrantë që janë kthyer nga jashtë vendit dhe kanë migruar brenda vendit, në veçanti në Fier, kthimi i migrantëve sezonalë.

Shumica e migrantëve që janë kthyer nga migracioni afatgjatë kanë investuar në pasuri të paluajtshme, ose kanë ngritur biznese të reja, duke sjellë kështu njohuritë e përvetësuar jashtë vendit:

U ktheva në këtë qytet për të investuar në diçka. Dua të ngre biznesin tim, ndoshta një kreperi ose fast food. Arsyeja pse u ktheva është sepse dua të jap kontributin tim në qytetin ku kam lindur [...] ⁶⁰

Megjithatë, edhe migrantët e kualifikuar nuk përfituan mbështetje të mjaftueshme për t'u riintegruar dhe për të përdorur aftësitë dhe shprehjet e tyre në mënyrën e duhur. Siç raportohet, autoritetet vendore nuk i njohin aftësitë dhe kualifikimet e migrantëve individualë, dhe as nuk i ndihmojnë për të gjetur punë dhe ngritur biznese. Përpos kësaj, klima për investime nuk është e favorshme:

Nuk e kam mundësinë për të investuar. Rroga ime mjafton vetëm për shkollimin e fëmijëve, dhe nuk mbetet asgjë për investim. Kursimet që kisha mbledhur kur punoja në Itali i investova në pasuri të paluajtshme, për shtëpinë tonë, por nuk kam pasur kurajën të investoja në biznes, sepse mjedisi më dukej i pasigurt [...] (maskull, 52, Lezhë).

Pasi u kthëm nga jashtë, edhe fëmijët hasën vështirësi për t'u riintegruar, në veçanti me përshtatjen në shkollë dhe jetën në komunitet. Si prindërit edhe OJF-të raportuan se fëmijët migrantë përballen me diskriminimin, bullizmin, dhe përjashtimin në ambientet e shkollës. Ndihma psikologjike dhe sociale e disponueshme për këta fëmijë dhe familjet e tyre konsiderohet

⁶⁰ fokus grup me migrantë në Lezhë

e pamjaftueshme⁶¹. Familja nuk ndihet e integruar dhe e stabilizuar nëse fëmijët nuk ndihen të lumtur. Disa migrantë që u kthyen i shprehën qartë qëllimet e tyre për të migruar sërish nëse fëmijët e tyre vazhdonin të kishin vështirësi në përshtatjen me jetesën në Shqipëri.

Nevojat e migrantëve të kthyer për shkak të refuzimit të aplikimit për azil janë përgjithësisht më të mëdha dhe të larmishme. Ata kanë nevojë për strehim, ndihmë ekonomike, punë, akses në kujdes shëndetësor, dhe mbështetje për arsimimin e fëmijëve.

Sidoqoftë, në krahasim me migrantët që kanë jetuar jashtë vendit për një kohë të gjatë, ata që kthehen pas procedurave të refuzuara të azilit kanë prirjen të jenë më pak të tronditur në aspektin kulturor. Një nga të intervistuarit u shpreh:

(Kur u kthyem) nuk kishte shumë ndryshim, sepse e dinim çfarë na priste. Kishim ende vështirësi të mëdha për të përballuar problemet e përditshme ekonomike... (mashkull, 42 vjeç, Tiranë).

Megjithatë, ëndrra për të jetuar në vendin ku kanë migruar u shkatërrua nga refuzimi i aplikimit për azil dhe iu shkaktoi dhimbje emocionale.

Një migrant vuri në dukje një dimension tjetër, që është shfrytëzimi nga pronarët e rinj të bizneseve në Shqipëri që punojnë në të zezë për të rritur përfitimet e tyre:

Përvoja ime e punës në Shqipëri është e tmerrshme. Kam punuar gjithmonë në supermarkete, ose si kamerier apo banakier në bare dhe restorante. Nuk kam marrë kurrë rrogë më të lartë se 15,000 lekë në muaj dhe kam punuar gjithmonë me orë të zgjata dhe pa pushime (mashkull, 25 vjeç, Lezhë).

Ndryshe nga migrantët e rritur, fëmijët e kthyer pas refuzimit të kërkesës për azil kishin prirje më të madhe për t'u integruar në vendin pritës, megjithëse qëndrimi i tyre ishte i kufizuar në një periudhë të shkurtër kohore. Këta fëmijë hasën vështirësi për t'u integruar sërish në komunitetin ku u kthye familja:

Shkollat dhe veprimtaritë jashtëshkollore të ofruara nga shteti gjerman janë shumë të mira dhe i ndihmojnë fëmijët të integrohen shpejt. Ata e mësuan gjuhën shumë shpejt dhe ndiheshin të barabartë me fëmijët e tjerë. Fëmijët vuajtën shumë në çastin që u larguan nga Gjermania. Dy javët e fundit kur po përgatiteshim për t'u kthyer në Shqipëri dhe iu treguam se do të largoheshim, ata qanë shumë, sepse nuk donin të ktheheshin.

⁶¹ Zana Vathi, Veronika Duci, Elona Dhembo, (Dis) *Integrimi i Atdheut: Përvoja Arsimore, Fëmijët dhe Kthimi i Migrantëve në Shqipëri*, IOM 2016 (<http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/imig.12230/full>)

Edhe migrantët sezonalë flasin për vështirësitë e riintegrimin në komunitet. Lëvizjet rrethore bënë të mundur që ata t'iu ofronin familjeve të tyre mjetet e mbijetesës, por këta migrantë u përballën me probleme psikologjike prej përshtatjes, dhe në përgjithësi iu mungonte optimizmi për të ardhmen. Ata që ishin kthyer për të jetuar në fshat u përballën me probleme kur u përpoqën të përdornin tokat e tyre. Sipas një migranti (mashkull, 35 vjeç) i cili u kthye nga Greqi, ai u përpoq të gjente një punë në Baltëz, por nuk ia doli dot, dhe më pas u përpoq ta kultivonte tokën që kishte, por i mungonin mjetet dhe makineritë e duhura dhe shteti nuk i ofroi ndihmën që kërkoi:

Nisa të migroja në Greqi 10 vjet më parë. Shkoj çdo vit në Kavala për punë sezonale, kryesisht për vjeljen e kivit. Jetoj në Baltëz [fshat në Fier] ku kam shtëpinë time, që ngjason më shumë me një kasolle, dhe jetojmë në kushte shumë të vështira. Sa herë që kthehem nga Greqia në Baltëz më duket sikur çdo gjë përkeqësohet. Jeta këtu po bëhet çdo ditë dhe më e vështirë, dhe mungesa e mundësive për punësim më bën të ndihem i pashpresë (mashkull, 51 vjeç, Fier).

Një prirje tjetër që u raportua nga migrantët në Korçë është kthimi i të moshuarve. Shumica e të moshuarve që kthehen nga migracioni kanë shtëpi dhe lidhje personale që i mbështesin kur kthehen. Në përgjithësi, ata nuk duan të kthehen nga vendi ku kanë emigruar. Nga ana tjetër, të rinjtë e kthyer synojnë ose planifikojnë të migrojnë sërish. Një migrant që u kthye pasi i refuzuan aplikimin për azil në Gjermani tha:

Nuk po kërkoj punë në Shqipëri. Synoj të kthehem në Gjermani me anë të një kontrate pune që kam siguruar. Gjatë qëndrimit në Gjermani arrita ta mësoj shumë mirë gjermanishten... nuk e kam pasur mundësinë të investoj në Shqipëri, por edhe po ta kisha, nuk do ta bëja sepse sipas mendimit tim Shqipëria nuk është vend i sigurt për biznes (mashkull, 31 vjeç).

Qëllimi ose dëshira për të migruar sërish është faktor i rëndësishëm për ruajtjen e lidhjeve transnacionale me vendet nga ku janë kthyer migrantët. Kjo vlen si për migrantët e rritur ashtu edhe për fëmijët. Migrantët mbajnë kontakte me punëdhënësit, miqtë, dhe pronarët e tyre. Disa nga ata që kanë aplikuar për azil dhe nuk janë pranuar, ende mbajnë kontakte me avokatët, me shpresën për të gjetur një mënyrë për të përfutur leje qëndrimi në vendin ku kanë migruar. Të tjerë mbanin kontakte me punonjësit socialë që i kanë ndihmuar ata dhe fëmijët e tyre gjatë procedurave të azilit. Fëmijët që përdornin Facebook-un, ose vazhdonin të shihnin programe televizive të vendit ku kishin migruar familjet dhe përmirësonin aftësitë gjuhësore që kishin përvetësuar, krahasuar me prindërit e tyre, e kishin më të lehtë të arrinin t'i ruanin këto lidhje.

4.5. Migracioni, mbrojtja sociale dhe e fëmijëve

Intervistat me personat kyç nga institucionet Shtetërore konfirmuan se te Zyrat vendore të Punësimit ekziston një sistem orientimi për migrantët që i këshillon ata lidhur me përfitimet e ndihmës ekonomike, punësimin, strehimin, dhe mundësitë e formimit profesional. Formimi profesional dhe shërbimet shëndetësore iu ofrohen falas qytetarëve që janë regjistruar si migrantë në Sportelin vendor të Migracionit. Megjithatë, migrantëve që synojnë të ngrenë një biznes nuk iu ofrohet mbështetje (si p. sh mikroreditë). Në bazë të faqeve të kërkimit, programet ekzistuese për formimin profesional janë të pakta në numër. Këto probleme lidhen sërish me mungesën e ndihmës specifike dhe masat mbrojtëse për migrantët:

Do të thoja se ka probleme [lidhur me politikat dhe programet për migrantët], dhe migrantët duhet të konsiderohen si kategori që kërkon vëmendje të veçantë. Vendet e tjera kanë Ministri Migracioni, dhe Zyrë Migracioni. Në Shqipëri, efektet e migracionit kanë nisur të bëhen të dukshme gjatë viteve të fundit, dhe si rrjedhojë nevojitet planifikim dhe trajtim më i mirë i nevojave të tyre. Këto politika duhen shoqëruar me një buxhet specifik⁶².

Në fakt, intervistat e migrantëve dhe personave kyç hodhën dritë mbi disa aspekte jofunksionale të sistemit të mbrojtjes sociale si i tërë, gjë që e pengon punën e efektshme dhe shtimin e efekteve të mundshme pozitive të familjet dhe fëmijët. Këto çështje lidhen me: transparencën dhe besueshmërinë e institucioneve, nivelin e integritit të shërbimeve, dhe aksesin në shërbime.

Në rang qendror, strategjitë ekzistuese parashikojnë përpjekje të përbashkëta të agjencive në rang qendror dhe vendor për të ndihmuar familjet migrante, por në qarqe **nuk ka koordinim**. Agjencitë punojnë në izolim, gjë që e bën punën e tyre joefikase. Për shembull, veprimtaritë e Qendrës së Formimit Profesional që synojnë lehtësimin e integritit të të trajnuarve të rinj në tregun e punës nuk janë të lidhura me ato të zbatuara nga Zyra e Punësimit. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës nuk janë të lidhura me Shërbimet Sociale dhe nuk bashkëpunojnë rregullisht me to. Personat kyç u shprehën se ishin të paqartë dhe të pashpresë, për shkak të mungesës së dispozitave të qarta për llojin e shërbimeve të disponueshme dhe profesionistët duhet të kryejnë veprimtari të ndryshme në mënyrë që t'i bëjnë këto shërbime të aksesueshme në praktikë:

Ka shumë vështirësi. Politikat duhet të planifikohen në bazë të vlerësimeve në shkallë komuniteti dhe bashkie. Në parim disa gjëra janë të qarta, por në komunitet gjithçka kthehet përmbys. Duhet të përqendrohemi më shumë në rang vendor ku jetojnë familjet dhe aty duhet të vendosim se cilat janë nevojat e tyre, si dhe të përcaktojmë politikat që t'i përmbushim këto nevoja. [...] Shërbimet janë të parashikuara në ligj, por në praktikë na mungojnë shërbime dhe struktura të veçanta për t'u marrë me raste të veçanta. Ligji i parashikon disa role dhe detyra, por jo specifikisht: Për shembull, çfarë kuptimi ka menaxhimi i rastit dhe cilat hapa duhen ndjekur?⁶³

⁶² përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Lezhë

⁶³ Valbona Buzi, Shërbimet Sociale Rajonale, Fier

Aktualisht, roli i Zyrës së Shërbimeve Sociale kufizohet në shpërndarjen e ndihmave sociale të familjet e varfra dhe personat me aftësi të kufizuara. Ata nuk kanë mundësi të udhëtojnë dhe t'i vizitojnë familjet me nevoja të veçanta, dhe nuk kanë fonde të pavarura të dedikuara për t'i ndihmuar. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës shpeshherë përbëhen nga një person që nuk ka pushtet mbi shërbimet e tjera Shtetërore për t'i ofruar ndihmë një fëmije apo familjeje në nevojë. Ata nuk kanë fonde dhe mbështeten te projektet e zhvillimit të zbatuara nga OJF-të për të përmbushur detyrat e tyre.

Problemi kryesor është se ka probleme të mëdha me logjistikën dhe stafin, prandaj jemi të detyruar të punojmë më vete dhe nuk kemi leje të veçantë për fëmijët dhe familjet e kthyer. Edhe vizitat në familje i kryejmë duke përdorur makinat tona⁶⁴.

Shumë familje me anëtarë të papunë hasin **vështirësi me aksesin në ndihmë sociale**, sepse nëse iu jepet një ngastër toke nga komuna, ata nuk kualifikohen për ndihmë sociale, pavarësisht se nuk i kanë mjetet e nevojshme për të jetuar. Përpos kësaj, ndihma sociale është e kufizuar për familjet e regjistruara në një rreth të caktuar, prandaj familjet nga zona të tjera dhe të paregjistruara në regjistrin civil nuk kanë akses. Sipas personave kyç, po ndërmerren disa hapa pozitivë në këtë drejtim:

Aktualisht, familjet që vijnë nga zonat rurale nuk përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale. Nga muaji shtator [2016] e tutje ata do të zgjidhen nëpërmjet një sistemi të ri aplikimesh për ndihmën sociale, dhe të gjitha familjet do të vlerësohen nga një sistem me pikë. Ky sistem është vënë në provë dhe zotërimi i një ngastre toke është i pavlefshëm. Të gjitha llojet e të ardhurave do të merren parasysh, dhe do të merret një vendim në përputhje me rrethanat⁶⁵.

Nevojiten instrumente të veçanta për mbështetjen dhe integrimin e familjeve në vështirësi. Aksesit është veçanërisht i vështirë për familjet që jetojnë në varfëri të skajshme:

Familjet shumë të varfra nuk e dinë se ekzistojnë këto shërbime dhe nuk kanë aplikuar për ndihmë. Ato nuk kanë informacion lidhur me shërbimet dhe kurset profesionale. Zakonisht njësitë për mbrojtjen e fëmijës e merr informacionin për familjet e kthyer nga shkolla apo nga lidhjet e saj me komunitetin [...]⁶⁶

Emigrantët e kthyer shprehën **mungesën e informacionit dhe besimit** ndaj institucioneve që mund t'i ndihmonin ato:

⁶⁴ fokus grup me persona kyç, Fier

⁶⁵ fokus grup me persona kyç, Fier

⁶⁶ Valbona Buzi, Shërbimet Sociale Rajonale, Fier

Nuk mendoj se do të shkoja te institucionet shtetërore, sepse mendoj që është humbje kohe dhe nuk ofrojnë zgjidhje apo ndihmë. Besoj se institucionet shtetërore nuk kanë ndryshuar që prej kohës që migrova, dhe meqë nuk më ndihmuan atëherë, nuk mendoj se do të më ndihmojnë tani (mashkull, 31 vjeç, Shkodër).

Jam regjistruar te zyra e punëkërkesve, por nuk kam shpresë se do më gjejnë punë. Bashkëshortja ime nuk punon. Siç janë punët në Shqipëri, nuk ke rrugëzgjidhje... prandaj punoj në ndërtim kur gjej punë, për të siguruar bukën e gojës që të mbijetoj... nuk përfitoj pagesë të sigurimeve shoqërore, sepse jam i regjistruar në Durrës (mashkull, 39 vjeç, Tiranë).

Një prirje tjetër e zbuluar gjatë këtij kërkimi lidhet me punësimin joformal të migranteve të kthyer të cenueshme në sektorin e brendshëm. Nënatanë se puna fleksibël, me kohë të pjeshme është e përshtatshme për to, përndryshe nuk do të mund të kujdeseshin për fëmijët e tyre (gjithashtu për shkak të mungesës së kujdesit të përshtatshëm për fëmijë). Megjithatë ky është burim i dobishëm punësimi për to, duhet treguar kujdes ndaj joformalitetit dhe mungesës së pagesave të sigurimeve shoqërore, si dhe shfrytëzimit të mundshëm në këtë sektor⁶⁷.

Aksesi në **strehim** është shumë i vështirë. Migrantët nuk përfitojnë mbështetje për përmbushjen e nevojave të strehimit. Ata trajtohen në bazë të kriterëve të përgjithshme të vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore. Krahas kësaj, nuk ekziston buxhet shtesë për strehimin e migrantëve.

Një nga çështjet më të ngutshme që migrantët e përmendën si kyçe për nivelin e tyre të (pa) kënaqësisë në Shqipëri është gjendja e dobët e **shërbimeve shëndetësore**. Këto shqetësime sjellin si rrjedhojë migracionin transnacional (ose plane për të kryer lëvizje të tilla) në rast se lindin probleme shëndetësore, veçanërisht te fëmijët. Sipas ligjit, kujdesi falas shëndetësor duhet t'iu ofrohet të gjithë personave që kanë sigurim shëndetësor, dhe individëve të papunë që kanë kartë shëndeti. Për këtë arsye, kthimi nga jashtë vendit pa pasur punë, nuk duhet t'i përjashtojë migrantët nga aksesi në shërbimet e kujdesit shëndetësor në vend. Megjithatë, siç kuptohet nga thënia e mëposhtme, migrantët përfitojnë nga praktikatat e mbrojtjes transnacionale sociale duke përdorur shërbimet në vendet ku migrojnë:

Për sa i përket spitaleve, kur prindërit e mi kanë probleme shëndetësore, i çoj në Itali ku kemi migruar unë dhe vëllezërit e mi, sepse nuk iu besojmë spitaleve këtu (mashkull, 38 vjeç, Lezhë).

⁶⁷ Julie Vullnetari, *Shqipëria në Lëvizje: Lidhjet midis Migracionit të Brendshëm dhe Ndërkombëtar*, Amsterdam University Press 2012

Një i kthyer i moshuar tha:

“Në spital na japin ilaçe të cilësisë së dobët! Dhe mjekët në Korçë na thonë të shkojmë në Tiranë ose Greqi. As 200 euro pension nuk mjaftojnë në Korçë, dhe ne marrim 14000⁶⁸ lekë” (femër, Korçë, 63 vjeç).

Problemet shëndetësore të të kthyerit e moshuar, dhe kapaciteti i tyre i kufizuar për të përballuar shërbimet ekzistuese, sjellin migracionin me qëllim bashkimin familjar me fëmijët që jetojnë jashtë:

Ne jetojmë në kushte të vështira. Shkoj në spital, por nuk gjej ilaçet e duhura. [...] Duke qenë pensioniste, kam kërkuar ndihmë nga institucionet dhe nga Konsullata greke që të plotësoj dokumentacionet për bashkim familjar me fëmijët e mi (femër, 60 vjeç, Korçë).

Migrantët e kthyer të moshuar e kanë të vështirë të kenë jetesë të denjë në Shqipëri për shkak të pensioneve të ulëta që përfitojnë, të cilat nuk përputhen me kostot e jetesës në Shqipëri.

Migrantët e kthyer hasin vështirësi në gjetjen e një **pune**, dhe kjo vlen edhe për ata që janë të arsimuar dhe kanë kualifikime të larta:

Kam hasur vështirësi në gjetjen e një pune në Shqipëri, dhe nëse nuk ke të afërm që të të ndihmojnë, askush nuk i vlerëson kualifikimet dhe meritat e tua. As nuk më kërkuan të dërgoj një CV, dhe thjesht më thanë se nuk ka vend (femër, 28 vjeç, Lezhë).

Përpos kësaj, mbështetja e disponueshme për migrantët e kthyer për **ngritjen e një biznesi është shumë e kufizuar**. Në vitin 2015, shumë nga bizneset e ngritura nga migrantët e kthyer u mbyllën, për shkak të taksave të larta dhe masave shtrënguese të ndërmarra nga qeveria. Dëshira e migrantëve të kthyer për të investuar ishte e madhe:

Shpresoj që të kthehem në SHBA dhe t’iu ofroj fëmijëve të mi një jetë më të mirë, arsimim më të mirë, dhe shërbime më të mira. Fillimisht do të përpiqem të bëj diçka për vendin tim, dhe dua të gjej të gjitha mundësitë për biznes. Nuk dua të marr vendim të nxituar dhe të kthehem në SHBA para se të bindem se nuk ka më vend për investime këtu (mashkull, 45 vjeç, Shkodër).

⁶⁸ 14000 lekë janë mesatarisht 103 euro

Informuesit kyç që u intervistuan thanë se **fëmijët** kanë përparësi në institucionet shqiptare. Në parim, fëmijët shqiptarë që kthehen nga jashtë dhe fëmijët e migrantëve të huaj në Shqipëri përfitojnë akses në shkollë dhe kujdes shëndetësor me bazë jodiskriminuese. Megjithatë, kjo nuk përkon me fjalët e migrantëve të tjerë në intervista. Një migrante e kthyer e përmblodhi përvojën e saj me shërbimet në Shqipëri pasi ishte kthyer, si vijon:

Si përfundim, Këshilli i Qytetit është indiferent, zyrat e punësimit janë të aksesueshme, por nuk zgjidhin asgjë, shkollave iu mungon orientimi lidhur me trajtimin e fëmijëve të kthyer në nevojë, spitalet nuk i ofrojnë shërbimet siç duhet, dhe komunikimi në përgjithësi është i dobët! (femër, 34 vjeç, Tiranë).

Megjithëse arsimimi është shërbimi më universal dhe i ndarë në mënyrë të barabartë, prindërit dhe fëmijët mendojnë se cilësia e arsimit, integritit social, dhe argëtimit të fëmijëve në shkollë është në nivel të pakënaqshëm. Mësuesit theksojnë faktin se nevojitet shumë punë për të mbështetur fëmijët e kthyer nga migracioni.⁶⁹

Një prirje interesante që doli në pah në Lezhë lidhet me situatën e adoleshentëve që janë kthyer nga emigracioni. Një baba që është kthyer nga Italia tha:

Të dy fëmijët u kthyen me ne dhe flasin mirë shqip. Ata shkojnë në shkollë në Lezhë, por nuk janë të kënaqur me kushtet që ofrohen. Në përgjithësi janë të pakënaqur, dhe kanë pasiguri, stres dhe frikë për të ardhmen e tyre në Shqipëri. Ata planifikojnë të shkojnë jashtë vendit për të vazhduar universitetin, dhe nëse nuk e arrijnë dot këtë gjë, atëherë të paktën në Tiranë. [...] Për ne është më mirë këtu në Shqipëri. Vajza ime ka në plan të shkojë në Itali, sepse ndihet si në shtëpi sa herë që shkojmë atje... (mashkull, 52 vjeç, Lezhë).

Migrantët në bashkitë e mbuluara nga kërkimi u shprehën se kujdesi ndaj fëmijëve të prindërve që punojnë është i dobët. Cilësia e ulët e strukturave shtetërore të kujdesit për fëmijët ndonjëherë anashkalohet nga migrantët e kthyer kur ata zgjedhin t'i regjistrojnë fëmijët në çerdhe dhe parashkollorë privatë, të cilët sipas tyre ofrojnë shërbime më të mira:

Siguria në shkolla dhe çerdhe dhe ajo që i ofrohet fëmijëve të mi lë shumë për të dëshiruar kur e krahasoj me shërbimet dhe mbrojtjen që Gjermania i ofron fëmijëve. Shteti ynë nuk i mbron fëmijët nëse ne si prindër nuk i mbrojmë dhe kujdesemi për ta (mashkull, 47 vjeç, Lezhë).

Disa migrantë të kthyer e përmendën largësinë dhe logjistikat e ndërlikuara për regjistrimin në çerdhe dhe parashkollorë në zonat ku jetonin. Një mama tha:

⁶⁹ Intervistë me një mësues të shkollës "Ismail Qemali", Korçë

Çerdhja e vajzës sime ndodhet në Levan dhe më duhet ta çoj çdo ditë me makinë. Ajo rri aty vetëm 4 orë, sepse ky është orari i çerdhes. Koha e kufizuar e çerdheve është problem, sepse nuk filloj dot të punoj meqenëse fëmijët nuk kanë ku të qëndrojnë. Shkolla është larg nga fshati, dhe më duhen 30 minuta me makinë për t'i çuar fëmijët atje. Në fshat nuk as kemi klinikë... (25, femër, Fier).

Gjendja në Korçë është e vështirë, dhe nuk di çfarë të bëj. Fëmijët kanë shumë kërkesa. Shkuam në Gjermani për fëmijët, por na kthyen. Po vjen pranvera, por nuk kemi para dhe asgjë. Erdhi një organizatë dhe sollën pemë Krishtlindjeje dhe atlete për fëmijët, dhe donin të bënin fotografi. Por fëmijët e mi nuk kanë për të ngrënë! Nuk kemi mundësitë bazë për të mbijetuar. Para së gjithash, na duhet një shtëpi dhe punë (pjesëtare e komunitetit rom dhe egjiptian, 36 vjeç).

Përveç ndihmës sociale të ofruar nga shteti dhe mbështetjes nga OJF-të, që në përgjithësi nuk i përmbushin të gjitha nevojat e migrantëve, edhe mbrojtja joformale luan një rol kyç në lehtësimin e problemeve me të cilat përballen familjet migrante. Solidariteti ndërmjet anëtarëve të komunitetit është ende i fortë dhe ata mund të mbështeten në ndihmën e familjeve të tjera për të plotësuar nevojat bazë, si ushqimi, rrobat, dhe strehimi, për periudha afatshkurtra pasi kthehen nga migracioni.

Personat kyç thanë se dallimi ndërmjet nevojave të grupeve të ndryshme të migrantëve është i domosdoshëm për të hartuar politika të efektshme. Ata gjithashtu e theksuan faktin se parandalimi në vend të reagimit nga ana e institucioneve do të ishte strategji e përshtatshme për t'i mbrojtur emigrantët në mënyrë të efektshme:

Ato që nevojiten janë puna, mikrokreditë për biznes, koordinim më i mirë ndërmjet pjesëve të ndryshme të administratës vendore dhe Shtetërore, [...] në mënyrë që e gjithë dinamika e migracionit të njihet paraprakisht, jo të pritët që të ndodhë dukuria...⁷⁰

⁷⁰ Intervistë me një mësues të shkollës "Ismail Qemali", Korçë

5. Përfundime

Migracioni mbetet një dukuri e rëndësishme dhe me ndikim në Shqipëri. Gjatë pesë viteve të shkuara, janë vërejtur ndryshime të mëdha lidhur me aspektet e ndryshme të migracionit jashtë, brenda, dhe drejt vendit.

Shqipëria vazhdon të ketë lloje të ndryshme të **emigracionit**. Ndërkohë që mundësitë për hyrje të ligjshme në vende të pasura evropiane janë rritur shumë me shtimin e kërkesave për vizë, mundësia që qytetarët shqiptarë të qëndrojnë dhe punojnë në mënyrë të rregullt në këto vende, mbetet ende e ulët. Kjo situatë i detyron shumë të rritur, familje, dhe fëmijë të zgjedhin mënyra të rrezikshme për të migruar, dhe/ose për t'u mbështetur te mendimi se do të marrin mbrojtje ndërkombëtare në vendet e synuara. Fëmijët bëjnë udhëtime në kushte të dyshimta që familja të mbërrijë në vendet e Evropës Perëndimore. Në raste edhe më problematike, adoleshentët nxiten të udhëtojnë vetëm, ose lihen pas nga prindërit e tyre në vendet e Evropës Perëndimore, me shpresën se do të përfitojnë leje qëndrimi, por kjo gjë sjell si pasojë cenueshmërinë dhe rrezikun e trafikimit.

Përpos kësaj, qëndrimi relativisht i shkurtër dhe kthimi i pashmangshëm pas përpjekjes së dështuar për të migruar i shkakton dëme të mëdha materiale dhe psikologjike migrantëve dhe fëmijëve të tyre, dhe këto dëme bëhen më të dukshme kur kthehen në Shqipëri. Fëmijët romë dhe egjiptianë që emigrojnë nga Shqipëria me qëllimin për të punuar në rrugë kanë qenë në qendër të disa kërkimeve deri më sot⁷¹, dhe mbeten kategori e cenueshme me nevoja të ngutshme për mbështetje.

Të dhënat nga ky raport treguan se **imigracioni** po shtohet në Shqipëri, së pari nëpërmjet migracionit të migrantëve me shumë aftësi dhe të përfshirë në veprimtari fetare, dhe së dyti si pjesë e fluksit të refugjatëve dhe imigracionit të parregullt. Imigracioni i rregullt përfshin kryesisht personat e rritur të pamartuar dhe deri në njëfarë mase edhe familjet. Në kërkimin e kryer për këtë raport ky aspekt nuk rezultoi problematik.

Nga ana tjetër, Shqipëria është prekur nga "kriza e migracionit dhe refugjatëve" e kohëve të fundit. Përmasat e këtyre lëvizjeve janë të vogla në krahasim me fluksin në rajon. Megjithatë, nevojat e këtyre individëve tregojnë mungesën e një sistemi koherent të menaxhimit të imigracionit në Shqipëri. Zbatimi i procedurave për këto grupe migrantësh është i papërshtatshëm dhe shpeshherë çon në shkeljen e të drejtave themelore. Fëmijë të moshave të ndryshme janë pjesë e këtyre flukseve, dhe hyjnë në Shqipëri si pjesë e familjeve të cenueshme, ose si të ndarë dhe të pashoqëruar. Familjet dhe fëmijët që hyjnë në mënyrë të parregullt dhe nuk aplikojnë për azil gjenden në situata të pasigurta, një fakt ky që tregon një nga aspektet më të dobëta të infrastrukturës së migracionit në Shqipëri.

Një nga gjetjet kryesore të kërkimit në rang vendor është që **migracioni i brendshëm** deri më tani është lloji më i rëndësishëm i migracionit që prek popullsinë e Shqipërisë, dhe njëkohësisht

⁷¹ Zana Vathi, *Migracioni dhe Vendosja në një Botë Lëvizëse. Migrantët shqiptarë dhe fëmijët e tyre në Evropë*, 2015

më i anashkaluari nga politikëbërësit. Migrantët e brendshëm më të cenueshëm janë ata që kanë nivel arsimor të ulët dhe jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike. Familjet dhe fëmijët romë dhe egjiptianë konsiderohen gjithashtu grup i veçantë i cenueshëm, për shkak të faktit që shpesh janë pjesë e familjeve më të varfra në vend, si dhe prej diskriminimit që përjetojnë në jetën e përditshme. Migracioni i brendshëm i kryetareve të familjeve, kryesisht drejt Tiranës, ose nga fshati drejt zonave kryesore urbane të rajonit të tyre, u konsideruan element i rëndësishëm i migracionit të brendshëm. Migrantët që kthehen nga jashtë vendit bëhen gjithashtu pjesë e këtij lloj migracioni, dhe në rastin e azilkërkuesve të kthyer ndikohet edhe migracioni i brendshëm, dhe si rrjedhojë sjell cenueshmëri në rritje, nga mundësitë e kufizuara për punë në Tiranë dhe qytete të tjera.

Megjithëse Shqipëria nuk i ndalon haptazi si në të shkuarën qytetarët e saj që të migrojnë brenda vendit, fakti që migrantët e brendshëm nuk kanë akses në shërbimet sociale në zonat ku duan të jetojnë pa pasur regjistrim paraprak, sjell një lloj "migracioni të brendshëm të parregullt". Duke pasur parasysh gjendjen e tmerrshme të sektorit të bujqësisë në Shqipëri, por edhe ligjin arbitrar për ndarjen e tokës në fillimin e viteve 1990, shumë qytetarë shqiptarë që vijnë nga zonat rurale kanë një ngastër toke tek e cila nuk mundën ose nuk duan të investojnë për të përballuar jetesën, por kanë ende mangësi lidhur me migracionin në zona urbane. Zbatimi i ligjit të ri për ndihmën sociale ka rëndësi të madhe për zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat përballet kjo kategori migrantësh dhe fëmijët e tyre.

Të dhënat nga ky kërkim tregojnë se **migracioni i kthimit** ka qenë lloj i spikatur migracioni gjatë viteve të kaluara (më së shumti 2010-2015). Dallimi ndërmjet migrantëve ekonomikë afatgjatë dhe ata që kthehen pas një aplikimi të refuzuar për azil është shumë i rëndësishëm. Dallimet kryesore lidhen së pari me profilin socio-ekonomik. Azilkërkuesit e refuzuar në përgjithësi kanë nivel arsimor të ulët dhe burime të pakta financiare. Së dyti, meqenëse kanë kaluar shumë kohë jashtë vendit, migrantët e kthyer afatgjatë në përgjithësi përballen me tronditje të madhe kulturore kur kthehen, gjë që e pengon aftësinë e tyre për t'u riintegruar. Megjithatë, azilkërkuesit e refuzuar kthehen në një gjendje edhe më të varfër në krahasim me atë që ishin para se të migronin, për shkak të investimit të kapitalit të tyre në pagesën e udhëtimit të familjes jashtë vendit. Ndryshe nga migrantët afatgjatë, ata nuk kanë pasur mundësi të përvetësojnë aftësi të reja profesionale. Si rrjedhojë, migrantët e kthyer afatgjatë kanë pritshmëri dhe përparësi të ndryshme ndaj institucioneve. Ata duan të investojnë në burimet dhe kapacitetet që kanë mbledhur gjatë viteve që kanë jetuar jashtë vendit, me synimin që fëmijët e tyre të përfitojnë nga mbështetja e madhe për riintegrim në shkollë dhe komunitet. Azilkërkuesit e refuzuar duket se përqendrohen te format bazë të mbështetjes (të ardhurat për mbijetesë, akomodimi, dhe çdo lloj punësimi).

Krahas këtyre prirjeve në rang kombëtar, pozicioni gjeografik i **secilës bashki**, dallimet socio-kulturore dhe ekonomitë ekzistuese vendore duket se ndikojnë te këto lloj lëvizjesh, te intensiteti i fluksit të migrantëve, dhe funksionimi i sistemit të mbrojtjes sociale në secilin bashki. Për shembull, në Tiranë ka pasur migracion të madh të brendshëm që prej fillimit të viteve 1990. Industria e naftës në Fier ka tërhequr shumë migrantë, që vijnë nga vende të ndryshme, duke përfshirë Kanadanë. Sektori bujqësor në Fier gjithashtu iu jep disa nga migrantëve të kthyer mundësinë për t'u marrë me punë joformale në toka bujqësore. Lezha duket se ka krijuar një sistem më të fortë të shërbimeve sociale private dhe joformale në zona rurale. Për sa i përket fluksit të refugjatëve, Korça është pikë hyrëse. Tirana, me infrastrukturën që ka, është qendra e shqyrtimit të kërkesave për azil, dhe paraburgimit të migrantëve të parregullt, ndërsa Shkodra është pikë dalje për refugjatët që synojnë të shkojnë në vende më të zhvilluara evropiane pasi

kalojnë nëpër Shqipëri. Këto dhe ndryshime të mëtejshme kërkojnë përgatitjen e shërbimeve për migrantët në rang vendor që t'iu përshtaten nevojave të tyre të përditshme.

Fëmijët janë shumë të prekur nga të gjitha llojet e sipërpërmendura të migracionit, megjithëse janë mbledhur vetëm pak të dhëna për situatën e tyre në ndihmë të raportit. Gjetjet nga kërkimet tregojnë që procedura dhe ofrimi i shërbimeve nuk është gjithmonë i përshtatshëm dhe i organizuar aq mirë sa duhet, pavarësisht faktit që në bazë të ligjeve aktuale në Shqipëri atyre u takojnë këto shërbime. Njëkohësisht, për shkak të mungesës së përgjithshme të konsideratës si një faktor që cenon migrantët dhe familjet e tyre, ndodh shpesh që fëmijët të jenë lidhja e vetme ose kryesore ndërmjet familjes migrante dhe shërbimeve sociale.

Ashtu si të rriturit, edhe fëmijët ndahen në grupe të ndryshme migrantësh hyrës, dalës dhe të brendshëm në Shqipëri. Këto grupe janë: migrantë afatgjatë dhe afatshkurtër të kthyer, qytetarë shqiptarë apo të huaj të ndarë dhe të pashoqëruar, fëmijë që janë migrantë të brendshëm dhe kanë migruar kryesisht me familjet e tyre disa prej të cilëve janë migrantë të kthyer vetë, dhe fëmijë që janë kthyer vetëm apo me familjet e tyre pas një aplikimi të refuzuar për azil. Megjithëse këta fëmijë kanë të drejta të përbashkëta, nevojat e tyre specifike ndryshojnë. Për shembull, fëmijët e migrantëve afatgjatë të kthyer duhet të integrohen në Shqipëri, pasi përvoja e tyre në Shqipëri ose ka qenë shumë e kufizuar, ose ata që kanë lindur jashtë vendit nuk kanë pasur fare përvojë. Ata kanë shumë nevojë për ndihmë psikologjike, më së shumti sepse nuk kanë aftësi gjuhësore. Integrimi në sistemin arsimor është tejet i vështirë dhe i ndërlikuar, kjo për shkak të ndryshimeve ndërmjet sistemeve të arsimit të Shqipërisë me ato të shteteve ku jetonin më parë. Fëmijët e familjeve azilkërkuese të kthyer përfundojnë çaste jo të mira për shkak të çrrënjësjes dhe kthimit të papritur në Shqipëri, kthim që ndodh pasi ata sapo ishin integruar në shtetet ku kërkonin azil. Kjo përvojë u dëmton edhe shkollimin në të dyja vendet, po ashtu edhe lidhjet shoqërore dhe emocionale të tyre. Për më tepër, ajo tregon hapur ndryshimet ndërmjet shërbimeve dhe mundësive që kanë fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri, krahasuar me disa nga vendet më të pasura evropiane.

Gjetjet e këtij raporti janë përqendruar te tre karakteristikat kryesore të funksionimit të **sistemeve të mbrojtjes sociale për migrantët në Shqipëri. Këto tre karakteristika janë: mospërputhja ndërmjet përparësive në rang kombëtar, dhe situatës dhe çështjeve të përditshmërisë në rang vendor; reagimi, dhe jo parandalimi, ndaj llojeve të rrezikshme të migracionit dhe rezultateve të tyre të dëmshme; dhe fakti që edhe pse po krijohen politika dhe programe në përputhje me standardet ndërkombëtare, zbatimi i tyre vazhdon të përbëjë një problem.**

Sistemet e menaxhimit të migracionit dhe mbrojtjes sociale në Shqipëri karakterizohen nga një mungesë e përgjithshme e koordinimit të mjaftueshëm ndërmjet institucioneve, shtuar kjo mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Përpos burimeve njerëzore të pakta të vëna në dispozicion, kapaciteti i tyre për të ndihmuar me efikasitet migrantët e rritur, familjet dhe fëmijët është i kufizuar, pasi profesionistët e përfshirë i kanë të kufizuara mundësitë e trajnimit.

Ndihma dhe mbrojtja që u ofrohet migrantëve në Shqipëri është vetëm kundrejt një grupi të kufizuar të njerëzve të "cenueshëm" dhe si rrjedhojë, përjashtohen ata që e kanë vërtet të nevojshme ndihmën. Për sa i përket fëmijëve, veçanërisht fëmijëve të shqiptarëve të pashoqëruar që kthehen në Shqipëri, ata janë grupi i vetëm i fëmijëve në lëvizje që përcaktohen si në nevojë për masa të dedikuara mbrojtjeje. Në të vërtetë, në Shqipëri, migrantët nuk konsiderohen si një kategori e veçantë që duhet trajtuar me përparësi. Ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë, edhe migrantët kanë akses në të gjitha shërbimet, por siç është përmendur më parë në këtë raport,

në praktikë ky akses është i kufizuar për shkak të mosbesimit në institucione dhe pengesave administrative. Kur migrantët flasin për mbrojtjen sociale që ofron shteti, më së shumti i referohen mungesës së saj.

Për sa i përket lidhjes ndërmjet migracionit dhe mbrojtjes sociale, kuadri i politikave është nxitur më së shumti nga kërkesa dhe përparësitë e vendosura në shkallë ndërkombëtare për shtetin, kryesisht si pjesë e procesit të aderimit në BE. Edhe pse jo domosdoshmërisht, përparësitë e sipërpërmendura pasqyrojnë nevojat kryesore të migrantëve, familjeve dhe komuniteteve të tyre dhe autoriteteve vendore që u vijnë në ndihmë atyre. Për më tepër, ligjet dhe politikat aktuale nuk janë në të njëjtën linjë me zhvillimet e fundit të prirjeve të migracionit. Këtë e tregon dhe fluksi hyrës i fundit, ndonëse i kufizuar, i migrantëve dhe refugjatëve.

Rrjedhimisht, ka mjaft të dhëna që tregojnë se migrantët mbështeten te strategjitë joformale të mbrojtjes sociale, përfshirë këtu mbështetje nga familjet, miqtë e tyre dhe rrjetet më të gjera në të cilat ata marrin pjesë, apo që i krijojnë si pjesë të procesit të tyre të migracionit apo kthimit. Shërbimeve dhe mbështetjes së gjithanshme të individëve, familjeve dhe fëmijëve të prekur nga migracioni i vijnë në ndihmë vlerat kulturore të solidaritetit, dhembshurisë dhe komunitetit. Boshllëqet e krijuara në rang vendor në mbrojtjen sociale publike, sidomos në disa nga zonat e analizuara, po mbushen nga ndihma dhe mbrojtja e ofruar nga OJF-të.

Një çështje shumëdimensionale është edhe ofrimi i mbrojtjes dhe ndihmës për migrantët, dhe në veçanti për fëmijët e prekur nga migracioni në Shqipëri. Gjendja ndryshon për emigrantët, migrantët e brendshëm dhe imigrantët. Të drejtat e emigrantëve në legjislacionet dhe fjalimet publike të shteteve pritëse janë tepër të kushtëzuara. Të drejtat e imigrantëve preken nga parimi i përgjithshëm që udhëheq mbrojtjen sociale të migrantëve nëpër botë. Sipas këtij parimi, mbrojtja sociale e plotë u jepet të gjithë atyre që kanë status ligjor të rregullt në Shqipëri. Të drejtat e migrantëve të brendshëm bëjnë pjesë në një kuadër më të gjerë të mbrojtjes sociale për qytetarët shqiptarë, megjithëse ata që janë shumë në nevojë "harrohen" nga sistemi pasi nuk kanë akses ndaj këtyre shërbimeve. Më pas, ofrimi i shërbimeve i nënshtrohet burimeve të kufizuara njerëzore dhe materiale.

Edhe pse krijimi i një sistemi funksional dhe koherent për mbrojtjen e migrantëve të rritur dhe fëmijë është një detyrë jashtëzakonisht e madhe dhe e vështirë, siç po e tregojnë shumë shtete të pasura, do ishte mirë që disa masave të ngutshme t'u jepej përparësi në Shqipëri. Këtu përfshihen, në veçanti: forcimi i bashkëpunimit transnacional me shtete ku migrojnë numri më i madh i qytetarëve shqiptarë; sqarimi i procedurave për refugjatët dhe migrantët që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të parregullt në një shtet dhe për shtetasit shqiptarë të riatdhesuar, sidomos fëmijë; sqarimi i hapave të njëpasnjëshëm të ndërmarrë në rang kombëtar dhe mbështetja e institucioneve vendore duke i vënë më shumë burime në dispozicion, që ata të mund të ofrojnë shërbime në përputhje me ligjin.

Një çështje e rëndësishme e studimit ishte fakti që familjet dhe qytetarët duhet t'i kërkonin shërbimet dhe jo që shteti t'ua ofronte këto shërbime njerëzve që kanë nevojë për mbështetje. Kjo përbën një rëndësi të madhe për sa i përket statusit dhe të drejtave të fëmijëve. Fëmijët nuk i drejtohen dot vetë shërbimeve sociale, pasi ata nuk kanë një agjenci ligjore dhe politike të tyre, dhe kjo do të thotë se ata u nënshtrohen veprimeve të ndërmarrë nga prindërit apo kujdestarë të tjerë të rritur. Si rrjedhojë, duhet që aksesit në shërbime dhe ofrimi e këtyre shërbimeve të përmirësohen, që këto t'u ofrohen qytetarëve në nevojë, dhe që të shmanget marginalizimi i fëmijëve.

Si përfundim, ky kërkim tregoi qartë që një rëndësi thelbësore ka lufta kundër varfërisë dhe sigurimi i kushteve të denja të jetesës për çdo individ në Shqipëri. Kjo duhet të lidhet me masat e ndërmarra për luftimin e diskriminimit në shtresat më të cënueshme të popullsisë, veçanërisht minoritetet etnike dhe migrantët e brendshëm.

6. Rekomandime

Kuadri ligjor, i politikave dhe institucional i lidhur me menaxhimin e migracionit duhet përmirësuar në disa fusha në rang kombëtar. Rekomandohet që të:

- *Përmirësohet infrastruktura dhe menaxhimi i migracionit.* Në Shqipëri duhet të krijohet dhe zbatohet një politikë afatgjatë migracioni. Kjo politikë duhet të ketë si përparësi zgjerimin e mundësive ligjore të emigracionit për arsye pune dhe trajnim profesional. Është e rëndësishme që Zyrat e Punësimit dhe MMSR-ja, në partneritet me qeveritë e huaja dhe agjencitë e punësimit, të identifikojnë nevojat për fuqi punëtore në tregun evropian dhe të promovojnë emigracionin e ligjshëm. Kjo duhet të bëhet me anë të investimeve në fushën e trajnimeve dhe aftësive profesionale të migrantëve të ardhshëm në Shqipëri. Gjithashtu, kjo politikë duhet të bëhet e ditur dhe të kontribuojë më tepër për një sistem më të mirë të mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave për sa i përket të gjitha llojeve të migracionit në vend.
- *Ofrohen shërbimet, dhe buxhetimi i tij në rang qendror të trajtohet si përparësi.* Gjetjet e kërkimit tregojnë se shërbimeve në rang vendor nuk iu është caktuar një buxhet për rang qendror, por në të vërtetë varen nga fondet e donatorëve. Në mënyrë që Shqipëria të përmbushë qëllimet e veta të migracionit dhe mbrojtjes sociale, duhet që përparësi e buxhetit të saj kombëtar të bëhet ofrimi i shërbimeve dhe i burimeve njerëzore dhe materiale migrantëve.
- *Analizohet zbatimi i ligjit.* Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri, kuadri ligjor i migracionit është përmirësuar mjaftueshëm, por i mungojnë aktet nënligjore dhe akte të tjera më specifike, që janë të nevojshme për përdorimin e ligjit në rang vendor dhe nga ata që e zbatojnë.
- *Përmirësohen ligjet, procedurat dhe institucionet e mbrojtjes së fëmijës dhe t'i jepet autorizimi për trajtimin e rasteve të fëmijëve migrantë.* Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës duhet të marrë rolin udhëheqës për sa i përket koordinimit të sistemeve të mbrojtjes dhe ndihmës së fëmijës. Këshilli Kombëtar duhet të marrë udhëheqjen për sa i përket krijimit të një sistemi të mbrojtjes së fëmijës dhe për koordinimin e qeverisë. Për më tepër, qeveria duhet të krijojë buxhete mbështetjeje për arsimimin dhe përfshirjen e fëmijëve migrantë, sidomos për familjet emigrante dhe ato në nevojë.

Nga ky studim u zbulua që ka një mbivendosje të grupeve të ndryshme të fëmijëve dhe të të rriturve të përfshirë në migracionin jashtë, brenda dhe përgjatë Shqipërisë. Gjithashtu, u zbulua se institucionet përgjegjëse për ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjen, nuk i kushtojnë vëmendje të barabartë këtyre grupeve. Në mënyrë që të njihen në praktikë të gjitha llojet e migracionit dhe të gjithë individëve të përfshirë t'iu kushtohet vëmendja e nevojshme, rekomandohet që:

- *Migracioni i brendshëm të konsiderohet si një lloj i rëndësishëm i migracionit, që lidhet me politikëbërjen.* Prova të nxjerra nga ky raport tregojnë se migrantët e brendshëm e kanë të vështirë të kenë akses në shërbime si ndihmë sociale, strehim, punësim, dhe se

ata nuk kanë një status të veçantë që njihet pozitën e tyre të marginalizuar. Migrantët e brendshëm në Shqipëri duhet të njihen si një grup i cënueshëm, që kanë nevojë për ndihmë.

- *Mbështetja e duhur të jepet për të ndihmuar migrantët gjatë procesit të tyre të riintegritimit.* Migrantët që kanë kaluar shumë vite jashtë vendit dhe që kthehen në Shqipëri përballen me vështirësi të mëdha, sidomos për sa i përket aksesit në mundësi strehimi dhe punësimi. Mund të përgatitet një inventar i aftësive të përvetësuar nga ata gjatë procesit të emigracionit dhe të konsiderohet si një bazë për të mbështetur punësimin dhe hapjen e bizneseve të reja. Masat për të nxitur hapjen e bizneseve të reja nga migrantët e kthyer, mund të përfshijnë edhe përjashtimin nga taksat gjatë muajve të parë të hapjes së biznesit apo edhe ofrimin e mjediseve të punës.
- *Trajtimi i imigrantëve dhe azilkërkuessve që hyjnë në mënyrë të parregullt të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme.* Kërkimi tregoi që trajtimi i migrantëve dhe azilkërkuessve që qëndrojnë në mënyrë të parregullt nuk përmbush standardet bazë të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Duke pasur parasysh rritjen e mundshme të numrit të këtyre migrantëve, të gjitha procedurat për trajtimin e këtij grupi në rrezik të të rriturve, fëmijëve dhe familjeve duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi të hollësishëm.

Masa të mëtejshme me përparësi, që duhen miratuar në rang kombëtar përfshijnë:

- *Trajtimin si përparësi të çështjes së regjistrimit dhe pajisjes me dokumente të fëmijëve, veçanërisht të atyre që kanë përjetuar migracionin e kthimit apo riatdhesimin.* Pajisja me dokumente është një çështje tepër e rëndësishme pasi kjo parandalon miratimin e dispozitave të përgjithshme për fëmijët dhe familjet. Pajisja me dokumente e fëmijëve të kthyer nga migracioni dhe për të tjerë të ardhur nga vende të tjera, kërkon që të ketë bashkëveprim të fortë në rang vendor, kombëtar dhe transnacional.

Në mënyrë që shërbimet t'u ofrohen siç duhet familjeve dhe fëmijëve migrantë në terren duhet të trajtohen një sërë mangësish në rang vendor. Si përparësi, rekomandohet që:

- *Të përfshihen të gjitha institucionet që u ofrojnë migrantëve shërbime sociale për sa i përket analizimit të procedurave standarde të funksionimit, që përcaktojnë çfarë dhe kur do ndodhë, dhe identifikojnë institucionet përgjegjëse për çdo veprim të kryer dhe ndërveprimin ndërmjet strukturave të migracionit dhe shërbimeve sociale.* Mbështetur në një sërë procedurash të reja, duhet që identifikimi dhe referimi i rasteve të mundshme që kanë nevojë për ndihmë dhe mbrojtje të fillojë që në kufi. Policia Kufitare dhe e Migracionit duhet të regjistrojë si migrantë qytetarët e ripranuar dhe ata të kthyer në mënyrë vullnetare. Gjithashtu, ajo duhet t'ua përcjellë të dhënat e tyre Sporteleve të Migracionit në bashkitë e destinacionit të personave në fjalë.
- *Të përmirësohen burimet njerëzore dhe financiare të Sporteleve të Migracionit.* Sportelet e Migracionit duhet të pajisen me stafin dhe fondet e nevojshme që të mund t'u ofrojnë mbështetje të pavarur grupeve të tyre të synuara. Këto institucione duhet të kenë një rol proaktiv për sa i përket komunikimit me individë dhe familje që kanë të drejtën e mbështetjes së tyre, bazuar në praktikat e mira në zonë. Sportelet e Migracionit duhet t'u shërbejnë po njësoj edhe migrantëve të brendshëm.

- *Të ofrohet mbështetje për shpenzimet e jetesës.* Qeverisja vendore duhet të ofrojë ndihmë sociale dhe strehim në përputhje me nevojat e plota të banorëve. Aksesit ndaj kësaj mbështetjeje duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë.
- *Të ofrohet ndihmë për punësimin dhe vetëpunësimin.* Sportelet e Migracionit duhet të kenë një regjistër me aftësitë e migrantëve dhe një profil të punëve që u përshtaten atyre. Zyra e Punësimit duhet të luajë rolin e ndërmjetësit me komunitetin e biznesit dhe agjencitë private të punësimit, që të mund të gjejnë punë të denja dhe në përputhje me potencialin dhe aftësitë e migrantëve. Përparësia e Zyrës së Punës duhet të jetë punësimi i migrantëve.
- *Të përhapen sa më shumë të dhënat për programet e formimit profesional.* Duhet të rriten mundësitë për punësim të të rinjve dhe njerëzve në nevojë. Aftësitë e punës të të rinjve duhet të forcohen me anë të orientimit për formimin profesional dhe arsimin e nivelit të lartë, dhe me anë të promovimit të mësimit të gjuhëve të huaja, si mënyrë për të rritur mobilitetin e tyre në tregun e punës.

Aneksi 1- Bibliografia

Raportet:

1. Fëmijët e ndarë në programin e Evropës ('SCEP'), *Deklaratë e Praktikës së Mirë, Botimi i 4-të i rishikuar*, 2009.
2. SCEP/Save the Children, *Dokument qëndrimesh për parandalimin dhe reagimin ndaj trafikimit të fëmijëve në Evropë*, 2007.
3. GRETA, *Raport për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga Shqipëria. Raundi i dytë i Vlerësimit*, Këshilli i Evropës, qershor, 2016
4. Zana Vathi, *Migrating and Settling in a Mobile World. Albanian Migrants and their Children in Europe*, 2015
5. Russell King, "Across the sea and over the mountains: Documenting Albanian migration", in *Scottish Geographical Journal* VËLLIMI 119 , ISS. 3, 2003
6. Peggy Levitt, Charlotte Lloyd, Armin Mueller dhe Jocelyn Viterna, "Global Social Protection: Setting the Agenda", në *RSCAS 2015/78*
7. Julie Vullnetari, *Albania on the Move: Links between Internal and International Migration*, Amsterdam University Press 2012

Linqet:

8. http://www.who.int/maternal_child_adolescent/topics/adolescence/dev/en/
9. <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/youth/youth-definition/>
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32004L0083:en:HTML>
10. <http://www.unrefugees.org/what-is-a-refugee/>
11. <http://www.migrationpolicy.org/article/embracing-emigration-migration-development-nexus-albania>
12. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AI33020>
13. http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013_.pdf
14. <http://www.unhcr.org/uk/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html>
15. <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-kosovo-top-german-2015-asylum-seekers-list-01-07-2016>
16. http://www.instat.gov.al/media/255982/return_migration_and_reintegration_in_albania_2013_.pdf
17. http://www.albania.iom.int/publications/reports/Profili_i_zgjeruar_i_migracionit_ENG_web.pdf
18. http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kushtetuta_e_republikes_se_shqiperise_1298.pdf
19. http://www.pp.gov.al/web/ligj_per_emigrimin_36.pdf

20. <http://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/07/LIGJ-Nr.-10-129-dat%C3%AB-11-5-2009-P%C3%8BR-GJENDJEN-CIVILE.pdf>.
21. <http://www.infocip.org/al/?p=6833>.
22. http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/13-11-14-04-05-08ligji_per_te_Huajt.pdf.
23. https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2015/10/ligj_nr_121_dt_18_9_2014_19228_11.pdf.
24. <http://dx.doi.org/10.1080/00369220318737179>
25. <http://link.springer.com/book/10.1007%2F978-3-319-13024-8>
26. https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/jha/117555.pdf
27. <http://www.unhcr.org/uk/statistics/unhcrstats/576408cd7/unhcr-global-trends-2015.html>
28. https://www.academia.edu/9693031/Children_and_Adolescents_on_the_Move_Involved_in_Street_Work_in_Albania_and_Kosovo_Transnational_and_Internal_Patterns_Terre_des_Hommes
29. http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/Marrevshja_e_Stabilizim-Asocijimit.pdf.
30. <http://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/01402380601019613>
31. <https://www.opensocietyfoundations.org/explainers/understanding-migration-and-asylum-european-union>
32. <http://www.adriapol.al/resources/National-Strategy-for-Development-and-Integration.pdf>
33. http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=2682423
34. <http://www.oapen.org/search?identifier=419372;keyword=vullnetari>
35. <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/imig.12230/full>
36. <http://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1111/imig.12230/full>

Aneksi 2 - Lista e të intervistuarve⁷²

Të intervistuarit në rang kombëtar

Znj. Elona Gjebrea, Koordinatore Kombëtare Antitrafik dhe Zëvendës Ministre, Ministria e Punëve të Brendshme

Znj. Alma Mele, Drejtoreshë e Azilit në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Znj. Enkeleda Toska, Drejtoreshë e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Përfaqësues i një Institucioni Antitrafik

Znj. Deneda Seferi, Drejtoreshë e Drejtorisë së Përkujdesit Shoqëror dhe Shërbimeve të Integruara, MMSR

Znj. Silva Banushi, Përfaqësuese e Zyrës së Migracionit dhe Mbrojtjes Sociale, MMSR

Znj. Ina Verzivolli, Drejtoreshë e Agjencisë Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, MMSR

Igli Totozani, Avokati i Popullit

Znj. Emira Galanxhi, Përfaqësuese e INSTAT

Marie Verney, Drejtoreshë e UNHCR-së

⁷² Lista e të intervistuarve e paraqitur më poshtë është e paplotë, pasi disa nga të intervistuarit të institucioneve në rang vendor kishin dëshirë që emrat e tyre të mos përmendeshin në raportin e kërkimit.

Të intervistuarit në Tiranë

Ekspert i Zyrës së Punës, Tiranë

Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës, Njësia Nr. 7, Tiranë

Përfaqësues i Policisë Kufitare dhe Migracionit, Tiranë

Drejtori i shkollës 9-vjeçare “Naim Frashëri”, Tiranë

Mësues në një shkollë 9-vjeçare në Tiranë

Përfaqësues i OJF-së “SHKEJ” (Shoqata Kombëtare “Edukim për Jetën”)

Përfaqësues i organizatës “ARSIS”

Të intervistuarit në Shkodër

Përfaqësues i Zyrës së Punësimit

Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social

Përfaqësues i Drejtorisë së Shëndetit Publik

Punonjës i të Drejtave të Fëmijës në Prefekturë

Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki

Përfaqësues i Zyrës së Migracionit dhe Policisë Kufitare

Psikolog për fëmijë në Policinë Kufitare dhe Migracionit

Përfaqësues i sektorit të dhunës në familje në Policinë e Shtetit

Përfaqësues i Qendrës së Formimit Profesional

Përfaqësues i OJF-së “Gruaja për Gruan”

Përfaqësues i OJF-së “ACLI”

Përfaqësues i OJF-së “Gruaja në Zhvillim”

Të intervistuarit në Lezhë

Dy përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social

Përfaqësues i Drejtorisë Arsimore Rajonale

Përfaqësues i Zyrës së Punësimit

Përfaqësues i OJF-së “Integrimi i romëve në veri”

Përfaqësues i Observatori i të drejtave e fëmijëve

Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijës në Bashki

Përfaqësues i Qendrës “Shën Maria”

Përfaqësues i Qendrës Kulturore për Fëmijë, Lezhë

Përfaqësues i Zyrës së Emergjencave Civile, Lezhë

Të intervistuarit në Fier

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë e Fierit

Përfaqësues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social

Përfaqësues i Policisë Kufitare dhe Migracionit

Përfaqësues i Sektorit të dhunës në familje në Bashkinë e Fierit

Përfaqësues i shoqatës “Rruga e Dritës”

Përfaqësues i Qendrës së Formimit Profesional Publik

Përfaqësues i Shërbimeve psikologjike në shkollë

Përfaqësues i Zyrës së Punës, Fier

Të intervistuarit në Korçë

Oficer i policisë gjyqësore nga Policia Kufitare dhe Migracionit

Përfaqësues i Policisë Kufitare dhe Migracionit

Drejtori i gjimnazit “Ismail Qemali”

Infermier dhe pediatër në qendrën e kujdesit shëndetësor parësor



Dy avokatë që u ofrojnë shërbimet e tyre familjeve të cënueshme
Përfaqësues i OJF-së "World Vision" në Korçë
Përfaqësues i OJF-së "Misioni Emanuel"
Qëndistari OBK "Qëndistarët"

Migrantët e intervistuar						
Bashkia	Migrantët		Pjesëtarët e familjes		Personat Kyç	Gjithsej
	F	M	F	M		
Shkodër	6	9	10	2	11	38
Lezhë	3	11	5	8	9	36
Tiranë	-	-	-	-	15	15
3) Kombëtar 4) Vendor	5	5	12	11	8	41
Fier	6	4	3	8	8	29
Korçë	9	1	14	21	9	54
Gjithsej (pjesëmarrës)	29	30	44	50	60	213
	59		94			

Aneksi 3 - Gjetjet sipas bashkive

Tiranë

I intervistuari	Migrantë		Persona të tjerë kyç		
	10		7		
Gjinia e migrantit	Mashkull		Femër		
	5		5		
Lloji i migracionit	I brendshëm		Ndërkufitar		
	2		8		
Gjendja civile	I martuar		I divorcuar		Beqar
	6		1		
Arsimi	Fillor		I mesëm		I lartë
	4		3		

Demografia e migrantëve të intervistuar në Tiranë (edhe pse është një kampion i vogël dhe jo përfaqësues) tregon që migracioni ndikon te njerëzit me disa karakteristika demografike dhe prejardhje socioekonomike të caktuara.

Emigracioni. Një prirje mbizotëruese që nga fillimi i viteve 1990 ka qenë dhe emigracioni nga Tirana drejt shteteve të Evropës Veriperëndimore dhe më tej. Në vitin 2015, u vu re një valë e re emigracioni, një emigracion i qytetarëve shqiptarë që kërkonin azil ekonomik jashtë vendit, sidomos në Gjermani dhe Francë. Shumica e këtyre migrantëve janë të papunë dhe kanë nivel

arsimor të ulët. Disa prej tyre kanë qenë migrantë të brendshëm, por kanë deklaruar që nuk ndiheshin të integruar në Tiranë. Ata u detyruan të migronin jashtë vendit për shkak të kushteve shumë të këqija të jetesës, aksesit të ulët ndaj shërbimeve dhe nga mungesa e shërbimeve të duhura (sidomos ato të shëndetësisë). Ata migruan me shpresën se mund të gjenin një mënyrë më të mirë për të jetuar.

Imigracioni. Imigracioni në Tiranë ka të bëjë me hyrjen dhe qëndrimin ligjor në Shqipëri të qytetarëve të huaj dhe migrantëve të parregullt, përfshirë dhe azilkërkuesit. Një numër i madh i qytetarëve të huaj qëndrojnë në Shqipëri për punë, çështje biznesi, për anëtarët e familjes apo për arsye të tjera. Gjatë pesë viteve të fundit, numri i qytetarëve të huaj me leje pune është rritur. Sipas zyrës së migracionit në MMRS, shifrat janë rritur nga 1,608 në vitin 2010 në 1,711 në vitin 2015. Në Tiranë ndodhen ndërtesat kryesore të akomodimit dhe shqyrtimit të rasteve të azilkërkuesve dhe migrantëve të parregullt në Shqipëri.

Migracioni i brendshëm. Migracioni i brendshëm ka të bëjë me lëvizjet nga zonat periferike tek ato urbane të Tiranës dhe nga qytete të vogla në kryeqytet. Qyteti që ka regjistruar rritjen më të madhe në Shqipëri gjatë 25 viteve të fundit është Tirana. Nga 250,000 banorë që kishte në vitin 1990, tani jetojnë më shumë se një milion njerëz në Tiranë. Zakonisht, në qendër të Tiranës jetojnë ata që kanë mundësi më të mira socioekonomik dhe nivel më të lartë arsimimi, ndërsa individët dhe familjet me nivel arsimimi dhe burime më të ulëta jetojnë në zonat periferike (që tani quhet “Tirana e Re”)

Migracioni i kthimit. Nga tetë rastet e emigracionit të përfshirë në kampionin e kërkimeve, gjashtë prej tyre ishin raste të azilkërkuesve që kishin shkuar në Gjermani, Francë dhe Itali, të cilët ishin kthyer pasi aplikimi i tyre ishte refuzuar nga autoritetet e atyre shteteve. Dy emigrantët e tjerë ishin kthyer në mënyrë vullnetare nga Greqia dhe Franca për shkak të krizës ekonomike në vendet e destinacionit, gjë që i pakësonte atyre mundësitë për punësim. Nga viti 2011 në vitin 2015, Sportelet e Migracionit të krijuara në Zyrat e Punësimit në Tiranë, kanë intervistuar dhe referuar te shërbime të tjera për afërsisht 2,300 qytetarë shqiptarë. Këta qytetarë u kthyen në mënyrë vullnetare ose u ripranuan nga Greqia (73%), Itali (21%), shtete të tjera anëtare të BE-së (2,8%), dhe të tjera joanëtare të BE-së (1.7%)⁷³.

Migracioni dhe mbrojtja sociale. Tirana ka më shumë shërbime për fëmijët, të rinjtë, familjet në nevojë dhe minoritetet etnike, krahasuar me qytetet dhe qytezat e tjera në Shqipëri. Në Tiranë ka një numër më të madh shkollash dhe kopshtesh, spitalësh dhe institucionesh të kujdesit shëndetësor, njësisish për mbrojtjen e fëmijës, qendrash të formimit profesional dhe strehësh të përditshme për fëmijët dhe të rinjtë. Disa nga këto shërbime drejtohen nga OJF që janë në partneritet me qeverinë për të ofruar ndihmë të specializuar dhe të cilësisë së lartë ndaj njerëzve në nevojë.

73 Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Qytetarëve Shqiptarë 2010-2015

Korçë

I intervistuari	Migrantë		Persona të tjerë kyç	
	10		10	
Gjinia e migrantit	Mashkull		Femër	
	1		9	
Lloji i migracionit	I brendshëm		Ndërkufitar	
	2		8	
Gjendja civile	I martuar	I divorcuar	Beqar	
	8	/	2	
Arsimi	Fillor	I mesëm	I lartë	
	3	6	1	

Korça ka disa karakteristika të përbashkëta me qytetet e tjera, për sa i përket profilit të migracionit, por pozicioni kufitar me Greqinë i shton një dimension specifik emigracionit nga Shqipëria drejt këtij vendi. Rëndësia e saj në Juglindje të Shqipërisë e ka bërë Korçën shënjestër edhe të migrantëve të brendshëm. Së fundmi, Korça ka pritur refugjatë dhe migrantë, që kaluan kufirin e Kapshticës për të hyrë në Shqipëri.

Emigracioni. Një destinacion i zakonshëm i korçarëve është Greqia, për shkak të afërsisë dhe transportit të disponueshëm (makinë dhe autobus). Disa prej të intervistuarve kanë emigruar më shumë se një herë në vende si SHBA-ja dhe Kanadaja. Individë që i përkasin minoriteteve etnike dhe/ose familjeve shumë të varfra kanë shkuar në Gjermani dhe kanë aplikuar për azil. Së fundmi, një destinacion migracioni për korçarët është edhe Turqia. Përfaqësuesit e OJF-ve vendore janë të informuar për rreth 200 individë që kanë emigruar jashtë vendit me qëllim punësimin, 170 për punë sezonale, 40 për arsye personale dhe 5 për të studiuar.⁷⁴ Disa migrantë, veçanërisht familje të minoriteteve romë dhe egjiptiane, mendohet që udhëtojnë drejt Greqisë për punë sezonale apo për të lypur. Mësuesit përmendën braktisjen e shpeshtë të shkollës dhe kthimin e nxënësve të tyre. Brenda vitit akademik 2015-2016, në një nga shkollat e qytetit u larguan 40 nxënës dhe 25 u kthyen.⁷⁵

Imigracioni. Sipas të dhënave, popullsia imigrante në Korçë është e larmishme. Aty janë mbledhur qytetarë nga 18 shtete të ndryshme, nga 3 kontinente. Këto të dhëna pasqyrojnë diversitetin e popullsisë në qytetet shqiptare dhe përqendrohen te nevoja për t'i përshtatur shërbimet sipas grupeve të ndryshme. Sipas të dhënave të siguruara nga Policia e Migracionit e Korçës, në vitin 2015, 84 qytetarëve të huaj u është dhënë leje qëndrimi, me arsye: bashkimi familjar (20), pune (50), studimi (12) dhe për të qenë vullnetarë në shoqata fetare (2). Shtetas të huaj që banojnë në Korçë: 22 nga Greqia, 4 nga Gjermania, 2 nga Franca, 2 nga Mbretëria e Bashkuar, 5 nga Uganda, 14 nga Turqia, 1 nga Ukraina, 3 nga Italia, 4 nga Kosova, 6 nga Holanda, 3 nga Rumania, 1 nga Siria, 1 nga SHBA-ja, 1 nga Maqedonia, 2 nga Serbia, 1 nga Nigeria, 1 nga Moldavia dhe 3 nga Sudani.

⁷⁴ Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së "Qëndistari"

⁷⁵ Intervistë me një mësues të shkollës "Ismail Qemali"

Përfaqësuesit e Prokurorisë kanë raportuar që dinamika e imigracionit në Korçë po rritet, por nuk ka të dhëna dhe statistika sistematike. Megjithatë, ata e kanë konfirmuar faktin se ekziston dukuria e kalimit të kufirit afër Korçës nga fëmijë të pashoqëruar shqiptarë dhe të huaj. Këto të dhëna përputhen me raportet e Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare dhe të Migracionit në Korçë, përfaqësuesit e të cilëve kanë konfirmuar që migrantët e pranishëm në qytet janë më së shumti të rinj nga i njëjti rajon. Ata kanë konfirmuar edhe rritjen e pranisë së fëmijëve të huaj gjatë viteve të fundit, nga të cilët më të cenueshëm ishin ato të vendeve në luftë. Megjithatë, i njëjti institucion ka raportuar edhe që nuk kanë statistika lidhur me migracionin.⁷⁶

Migracioni i brendshëm. Korça ka që në fillim të viteve 1990 që pret migrantë të brendshëm, duke qenë se është një nga qytetet me të mëdha në Shqipëri dhe një qytet i rëndësishëm kufitar në juglindje. Statistikat lidhur me migracionin e brendshëm janë rastësore dhe të shpërndara. Disa shifra të dhëna nga një OJF vendore në Korçë tregojnë se 12 familje janë migrantë të brendshëm dhe 5 fëmijë kanë shkuar vetëm në Korçë për të lypur.⁷⁷ Migrantët e brendshëm nga zonat rurale kanë shprehur mirënjohje për mundësitë që u janë dhënë fëmijëve të tyre për t'u arsimuar në qytet. Megjithatë, ka migrantë, të cilët vijnë nga veriu i Shqipërisë, që raportojnë të jenë diskriminuar si nga komuniteti edhe nga institucionet vendore në Korçë, për shkak të prejardhjes së tyre gjeografike.

Migracioni i kthimit. Migracioni i kthimit në Korçë përfshin migrantë të kthyer nga një migracion afatgjatë jashtë vendit, azilkërkues të refuzuar dhe migrantë të kthyer për t'u vendosur në Korçë, me prejardhje nga zona të tjera më pak të zhvilluara të Shqipërisë. Sipas një OJF-je vendore, në vitin 2015, 150 migrantë janë kthyer rregullisht, ndërsa përgjatë të njëjtit vit numri i qytetarëve të kthyer në Korçë për shkak të statusit të tyre të parregullt jashtë vendit ishte 265.⁷⁸ Pasi aplikimi i tyre për azil u refuzua, numri më i madh i tyre u kthyen nga Gjermania. Disa migrantë janë kthyer dhe po bëjnë investime në Korçë duke hapur bizneset e tyre. Këta migrantë sjellin me vete ekspertizë dhe njohuri, që kanë potencialin të zhvillojnë sektorin e biznesit dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara në zonë. Për shembull, një migrante e kthyer (36 vjeçe) nga Selaniku ka investuar në një restorant, duke shfrytëzuar aftësitë e përvetësuar në Greqi. Një tjetër i kthyer nga Greqia (mashkull, 39) ka investuar në një hapësirë parkimi.

Migracioni dhe mbrojtja sociale. Intervistat me migrantët tregojnë që shërbimet publike në Korçë janë të pamjaftueshme dhe të financuara keq. Vetëm njërit prej migrantëve të intervistuar i është dhënë ndihma sociale, por asnjërit prej tyre nuk u është ofruar strehim. Zyra e Punësimit nuk ka arritur t'i gjejë punë asnjërit prej migrantëve të intervistuar. Shumë migrantë të kthyer të moshave të mesme apo të moshuar folën për kujdesin shëndetësor në Korçë, që duket se është një çështje që përmendet shpesh nga migrantët. Në mënyrë që të blejnë ilaçet dhe të paguajnë trajtimet e tyre, ata varen nga ndihma e dhënë nga fëmijët e tyre që jetojnë jashtë vendit. Raportohet që procedura për të përfituar pensione nga skema e sigurimeve sociale është e gjatë dhe e vështirë për migrantët e kthyer në Korçë pas disa vitesh jashtë vendit. Ata kanë hasur shumë probleme për sa i përket transferimit në skemën shqiptare të sigurimeve sociale të paguara jashtë vendit.

⁷⁶ Intervistë me Klenadra Vebillar, Drejtorja e Migracionit dhe Kufijve, Korçë

⁷⁷ Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së "Qëndistari"

⁷⁸ Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së "Qëndistari"

Në Korçë ndodhet edhe një rrjet OJF-sh, që u ofrojnë shërbime fëmijëve (më së shumti mbështetje për t'u integruar në shkollë), familjeve, grave dhe veçanërisht migrantëve. Të dhëna nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tregojnë se 36 fëmijë shqiptarë janë integruar ose riintegruar në shkollë gjatë vitit 2015 në qarkun e Korçës. Megjithatë, migrantët e kthyer kanë raportuar se fëmijët e tyre e kanë pasur të vështirë të integrohen në shkollë dhe në jetën sociale në Shqipëri.

Fier

I intervistuari	Migrantë		Persona të tjerë kyç	
	10		8	
Gjinia e migrantit	Mashkull		Femër	
	4		6	
Lloji i migracionit	I brendshëm		Ndërkufitar	
	3		7	
Gjendja civile	I martuar	I divorcuar	Beqar	
	8	/	2	
Arsimi	Fillor	I mesëm	I lartë	
	9	/	1	

Migracioni në Fier paraqet disa karakteristika përsëritëse, si: kushte shumë të këqija të komuniteteve rome dhe egjiptiane që i kanë detyruar të largohen, migracioni i madh sezonal drejt Greqisë, punësimi i migrantëve më së shumti në bujqësi dhe mungesa e shërbimeve të koordinimit në terren, përpos nivelit të lartë të ndërgjegjësimit të informatorëve kyç për sa i përket situatës dhe nevojave të migrantëve.

Emigracioni. Në Fier emigracioni ka qenë një prirje e vazhdueshme që në fillim të viteve 1990. Shumë njerëz emigruan jashtë vendit, më së shumti në Greqi dhe më pak në Itali dhe në vende të tjera. Në përgjithësi, këta migrantë kanë një nivel arsimor shumë të ulët dhe nuk kanë fare aftësi të specializuara profesionale. Emigracioni afatgjatë në Greqi, që ka mbizotëruar gjatë dy dekadave të fundit, së fundmi ka filluar të zëvendësohet nga emigracioni afatshkurtër dhe sezonal. Si rezultat i liberalizimit të vizave me vendet e zonës Schengen, që të siguronin të ardhura për familjet e tyre shumë qytetarë shqiptarë nga Fieri emigronin një ose dy herë në vit në Greqi për punë të përkohshme që zgjaste 90 ditë. Në përgjithësi, punëtorët sezonalë janë kryefamiljarë, burra të rritur, por edhe gra, disa prej të cilave kishin emigruar në Greqi dhe më parë për një kohë më të gjatë dhe që kanë familje apo miq që i ndihmojnë të gjejnë punë afatshkurtra. Të ardhurat nga këto punë të përkohshme përfaqësojnë të ardhurat kryesore të disa familjeve.

Emigracioni ka qenë zgjedhje edhe e shumë migrantëve të brendshëm, që nuk kanë mundur të integrohen në Fier. Sipas intervistave të migrantëve, aksesit në shërbimet e ndihmave dhe punësimit në fshatra është i ulët. Bujqësia është e prapambetur dhe shumë pak njerëz i punojnë tokat e tyre dhe nxjerrin jetesën nga ato. Fshatrat nuk kanë rrugë dhe ujësjellës kanalizimet e nevojshme, për më tepër, nuk kanë mundësi të marrin kredi që të blejnë makineritë e punës, farat apo edhe produkte të tjera të nevojshme për të punuar në sektorin e bujqësisë. Përfaqësues të Njësisë vendore për Mbrojtjen e Fëmijës kanë deklaruar se përqindja mjaft e lartë e emigracionit

në qarkun e Fierit lidhet me një numër të madh të popullsisë që i përket minoriteteve etnike rome dhe egjiptiane. Me fjalë të tjera, diskriminimi i madh i përjetuar nga këto komunitete i shtyn ata të migrojnë, që të mund të gjejnë një vend më mikpritës për të jetuar.⁷⁹

Imigracioni. Fieri ka disa rezerva të rëndësishme naftë dhe një industri shumë të rëndësishme të rafinimit të naftës, që gjatë 5 viteve të fundit janë drejtuar nga një firmë ndërkombëtare. Numri i qytetarëve të huaj që banojnë në Fier me leje qëndrimi është rritur nga përafërsisht 50 persona në vitin 2010 në 337 në vitin 2016. Kjo rritje vjen më së shumti për shkak të këtyre veprimtarive. Nga kjo shifër, 227 persona kanë leje pune, ndërsa 93 personat e mbetur ose kanë ardhur me pjesëtarët e familjes, ose merren me veprimtari fetare. Në bazë të kombësisë së tyre, banorët e huaj në Fier janë të ndarë si më poshtë: 126 kanadezë, 62 kroatë, 15 hungarezë, 49 italianë, 17 turq, 20 kosovarë, 16 rumunë dhe 5 rusë. Drejtoria Rajonale e Punësimit në Fier e konsideron shumë të nevojshëm punësimin e këtyre qytetarëve të huaj, pasi mungesa e ekspertëve të naftës do të ishte shkaku kryesor i papunësisë në rajon, që varet plotësisht nga ky sektor.⁸⁰

Në vitin 2014, policia e zonës së Fierit kapi mesatarisht 200 shtetas sirianë, që po përpiqeshin të kalonin kufirin për në Mal të Zi. Në të vërtetë, ata nuk kanë aplikuar për azil, me shumë mundësi sepse donin ta bënë këtë në një shtet anëtar të BE-së. Si rrjedhojë, ata u kthyen si imigrantë të parregulltë në vendet e tyre të fundit të origjinës, me arsyen se ekzistojnë marrëveshje dypalëshe ripranimi me Shqipërinë. Gjatë zhvillimit të intervistave nuk ka pasur raportime të migrantëve apo refugjatëve sirianë në Fier. Edhe në këtë qark është konfirmuar mungesa apo vështirësia për të pasur një përkthyes apo interpret për popullsinë e re migrante apo refugjate.

Migracioni i brendshëm. Tre migrantët e brendshëm të përfshirë në kampionin e kërkimit e kanë përshkruar gjendjen e tyre në Fier si një zgjidhje të përkohshme me të cilën nuk janë të kënaqur plotësisht. Ata kishin ardhur në Fier me shpresën se do gjenin punë dhe kështu do mund të mbanin veten dhe familjen. Gjatë kohës së tyre atje, ata bënë punë të thjeshta si kamerierë, punonjës lavazhi, sanitarë dhe nuk ishin të kënaqur me kushtet e punës dhe pagën. Është raportuar se migrantë të tjerë që jetojnë në Fier janë bërë pjesë e migracionit sezonal ndërkombëtar, që të mund të rrisin të ardhurat e familjes së tyre. Ndjesia e diskriminimit është e ngjashme me atë në Korçë dhe kjo u përmend gjatë intervistave me migrantët e brendshëm, sidomos ata nga veriu i Shqipërisë.

Migracioni i kthimit. Edhe pse ka thujtë të njëjtat karakteristika me qytetet dhe qytezat e tjera në Shqipëri për sa i përket migracionit, Fieri ka një karakteristikë të veçantë dhe ajo është kthimi i migrantëve sezonalë. Njësia vendore për Mbrojtjen e Fëmijës nuk ka dhënë shifrat e sakta të të kthyerve, por ka treguar që në Fier janë kthyer mesatarisht 50 familje. Gjithashtu, ata kanë raportuar, që ndryshe nga udhëzimi i qartë për shkollat që të përqendrohen te nxënësit migrantë të kthyer, institucioneve që janë pjesë të sistemit vendor të mbrojtjes së fëmijës nuk u është dhënë një udhëzim i qartë mbi punën që duhet të bëjnë me fëmijët migrantë të kthyer. Ndërkohë, Drejtori i Njësies së Shërbimeve Psikosociale në shkollë ka thënë se një numër shumë i madh fëmijësh janë kthyer gjatë vitit akademik 2015-2016 pasi aplikimet e tyre për azil nuk u pranuan. Përkatesisht, 170 nxënës në shkollë të mesme dhe 31 studentë në shkollë të lartë janë kthyer nga Gjermania dhe 53 janë kthyer nga Greqia.⁸¹

⁷⁹ Alma Guma, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

⁸⁰ Fatmira Vruzhaj, Drejtorja Rajonale e Punësimit, Fier

⁸¹ Intervistë me Irma Bacin



Migracioni dhe Mbrojtja Sociale. Të dhënat e marra nga puna në terren tregojnë që shërbimet publike kanë shtuar përpjekjet e tyre për t'u ofruar familjeve migrante ndihmë ekonomike dhe mbështetje integrimi apo riintegrimi që të mund të integrohen në Fier. Nëpër Pikat Kufitare shpërndahen fletëpalosje me të dhënat e kontaktit të Sportelit Vendor të Migracionit dhe shërbimet që ofron. Në bashkinë e Fierit janë krijuar njësi të reja të specializuara për mbrojtjen e fëmijës kundër dhunës në familje, ndonëse nuk i është dhënë një udhëzim i qartë, që të merren me fëmijët migrantë të kthyer dhe as nuk janë përfshirë në asnjë nga procedurat e pritjes, kthimit vullnetar, riatdhesimit, integrimin apo riintegrimin pas kthimit apo ndihmës për sa i përket transitit të këtyre fëmijëve.⁸² Ministria e Punës ka hapur një Qendër Rajonale të Formimit Profesional, që ofron kurse profesionale falas për të rinj që regjistrohen, megjithëse regjistrimet janë të kufizuara.

Është raportuar se aksesimi në shkollë për fëmijët e kthyer ka funksionuar shumë mirë për familjet migrante shqiptare të kthyer nga jashtë vendit. Fëmijët mund të regjistrohen në fillim apo në çfarëdo periudhe të vitit akademik. Fëmijëve të kthyer nga jashtë vendit iu ofrohen kurse mbështetëse të gjuhës shqipe. Në vitin 2015, në shkollat e Fierit janë kthyer dhe riintegruar 115 fëmijë gjithsej. Aksesimi në kujdesin shëndetësor përfshin vaksinimin e fëmijëve dhe të gjitha shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor të të gjithë anëtarëve të familjeve migrante. Megjithatë, mbështetja e dhënë për integrimin apo riintegrimin e këtyre familjeve në tregun vendor të punës vazhdon të jetë e pamjaftueshme. Sipas të intervistuarve, në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre, institucioneve vendore si Shërbimet Rajonale Sociale dhe Qendra Rajonale e Formimit Profesional u duhet dhënë më shumë fushëveprim dhe ndihmë financiare.⁸³

Ka një rrjet funksional OJF-sh që mbështetin familjet që jetojnë në varfëri të skajshme, si komunitetet rome dhe egjiptiane dhe familje të tjera shumë të varfra. Këto OJF mbështetin integrimin apo riintegrimin e atyre familjeve me anë të disa ndërhyrjeve, që fillojnë nga ndihma për mbijetesë që përfshin dhënie të ushqimit dhe shlyerjen e qirasë për strehimin, e deri te regjistrimi i fëmijëve në gjendjen civile dhe në shkollë, dhe mbështetja për gjetjen e punës për prindërit dhe të rinjtë me anë të mikrokredivë dhe formimit profesional. Megjithatë, disa migrantë, sidomos ata që jetojnë në fshatra thanë që largësia dhe logjistika e ndërlikuar për të shkuar në kopshte është një pengesë shumë e madhe që i pengon të shkojnë në punë.

Shkodër

I intervistuari	Migrantë		Persona të tjerë kyç
	15		12
Gjinia e migrantit	Mashkull		Femër
	9		6
Lloji i migracionit	I brendshëm		Ndërkufitar
	/		15
Gjendja civile	I martuar	I divorcuar	Beqar
	11	/	4
Arsimi	Fillor	I mesëm	I lartë
	1	8	6

⁸² Intervistë me Alma Gumën, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës

⁸³ Ilir Dano, Drejtor i Qendrës së Formimit Profesional, Fier

Për shkak të pozicionit të saj socioekonomik si një nga qytetet më të mëdha në Shqipëri, Shkodra u bë një rast studimor i rëndësishëm në hulumtimin për migracionin dhe mbrojtjen sociale. Ky qytet paraqet të gjitha prirjet kyçe të migracionit në Shqipëri dhe intervistat treguan se ishte shumë e qartë se kush janë personat kyç në funksionimin ligjor dhe të kuadrove politike për sa i përket migrantëve në vend.

Emigracioni. Lloji më i përhapur i migracionit në Shkodër (ose të paktën më i raportuari) është emigracioni. Që nga fillimi i viteve 1990, në qytet është pikasur një fluks i madh emigracioni drejt Italisë dhe Greqisë, po ashtu edhe drejt shteteve të tjera anëtare të BE-së. Ndonëse migrantët vazhdojnë të përdorin lloje të ndryshme të parregullta të migracionit, është vënë re që gjatë viteve të fundit migrantët potencialë në Shkodër kanë filluar të ndërgjegjësohen për rrezikun që iu kanoset dhe për mundësitë e pakta për integrim që i presin në vendet e destinacionit. Si rrjedhojë, numri i migrantëve që ka filluar të përdorë lloje të rregullta të migracionit sa vjen e rritet, ndonëse mundësitë mbeten të kufizuara. Ndër format ligjore të përdorura, migrantët e intervistuar kanë përmendur studimet, kontratat e punës, punët sezonale, martesat dhe lotarinë amerikane dhe kanadeze për sa i përket lejeve të qëndrimit. Të intervistuarit kanë përmendur dhe disa raste aplikimi për azil me arsye gjakmarrjen apo dhunën në familje. Policia Kufitare ka përmendur dhe emigracionin e fëmijëve të ndarë dhe të pashoqëruar si një dukuri të përsëritur. Pretendohet që fëmijët të shoqëruar nga prindërit e tyre e kalojnë ligjërisht kufirin shqiptar dhe më pas e vazhdojnë udhëtimin pa ta. Policia ka shprehur shqetësimin e saj se përgjatë udhëtimit këta fëmijë mund të bëhen viktima të trafikimit apo formave të tjera të dhunës.

Imigracioni. Qytetarët e huaj që kanë imigruar në Shkodër e kanë bërë këtë për arsye pune, për bashkim familjar, për të bërë punë vullnetare në shoqata fetare dhe për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare (personat nga Maroku dhe Siria). Numri më i madh i tyre janë meshkuj të rritur. Gjatë viteve 2010 deri në 2015, qytetarëve të huaj në Shkodër u janë dhënë leje pune si më poshtë: 112 në vitin 2010, 152 në vitin 2011, 67 në vitin 2012, 63 në vitin 2013, 29 në vitin 2014 dhe 38 në vitin 2015⁸⁴. Gjatë kohës kur bëhej kërkimi, në qarkun e Shkodrës jetonin gjithsej 1,198 të huaj dhe numri më i madh i tyre kishin ardhur si vullnetarë në shoqata fetare. Në vitin 2014, në Shkodër janë identifikuar 94 migrantë të parregulltë dhe asnjëri prej tyre nuk ka aplikuar për azil. Ka pasur vetëm 360 migrantë të parregulltë në qytet në vitin 2015, 50 nga të cilët kanë aplikuar për azil, ndërsa në vitin 2016 janë identifikuar vetëm 6 raste migrantësh të parregulltë.

Migracioni i brendshëm. Është përmendur shpesh në këtë raport që nuk ka shifra të disponueshme lidhur me migrantët e brendshëm në Shqipëri, ndonëse të gjithë ofruesit e shërbimeve në rang vendor bien dakord që ky grup përbën një pjesë shumë të madhe të familjeve të marginalizuara me të ardhura shumë të ulëta dhe që kanë nevojë për ndihmë ekonomike. Kjo prirje e përgjithshme është konfirmuar në Shkodër, ku migrantë të brendshëm në qarkun e Shkodrës zakonisht vijnë nga qytetet më të varfra dhe zonat rurale. Migrantët e brendshëm zakonisht vijnë nga familjet rome dhe egjiptiane. Personat kyç të sektorit të OJF-ve këmbëngulin, që edhe pse mendohet se migrantët ndërkombëtarë janë më të shumtë në numër, lloji kryesor i migracionit në Shkodër është ai i familjeve që vijnë nga qytete të tjera si Elbasani, Fushë-Kruja, Berati dhe më së shumti nga familjet rome dhe egjiptiane. Zyra e Punësimit ka raportuar se migrantët e brendshëm nuk bëjnë pjesë në fushën e tyre të veprimit, por nënvizon rëndësinë e ligjit të ri mbi punëkërkesit në Shqipëri, që u jep të drejtë të barabartë me banorët e Shkodrës dhe atyre që vijnë nga zonat rurale të kërkojnë shërbimet e ofruara nga kjo zyrë.⁸⁵ Përfaqësuesit

⁸⁴ Drejtoria e Migracionit në Ministrinë e Punës

⁸⁵ Intervistë me përfaqësuesin e Zyrës së Punësimit dhe Punëkërkesve në Shkodër.



e Zyrës së Formimit Profesional kanë thënë se as migrantët e brendshëm nuk bëjnë pjesë në fushën e tyre të veprimit pasi nuk janë në listën e grupeve të cenueshme që përbëjnë përparësi për Zyrën.

Migracioni i kthimit. Në Shkodër ka një numër të madh migrantësh dhe familjesh shqiptare të kthyer nga emigracioni pasi kanë humbur punën në vendet e tyre të destinacionit, si pasojë e krizave ekonomike. Ky grup përbën numrin më të madh të përdoruesve në Sportelin vendor të Migracionit. Sipas përfaqësuesve të këtij institucioni, që nga fillimi i vitit 2009, rikthimi në Shkodër ka qenë në shkallë të lartë. Ata kanë raportuar se gjatë kësaj kohe, në këtë zyrë janë regjistruar 299 migrantë të kthyer⁸⁶. Zyra e Formimit Profesional ka raportuar se migrantët e kthyer konsiderohen si një grup me përparësi, por në të vërtetë shifrat e ulëta të migrantëve të kthyer tregojnë se ata nuk janë përfitues të kësaj zyre (janë vetëm 25 në vitin 2014, 15 në vitin 2015 dhe 5 në vitin 2016).

Për sa i përket riintegrit, familjet e migrantëve të intervistuar në Shkodër nënvizuan faktin se pasi ishin kthyer, fëmijët e tyre ishin përballur me sfida të shumta. Zyra për Mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje, një institucion që është pjesë e Drejtorisë së Policisë, është përfshirë në rastet e fëmijëve të kthyer, si me familjet po ashtu edhe të ndarë apo të pashoqëruar. Ata kanë thënë se numri më i madh i këtyre fëmijëve vijnë nga zonat rurale të qarkut të Shkodrës.

Migracioni dhe mbrojtja sociale. Intervistat me personat kyç dhe migrantët kanë nxjerrë në dritë faktin që institucionet publike në Shkodër nuk kanë mjaftueshëm burime njerëzore dhe financiare për të ndihmuar migrantët dhe për të përmbushur më tej detyrat e tyre. Përfaqësues të OJF-ve kanë konfirmuar mungesën e burimeve njerëzore tek ofruesit vendorë të shërbimeve publike, po ashtu dhe aftësitë e tyre të kufizuara apo të papërshtatshme, fitimet e stafit dhe buxheti i kufizuar për zbatimin e politikave⁸⁷.

Nga të gjithë migrantët e intervistuar, vetëm 4 prej tyre kanë shkuar pranë Sportelit të Migracionit për të kërkuar punë dhe asnjëri prej tyre nuk ka asnjë falënderim për këtë shërbim. Është shumë e vështirë të merret ndihma ekonomike dhe asnjëri prej tyre nuk ka përfituar strehim nga qeverisja vendore. Disa prej të intervistuarve nuk furnizohen me ujë apo energji elektrike sepse nuk i paguanin dot faturat pas kthimit. Të gjithë migrantët e intervistuar janë ankuar për trajtimin e keq në spitale dhe në qendra të tjera të kujdesit shëndetësor.

Për sa i përket trajtimit të migrantëve të huaj, nuk vihet re asnjë lloj mangësie në praktikë. Për shembull, Policia Kufitare ka deklaruar se nuk kanë ujë, ushqim apo mjedise ku mund të strehohen grupe të mëdha me imigrantë në rast se lind nevoja për t'i intervistuar. Në disa raste, kisha ka ofruar ushqim për të huajt. Persona kyç kanë thënë se institucionet nuk kanë para për të paguar interpretë për të gjitha gjuhët që flasin imigrantët. Emigrantët e huaj që qëndrojnë ligjërisht në Shkodër për arsye pune apo arsye të tjera kanë të drejta të barabarta të aksesit në shërbime si arsimimi dhe kujdesi shëndetësor (mund të kenë akses në këtë të fundit vetëm nëse janë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile dhe kanë siguracion, gjithashtu nëse janë regjistruar si të papunë në kërkim të punës).

⁸⁶ Intervistë me përfaqësuesin e Zyrës së Punësimit dhe Punëkërkuesve në Shkodër.

⁸⁷ Përfaqësues i organizatës "Gruaja në Zhvillim"

Përveç institucioneve publike, në mbrojtjen e përfshirjes sociale të fëmijëve dhe familjeve të cenueshme, përfshirë dhe familjet e migrantëve, janë përfshirë dhe disa organizata fetare që kanë lidhje me Kishën Katolike.

Një faktor që ka kontribuar në migracion dhe ndalimin e riintegrit të migrantëve të brendshëm dhe/ose të kthyer është ai i diskriminimit të minoriteteve etnike, në veçanti ato rome dhe egjiptiane. Përfaqësuesit e OJF-ve kanë nënvizuar se në rastet e fëmijëve të këtyre minoriteteve në veçanti, në proceset e vendimmarrjes të organizuara nga institucionet përkatëse, jo gjithmonë zbatohet parimi i “interesit më të lartë të fëmijës”⁸⁸

Lezhë

I intervistuari	Migrantë		Persona të tjerë kyç
	14		9
Gjinia e migrantit	Mashkull		Femër
	11		3
Lloji i migracionit	I brendshëm		Ndërkufitar
	1		13
Gjendja civile	I martuar	I divorcuar	Beqar
	8	/	6
Arsimi	Fillor	I mesëm	I lartë
	nuk ka	nuk ka	nuk ka

Lezha ndan të njëjtat karakteristika me bashkitë e tjera të këtij kërkimi, sidomos me Fierin. Të dyja këto bashki janë me madhësi mesatare, që shtrihen në Shqipërinë Jugore. Në këtë bashki migracioni i brendshëm është më pak i përhapur dhe nuk janë të regjistruar raste refugjatësh. Çështjet kryesore të zbuluara nga intervistat në Lezhë kanë lidhje me gjendjen e tmerrshme të tregut vendor të punës, që raportohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë mbi mirëqenien e familjeve dhe vendimin e tyre për të migruar. Gjithashtu kanë lidhje me imigracionin sipas sektorëve (sektori i turizmit), ndikimin e veprimtarive të kryera nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës e hapur së fundmi dhe me ndikimin që kanë organizatat fetare në zonë.

Emigracioni. Lloji më i shpeshtë i migracionit në Lezhë është emigracioni drejt vendeve të huaja, kryesisht në ato të BE-së. Një destinacion kryesor është Italia, por lezhjanët kanë zgjedhur të shkojnë edhe në Gjermani dhe Francë. Disa njerëz kanë emigruar drejt Greqisë, por po kthehen për shkak të krizës ekonomike dhe sepse sipas tyre, integrimi i migrantëve është më i vështirë, kërkon më shumë kohë dhe kushton më shumë në Greqi se në çdo shtet tjetër anëtar të BE-së.

Në Lezhë, mundësitë për emigracion të ligjshëm pothuajse nuk ekzistojnë. Në fakt, 13 nga 14 migrantët e intervistuar kishin emigruar ose në mënyrë të parregullt (para liberalizimit të vizave) ose me pasaportë pa nevojën e vizës, por që nuk kishin leje pune. Personat kyç thonë që Zyra e Punësimit dhe MMSR-ja duhet të bëjnë më shumë për sa i përket krijimit të mundësive për

⁸⁸ Përfaqësues i organizatës “Gruaja në Zhvillim”

migracion të ligjshëm të rinjve dhe njerëzve të kualifikuar. Gjithashtu, ata thonë që ata duhet të ndihmojnë migrantët që të kenë akses ndaj formimit profesional, duke rritur kështu aftësitë e tyre profesionale. Që nga krijimi i saj, Zyra e Punësimit ka marrë vetëm tre aplikime nga punëkërkuar që kërkonin punë jashtë shtetit. Sipas përfaqësuesit të intervistuar, Zyra e Punësimit “nuk di çfarë të bëjë me këta njerëz.”

Imigracioni. Sipas Zyrës së Punës në Lezhë, në vitin 2015, 124 qytetarëve të huaj u është dhënë leje pune. Ata ishin nga: Italia (2), Kosova (6), Maqedonia (3), Turqia (2) dhe Serbia (1). Për sa i përket lejeve të punës të dhëna qytetarëve të huaj në vitet e mëparshme janë raportuar shifra të ngjashme: 54 në vitin 2014, 170 në vitin 2013, 34 në vitin 2012, 36 në vitin 2011 dhe 23 në vitin 2010.⁸⁹ Shumë prej këtyre qytetarëve ishin të punësuar në industrinë e turizmit dhe shërbimeve. Shifrat e sipërpërmendura nuk përfshijnë vullnetarët e huaj që qëndrojnë në Lezhë për veprimtari fetare. Specialistët e Zyrës së Emergjencave Civile në Lezhë kanë raportuar se nuk ka pasur raste të refugjatëve nga Siria apo shteteve të tjera të prekura nga lufta.

Migracioni i brendshëm. Ky lloj migracioni është shumë i shpeshtë, megjithëse asnjë institucion nuk po merret me mbledhjen e të dhënave përkatëse. Në vitin 1990, Lezha kishte 8,000 banorë, ndërsa në vitin 2016 ka 40,000 banorë. Kjo shifër mjafton për të paraqitur dimensionet e lëvizjeve më të mëdha demografike që ndodhin në këtë zonë. Në Lezhë janë shpërngulur shumë njerëz nga zonat rurale dhe qendrat më të vogla dhe më të izoluar si Dukagjini, Kukësi dhe Tropoja. Ata janë shpërngulur pasi ishin në kërkim të kushteve më të mira të jetesës dhe punës. Shumë banorë të Lezhës janë shpërngulur në qytete më të mëdha si Tirana. Në këtë kategori migrantësh përfshihen dhe migrantët afatgjatë, që zgjedhën të shpërnguleshin në kryeqytet sapa u kthyen në Shqipëri.

Jetojmë ndërmjet Lezhës dhe Tiranës. Kemi marrë një hyrje me qira në Tiranë. Kur djali ynë të fillojë shkollën e lartë do të jetojë aty. Kemi shtëpinë tonë në Lezhë. Në Tiranë nuk komunikojmë shumë me njerëzit e komunitetit... (grua, 40 vjeç)

Migracioni i kthimit. Të gjithë migrantët e intervistuar në Lezhë ishin qytetarë shqiptarë të kthyer pas një ose disa vitesh. Asnjë nga institucionet e intervistuar nuk dhanë shifra të qarta për këtë lloj migracioni. Zyra e Punësimit ka raportuar që në vitin 2015 kishte 5 migrantë të kthyer që iu drejtuan Zyrës dhe nëntë në vitin 2016, por këto shifra nuk paraqesin përmasat e vërteta të kësaj dukurie. Kushtet pas kthimit të migrantëve ndryshojnë në varësi të situatave specifike. Në përgjithësi, shumica prej tyre e kishin të vështirë të gjenin punë kur u kthyen në Lezhë dhe këtu nuk përjashtohen migrantët me arsim të lartë.

Ata që mundën të gjenin punë, kanë thënë se kushtet e punës ishin të këqija dhe paga ishte e ulët në krahasim me standardin që ata kishin pasur në shtetet anëtare të BE-së. Migrantët me kualifikime të ulëta thonë që marrin rroga nën minimalen zyrtare (15,000 Lekë në muaj) dhe janë të detyruar të punojnë me orare të zgjatura çdo ditë.

⁸⁹ Të dhëna të raportuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

Situata pasi kthehen është shumë e vështirë, si në aspektin emocional edhe në atë material. Përfaqësuesit e Drejtorisë Arsimore Rajonale kanë raportuar se një numër shumë i madh fëmijësh janë riintegruar në shkolla. Nga 225 fëmijë të kthyer, 42 ishin adoleshentë në shkolla të mesme, 179 në 9-vjeçare dhe 4 në çerdhe. Numri më i madh i këtyre fëmijëve ishin kthyer nga Gjermania (162), gjithashtu dhe nga Franca (4), Greqia (20), Italia (23), Suedia (8), Zvicra (1), Kanadaja (2) dhe Turqia (1).

Migracioni dhe mbrojtja sociale. Në Lezhë ka një numër të madh shërbimesh që u ofrohen personave të cenueshëm, përfshirë dhe migrantët e kthyer. Megjithatë, mundësia për t'u regjistruar si migrant i kthyer varet nga nisma e individit në fjalë dhe vetëm njerëzit që kanë qëndruar më shumë se një vit jashtë vendit mund të regjistrohen si të tillë në Shqipëri. Për sa i përket qëndrimit të shkurtër të migrantëve të përfshirë në procedurat e kërkimit të azilit jashtë vendit, shumë familje dhe fëmijë mund të përjashtohen nga marrja e ndihmës për shkak të afatit njëvjeçar. Zyra e Punësimit e rajonit ka pasur një Sportel Migracioni nga viti 2010 deri në vitin 2015. Migrantët e kthyer nga jashtë vendit mund të përfitojnë një orientim falas ndaj shërbimeve, si punësimi, formimi profesional, arsimimi, strehimi dhe kujdesi shëndetësor atje. Megjithatë, Zyra e Punësimit ka marrë shumë pak kërkesa për ndihmë nga ky grup. Sipas një përfaqësuesi të këtij institucioni, migrantët e kthyer shkojnë te Zyrat e Punës vetëm kur iu duhet një certifikatë papunësie, që të mund të marrin kartën e shëndetit. Ashtu si migrantët në bashkitë e tjera, edhe migrantët e kthyer në Lezhë kanë thënë se nuk kishin pritshmëri të larta për institucionet publike. Nga 14 migrantët e përfshirë në këtë kampion kërkimi, vetëm një ka kërkuar punë te Zyra e Punësimit por pa rezultat.

Për sa i përket shërbimeve të disponueshme për fëmijët e kthyer, edhe në Lezhë doli që shërbimet më të mira ofroheshin nga shkollat, që janë të autorizuar qartësisht që të mbështesin riintegrimin e fëmijëve migrantë. Sipas Drejtorisë Arsimore Rajonale të Lezhës, gjatë viteve 2015-2016, nëpër shkollat vendase janë integruar 225 fëmijë të familjeve të kthyer migrantë. 162 prej tyre janë kthyer nga Gjermania, 20 nga Franca, 23 nga Greqia, 8 nga Italia, 11 nga Suedia, 2 nga Zvicra, 2 nga Kanadaja dhe 1 nga Turqia.

Një pjesë e rëndësishme e punës së Zyrës së Shërbimeve Kombëtare Sociale në Lezhë është dhënia e ndihmës për kthimin e fëmijëve të pashoqëruar. Sipas përfaqësuesit të tyre, në vitin 2015 ata kanë ndihmuar 15 raste në të gjithë prefekturën, që përfshin edhe dy komunat e tjera të qarkut të Lezhës (Mirditën dhe Kurbinin).

Përpos Shërbimit Social Shtetëror, grave dhe vajzave, fëmijëve të familjeve të varfra, minoriteteve rome dhe egjiptiane dhe të moshuarve në Lezhë iu ofrohen disa lloje të tjera shërbimesh nga OJF private. Këto shërbime kanë të bëjnë me ofrimin e ndihmës për strehim, jetesë, punë dhe për arsimimin dhe formimin e fëmijëve dhe të rinjve që kanë familje në nevojë. Migrantët e intervistuar si pjesë e kërkimit tregojnë se ata ishin të kënaqur me mbështetjen e organizatave private dhe, që ata mbështeteshin shumë të rrjetet e mbrojtjes joformale në rang komuniteti.




Misioni në Shqipëri


Rruga "Skënderbej", Nd. 8, H. 3, Ap. 27 & 37, Tiranë, Shqipëri


T & F +355 (0) 4 223 99 00

E-Mail: info@tdhalbania.org

Web: tdh.ch, childhub.org

 Terre des hommes Albania

 Terre des hommes Albania

 [tdh_albania](https://twitter.com/tdh_albania)



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët në mbarë botën. tdh.ch